



# Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3282 · e premte 2 shkurt, 2018

-1°C | 13°C

Fq.15

15 DEN

**EDITORIAL**

## Broçkulla "ekspertësh"



Në kohën kur Maqedonia po negocion me Greqinë për ndryshimin e emrit, ndërsa me Bullgarinë po ratifikon një marrëveshje të vështirë, që gjithashtu ka të bëjë me identitetin e këtij populli të kontestuar nga të gjithë fqinjët, çuditërisht po në të njëjtën kohë, në mediat e vendit lajm kryesor është Ligji për përdorimin e gjuhës shqipe dhe rreziku që vjen për shtetin nga lejimi i zgjerimit të përdorimit të saj në institucionet e vendit. Kjo mënyrë paradoksale e të menduarit politik mbi rrezikun nga shqiptarët, të cilët për dallim nga grekët dhe...

Fq.2

**DOSSIER**

## Kërkesa e deputetëve shqiptarë drejtuar Andovit

Fq.17

**STUDIME**

## Skllëvër të mediave sociale

Fq.12



## NIMICOPTIMIST PËR EMRIN, TAKON KREUN E SHTETIT

# "MAQEDONIAEPËRME", ÇËSHTJE JAVËSH



Të dyja vendet kane vullnet dhe janë duke përparuar në drejtim të zgjidhjes së çështjes së emrit, tha Nimic dhe siguroi qytetarët e Maqedonisë se në asnjë rast nuk bisedohet për ndryshim të identitetit, por siç potencoi ai, bisedohet për emrin e shtetit. Në ndërkohë, gazeta KOHA merr vesh se më shumë gjasa ka termi "Maqedoniaepërme", d.m.th si nocion i vetëm pa ndarje të emrit

Fq.3

## Shqiptarët para atyre maqedonasve dhe turqve

*Shkup, 1 shkurt* - Me gjithë rezultatet e dobëta që kanë treguar në vazhdimësi nxënësit tanë nëpër testimet ndërkombëtare të matjes së njohurive, në Maqedoni nuk është bërë ende diçka konkrete për të gjetur shkaqet kryesore dhe për të rekomanduar propozimet për zgjidhjen e problemit. Hulumtime të mirëfillta shkencore, të ndërmarra nga institucione shtetërore, konkretisht nga Ministria e Arsimit

dhe Shkencës (MASH) mungojnë sot e kësaj dite, pa çka se dy herë radhazi, PISA 2013 dhe PISA 2015 e radhiti Maqedoninë në mesin e trekatër vendeve të fundit në botë. Kështu, nga testimet e fundit për nivelin e diturive për shkencë, lexim dhe matematikë në mesin e 70 vendeve në botë, Maqedonia u rangua në vendin e 67 për shkencë dhe lexim dhe në vendin 66 për matematikë...

Fq.7





## EDITORIAL

# BROÇKULLA "EKSPERTËSH"



Lirim DULLOVI

Në kohën kur Maqedonia po negocion me Greqinë për ndryshimin e emrit, ndërsa me Bullgarinë po ratifikon një marrëveshje të vësh-tirë, që gjithashtu ka të bëjë me identitetin e këtij populli të konte-stuar nga të gjithë fqinjët, çuditërisht po në të njëjtën kohë, në me-diat e vendit lajm kryesor është Ligji për përdorimin e gjuhës shqipe dhe rreziku që vjen për shtetin nga lejimi i zgjerimit të përdorimit të saj në institucionet e vendit.

Kjo mënyrë paradoksale e të menduarit politik mbi rrezikun nga sh-qiptarët, të cilët për dallim nga grekët dhe bullgarët, nuk po konte-stojnë asgjë, është duke u promovuar nga ekspertë të ashtuquajtur të drejtës kushtetuese, të llojit të profesoreshës Gordana Siljanov-ska dhe disa të tjerë si ajo, të cilët në argumentimin e kushtetue-shmërisë së këtij propozim-ligji, si ekspertë të mëdhenj që janë, shër-behen bile edhe me memoaret e disa pjesëmarrësve në bisedimet në Ohër të vitit 2001.

Kur i dëgjon se si flasin për drejtësinë, e sidomos atë që buron nga kushtetuta, të krijohet përshtypjen se kushtetuta është një materie, që është hartuar për ta kuptuar vetëm qeniet jashtëtokësore, apo një program sekret i NASA-s për pushtimin e planetëve tjera të gjithë-sisë. Ose, sipas tyre, kushtetuta mund të jetë një plastelinë që merr formë varësisht se në dorën e kujt modelohet.

Të lexosh Kushtetutën me syzat e huazuara nëpër muzetë e harrua-ra të mesjetës, patjetër që do të prodhojë errësirë në kokën e atyre që ushqehen me këtë mendësi mesjetare. Përpos një pjese raciona-le të publikut, përfshi edhe shqiptarët, të cilët ndodhen në situatë pa-radoksale, duke e pyetur veten mos vallë ata nuk e kuptojnë drejt Ku-shtetutën, sidomos amendamentin 5, i cili në mënyrë të qartë përcakton që përskaaj gjuhës maqedone, gjuhë tjetër zyrtare në Ma-qedoni është edhe gjuha që e flasin mbi 20 për qind e popullatës. Dhe në vend se këtu të përfundojë debati mbi këtë çështje dhe, si pa-triotë dhe ekspertë të mëdhenj që janë, ta mbrojnë veten dhe kom-bin që i takojnë nga çështjet e hapura me Bullgarinë, Greqinë edhe Serbinë, këta kujdestarë të çështjes shqiptare, gjithnjë duke u nisur nga ndjenja antishqiptare, e kalitur ndër vite, shërbehen me çka munden për të mohuar shtimin e përdorimit zyrtar të gjuhës shqi-pe.

Fakt tjetër shqetësues janë edhe prijet e disa mediave që këtyre per-sonave u japin luksin të debatojnë në këtë temë, duke mos ftuar nga ana tjetër asnjë përfaqësues që mund të ketë mendim krejt të ndry-shëm. Pyetja më e logjikshme që duhet shtruar këtyre mender-methënë ekspertëve do të ishte A jeni ju për përdorim më të gjerë të gjuhës shqipe në këtë shtet, apo nuk jeni? Ndonëse, shpeshherë qëndrimet e tyre mohuese kundër shqipes ata i prezantojnë edhe pa u pyetur, habit fakti se në të njëjtat vale ndodhen edhe disa ko-legë tanë maqedonas, të cilët pa kurrfarë sensi professional e qyte-tar Siljanovskës mundohen t'ia japin epitetin e personit që ka li-cencën mbi interpretimin e drejtë të kushtetutës. Por në këtë vend të absurdeve që moti epitetin e ekspertit e mbajnë ata të cilët filli-misht janë antishqiptarë. Fundja, po të mos ishte antishqiptare, Siljanovska që moti do të kishte mbrojtur çështjen maqedonase aty ku mohohet dhe përbuzet më së tepërmi. Ka të ngjarë që antishqip-tarizmi i kësaj kategorie ekspertësh po vazhdon të shërbejë si kar-burant i vjedhur kontrabandë për të djegur kauzat e tyre kombëta-re që asnjëherë nuk guxuan ti shpalosin, sidomos atje ku më së tepërmi u mohohet origjina, gjuha, kisha etj.

Përfundimisht, gjithë ata që nuk ngurrojnë të promovojnë dhe paj-tohen me qëndrimet si ato të Siljanovskës dhe të ngjashmëve, duhet ta dinë se këto broçkulla "ekspertësh" nuk mund t'i plasojnë përtej pa-zarit lokal të mendësisë së çoroditur politike maqedonase.

## SI TË KTHEHEMI NË VENDLINDJE...

"Po flas për periudhën para 30 vitesh, sheshi para Konfederatës helvetike në Bernë ishte i stërbushur me shqiptarë, kishte nga çdo lloj profili, nga kriminelët me kalibër më të madh, deri te intelektualit me famë ndërkombëtare. Një varg i restoranteve para sheshit, gjithnjë rrinin të stërbushur me shqiptarë, nga Kosova, Maqedonia, Mali Zi, Presheva, të Shqipërisë nuk kishte shumë në atë kohë. Hapësira prej rreth 5-6 metrash katrore, në të cilën ishte vendosur një fushe shahu me figura të mëdha që arrijnë deri tek gjuri, rregullisht ishte e zënë me lojtarë shqiptarë. Zakonisht, i pushtonim edhe restorantet nëpër stacionet e trenave, të njohura në popull si banhofi (në Bernë ishte Kristofelli i famshëm). Sot, të merr malli të shohësh ndonjë shqiptar në kryeqendrën zvicerane. Të gjithë janë integruar në mënyrë të shkëlqyeshme në shoqërinë zvicerane. Të gjithë i kushtojnë vëmendje të jashtëzakonshme arsimit të fëmijëve, pagesës me kohë të detyrimeve të përditshme, shfrytëzimit të fundjavës në mënyrë sa më racionale, duke shëtitur nëpër qendra të ndryshme turistike. Vërtet mungojnë shumë aktivitetet edukative-kulturore shqiptare (me përjashtim të Ostermundigenit, LAPSH-it dhe ekepeve sportive që po na e zbardhin fytyrën), ama kemi bre mundësi edhe për shumë gjëra të tjera. Duhet të pajtohem që ti shuajmë ëndrrat për t'u kthyer në vendlindje, pasi fëmijët janë martuar këtu, ata nuk i kanë ato ndjenja sikur që i kishim ne, të fitojmë pak të holla e të kthehemi në vendlindje. Ata tani mendojnë në mënyrë zvicerane, ndërsa ne nuk mundemi pa ta. Si të kthehemi në vendlindje kur fëmija as që do të dëgjojë për një "vend të huaj". Kemi ra në hall, është krijuar një vakum i llojit të veçantë, as të kthehemi në vendlindje, por as edhe të organizojmë jetën sikur në vendlindje me lloj-lloj aktivitetesh edukative-kulturore. Veç po them se edhe nuk kam as ide e as mundësi për të ndryshuar gjërat", shkruan në profilin e tij në Facebook, gjuhëtari Enver Gashi, njëherësh themelues i portalit "shtegu.com" me zyre në Zvicër.

## VMRO-DPMNE E DJEG TË ARDHMEN POLITIKE

"Është absurde që në këtë kohë të globalizimit gjuha e tjetrit të shndërrohet në problem. Aq më tepër kur të arriturat teknike dhe teknologjike kanë bërë që të tejkalohet çdo barrierë gjuhësore për çdokënd në rruzullin tokësor. Tani më gjuha është shndërruar në një formë komunikimi, e shkarkuar nga fobitë e ekspansioneve kulturore apo e mbisundimeve gjuhësore. Gjuha në fakt gjithnjë e më shumë kuptohet vetëm si një formë komunikimi, me ç'rast përmbajtja shpërfaqet si elementi i vetëm në procesin e komunikimit. Për dallim nga më parë, kur vende me ndikim në botë përpiqeshin të përhapin gjuhën e tyre si parakusht i ekspansionit kulturor, me paraqitjen e Internetit dhe veglave të përkthimit, lufta për dominim gjuhësor bëhet gjithnjë më e pakuptimtë. Në fakt, po ndodh një trend i kundërt: institucione dhe media të një qytetërimi përçojnë përmbajtjen në gjuhën e qytetërit tjetër të cilin dëshirojnë ta influencojnë. Institucionet amerikane që kanë të bëjnë me politikën e jashtme kanë web-faqet e tyre edhe në gjuhën ruse apo arabe, ato ruse japin mundësi që qasje të kenë edhe ata që njohin gjuhën angleze apo kineze. Të dy vendet kushtimisht thënë armiqësore flasin gjuhën e njëri-tjetrit me qëllim të ndikimit në opinionin publik...", shkruan gazetari Xhelal Neziri.

## MEDIACitate

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në konferencën për dhjetëvjetorin e Pavarësisë së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se në vitin 2015 zgjodhën më të mirën e mundshme nga dy më të këqijat për Gjykatën Speciale. Ai ka thënë se kjo gjykatë ka mundur të krijohej në dy mënyra, atë nga OKB-ja, ku Rusia ka të drejtën e vetos dhe përkrahjen e shteteve tjera që nuk e kanë njohur Kosovën, ose nga institucionet e Kosovës, duke u bazuar me kushtetutën e vendit. "Kemi zgjedhur më të keqen të mundshme", ka thënë Thaçi, derisa ka bërë thirrje për publikimin e bisedave me përfaqësuesit ndërkombëtarë për Gjykatën Speciale. Në interesimin e gazetarëve rreth Gjykatës Speciale dhe iniciativës së deputetëve për zhbërjen e saj, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi tha: "Gjykata Speciale nuk do të shfuqizohet. Ky është qëndrim i shtetit të Kosovës, nuk është opinion". "Unë uroj që ato biseda me SHBA-në dhe vendet tjera të publikohen dhe të shihni pozicionin tim të pozicionit tim si kryeministër. (KOHA Ditore, 1 shkurt)

Vendimi më i rëndësishëm që do duhej të merrte Kuvendi ditën e djeshme, ishte ai për miratimin ose jo të listës së anëtarëve për Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë të Gjyqësorit. Mes tensioneve dhe bllokimit të foltores nge deputetët e opozitës, lista me emra të rinj, që u propozua për votim është rrezuar për të dytën herë, pasi projektligji nuk ka marrë 2/3 e votave që përcakton Kushtetuta për të. Megjithatë, mes thirrjeve të opozitës "hajdutë, kriminelë", ku deputetët kishin rrethuar foltoresh e Kuvendit dhe përplasnin duart në tavolinë, Parlamenti miratoi projektligjet e parashikuara në rendin e ditës. Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi tha se procedura do të kthehet sërish në nënkomisionin Ad-hoc, ku do të zgjidhen emra të tjerë. Ndërkohë një tjetër projektligji i rëndësishëm, për të cilin u votua sot ishte ai që i hap rrugën negociatave me kosnsorciumin turk për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës. Ky projektligji u miratua me 74 vota pro të mazhorancës, ndërsa foltoresha e Kuvendit ishte e bllokuar nga deputetët e opozitës. (Gazeta Shqip, 1 shkurt)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

## ÇFARË KA QENË VAKËFI?

Vakëfi ka qenë pasuri e institucioneve fetare myslimane që përfshinte toka, shtëpi, dyqane, të holla etj., e krijuar në Shqipëri që nga shek.XV e më vonë nga dhurimet e sulltanit dhe të besimtarëve të tjerë, sipas rregullave të caktuara të vakufimit. Çdo mysliman kishte të drejtë të kthente në vakëf çdo lloj prone private, duke caktuar si do të përdroreshin të ardhurat e

saj. Kusht themelor ishte që një pjesë e këtyre të ardhurave të shkonte në dobi të një institucioni fetar, një pjesë tjetër mund të shkonte për ndërtime publike, rrugë, çezma, ndërtesa. Vakëfi ishte i paprekshëm nga shteti. Pjesën më të madhe të të ardhurave vakufënësi shpesh e destinonte për vete e për trashëgimtarët e tij brez pas brezi. I tillë qe vakëfi i madh me shumë fshatra në krahinën e Korçës, që e la feudalit i madh Iljaz Bej Mirahori në fund të shek.XV.



NIMIC OPTIMIST PËR EMRIN



# “MAQEDONIAEPËRME”,

# ÇËSHTJE DITËSH DHE JAVËSH

Të dyja vendet kane vullnet dhe janë duke përparuar në drejtim të zgjidhjes së çështjes së emrit, tha Nimic dhe siguroi qytetarët e Maqedonisë se në asnjë rast nuk bisedohet për ndryshim të identitetit, por siç potencoi ai, bisedohet për emrin e shtetit. Në ndërkohë, gazeta KOHA merr vesh se më shumë gjasa ka termi “Maqedoniaepërme”, d.m.th si nocion i vetëm pa ndarje të emrit

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 1 shkurt - Ndërmjetësuesi i OKB-së për zgjidhjen e kontestit të emrit, Methju Nimic pas takimit që pati me ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, bëri të ditur se zgjidhja e kontestit për emrin është afër dhe është çështje ditësh dhe javësh kur mund të jetë përfundimtare. Këtë optimizëm Nimic e shprehu duke u mbështetur në faktin se, siç tha ai, të dyja vendet kane vullnet dhe janë duke përparuar në drejtim të zgjidhjes së çështjes së emrit. Nimic siguroi qytetarët e Maqedonisë se në asnjë rast nuk bisedohet për ndryshim të identitetit por siç potencoi ai bisedohet për emrin e shtetit.

“Zgjidhja është shumë afër dhe flitet për javë, e muaj për ta zgjidhur çështjen, e jo vite. Në të ardhmen nuk do të ketë situatë më të lehtë, prandaj duhet të zgjidhet çështja tani, pra duhet të ecet përpara”, tha Nimic gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me ministrin Dimitrov. “Ne po negociojmë për emrin e shtetit dhe jo për gjuhën dhe identitetin e maqedonasve. Tani është koha për zgjidhje, tani është momenti dhe ne duhet ta kapim atë. E di që nuk është lehtë por më tutje do të bëhet më vështirë prandaj këto muajt që vijin janë kyçe dhe deciziv për një zgjidhje për të dyja vende. Do të ishte tragjedi e vërtetë nëse kjo çështje nuk zgjidhet tani dhe zgjatet edhe 20 vite më tutje”, theksoi Nimic. Siç shtoi ai, procesi i negociatave në përgjithësi shkon mirë ndërsa pranoi që ende ka dallime, por

që mund të tejkalohen. Ai tha se në përgjithësi procesi po shkon përpara në të dyja vendet për të arritur një zgjidhje të problemit. Ka dallime në qëndrime, por sipas tij, ato mund të tejkalohen sepse siç përsëriti sërish, tani është koha e duhur për t'i lënë këto çështje pas dhe të dyja vendet të përparojnë.

Nga ana tjetër, ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, tha se Qeveria ka shumë kujdes në këtë proces dhe se ka vullnet për zgjidhjen e kësaj çështje. “Çështja e emrit është e shenjtë për popullin maqedonas dhe andaj ndiqet me shumë vëmendje dhe brengosje. Qeveria ka shumë kujdes dhe dëshiron të zgjidh këtë çështje në mënyrë që edhe në Maqedoni edhe në Greqi të mos ketë pakënaqësi. Në shekullin 21 askush nuk ka të drejtë të më mohojë të drejtën time për të qenë maqedonas dhe të për të folur maqedonisht. Është me rëndësi se si sillemi në publik dhe çfarë flasim, posaçërisht kur flasim për linja të kuqe, sepse kjo e dëmton gjithë procesin që e udhëheq Nimici. Ne kemi vullnet dhe shpresojmë që edhe pala tjetër të ketë vullnet të njëjtë për të gjetur zgjidhje”, tha Dimitrov. Ai ishte kategorik se me palën greke nuk po negociohet për identitetin e vendit, por shtoi se nga propozimet e Nimicit, përveç ideve të mira - ka edhe ide që nuk janë dhe aq të mira. “Në asnjë mënyrë nuk negociohet për identitetin e vendit dhe se për këtë as që do të negociohet ndonjëherë sepse Qeveria absolutisht nuk do të kishte negociuar për këtë dhe nuk do të kishte zgjidhje.

Kemi folur shumë detajisht dhe seriozisht për idetë që i ka sjellë Nimici. I thash që në propozimet e tij ka dhe ide që nuk janë të këqija, por dhe ide që nuk janë dhe aq të mira”, tha Dimitrov. Ndryshe, Methju Nimic të enjten para dite u takua me presidentin Gjorge Ivanov dhe me kryeministrin Zoran Zaev, para se të takohen me ministrin e Jashtëm, Nikolla Dimitrov. Pas tij, Nimic ka takuar liderin e VMRO-së, Hristijan Mickoski dhe atë të BDI-së, Ali Ahmeti. Në takimin midis presidentit Gjorge Ivanov dhe ambasadorit të Kombeve të Bashkuara (KB), Metju Nimic, është diskutuar gjendja aktuale rreth çështjes së emrit që po zhvillohet me ndërmjetësim të OKB-së. Në këtë takim janë shkëmbyer informacione dhe mendime lidhur me idetë dhe propozimet e ambasadorit Nimic, si dhe është folur për vizitën e tij në Athinë, njoftuan nga kabineti i Presidentit Ivanov. Nga kabineti i presidentit Ivanov theksojnë se Maqedonia do të vazhdojë të marrë pjesë në këtë proces në mënyrë konstruktive, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje për mosmarrëveshjen e imponuar nga Greqia, e cila nuk do të ndikojë në identitetin e popullit maqedonas dhe nuk do të shkel dinjitetin e qytetarëve të Maqedonisë.

Kur jemi tek bisedimet për emrin nga burimet e saja anonime gazeta KOHA merr vesh se më shumë gjasa ka termi “Maqedoniaepërme”, d.m.th si nocion i vetëm pa ndarje të emrit “Maqedoni” dhe termit “e epërme”, e jo sintagmë. Kjo thuhet të jetë propozimi që do të

kënaqte Greqinë. Ky emër është folur këto ditë edhe nga mediat greke. Sipas mediave greke, Maqedonia e Epërme (Republic of Upper Macedonia), por pa u specifikuar ndarja mes termeve është propozimi i ri për emrin, siç ka përcjell korrespondenti i “eMagazin” në Selanik. Mediat greke thirren në informacione ekskluzive të Ministrisë së Jashtme. Nga ana tjetër, sipas mediave greke që thirren në burime në Shkup, pala maqedonase ka qenë për propozimin Maqedonia e Re (Republic of New Macedonia). Greqëve u ka pëlqyer edhe propozimi Republika Maqedonia e Vardarit (Republic of Macedonia of Vardar). Propozimi për Republika Maqedonia e Epërme (Upper Macedonia) megjithatë ka qenë i pranueshëm për dyja palët, shkruajnë mediat greke.

Ndërkaq, propozimi Republika e Maqedonisë (Shkupi) nuk është në lojë. Zgjidhja e çështjes së emrit qoftë dhe jo definitive por që palët paraprakisht të merren vesh për emrin e shtetit, edhe atë para Samitit të NATOS që do të mbahet ne Strasburg në korrik të këtij viti, do të bëjë që Maqedonia me gjasë do të merr ftesë për anëtarësim në këtë organizatë. Një ditë para se të vjen në Shkup ndërmjetësi Methju Nimic ishte sekretari i përgjithshëm i NATO-së Jens Stoltenberg që dha optimizëm për të dyja palët kur tha se Maqedonia do të merre ftesë nga kjo organizatë pas vendimit të dakorduar nga të dyja palët për kontestin rreth emrit të shtetit në kuadër të OKB-së.



## Cipras luan poker në lidhje me Maqedoninë

Londër, 1 shkurt - Alexis Cipras po përballlet me rezistencë të madhe popullore dhe politike drejt çfarëdo lloj përdorimi të termit “Maqedonia” në emrin e vendit. Nga ana tjetër, sërish, shpërblimi diplomatik për zgjidhjen e kontestit të emrit që mund ta marrë është e rëndësishme për të dhe mund ta shndërojë në Oto fon Bizmark të Ballkanit, shkruan “Fajneshtëll Tajms” në artikullin nën titullin “Cipras luan poker në lidhje me Maqedoninë”. Gazeta prestigjioze britanike duke bërë kthim historik në kontestin mes të dy vendeve deri më sot, theksojnë se rreth 60 për qind e grekëve e kundërshtojnë emrin e përbërë i cili do ta përmbante termin “Maqedonia” ndërsa tregojnë edhe për mijëra qytetarë të cilët morën pjesë në protestat në Selanik muajin e kaluar, si dhe për protestën e ardhshme që është caktuar për të dielën në Athinë. FT shkruan se opozita greke Demokracia e Re e ka sulmuar Ciprasin që nuk i ka përfshirë në bisedimet për emrin dhe shton se Kisha greke, e cila në fillim ka dhënë mbështetje për Ciprasin, tani është kundër tij. Në gjithë këtë rrëmujë, e cila sipas gazetës ngjan në kaos, është edhe qëndrimi i ultranacionalistëve të cilët janë pjesë e koalicionit në Qeverinë e Ciprasit, ndërsa të cilët çështjen e emrit për Maqedoninë e vendosin në qendër të politikës së tyre irrendentiste. “Për liderin e SYRIZA-s edhe vetë shqyrtimi i emrit është strategji me rrezik të madh në vitin kur vendi duhet ta kremtojë daljen e saj nga kriza debitorë tetëvjeçare. Ndërkaq, çmimi i mundur diplomatik është i rëndësishëm për të. Nën presionin e Uashingtonit, i cili sivjet dëshiron që Maqedonia të inkuadrohet në NATO, dhe në Bashkimin Evropian, e cila ende mendon për lehtësimin e borxheve greke, kompromisin që do ta arrinte Ciprasi do ta shndërronte në Oto fon Bizmarkun e Ballkanit”, theksojnë “Fajneshtëll tajms” në analizën e saj. Nga ana tjetër, ndërkaq, shohet në analizë, gazeta përfundon se për grekët emocional, të cilët janë nën fuqinë e kreditorëve të huaj pothuajse për një dekadë, kjo mund të jetë pika e ujit që do të derdhej nga gota.



DËM PËR DY MILIONË BANORË

# ME AJRIN E NDOTUR, PIMË NGA TRE CIGARE!

Analizat e ndryshme tregojnë se çdo qytetar që jeton në Maqedoni, duke thithur ajër të ndotur - në mesatare konsumon gati nga 3.2 cigare në ditë

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 1 shkurt - Ndotja e madhe e ajrit në Shkup dhe tërë Maqedoninë shkakton dëme të mëdha për shëndetin e njeriut. Ajri me prani të madhe të grimcave të ndryshme të rrezikshme për njeriun aq shumë rrezikon shëndetin e njerëzve sa që shkakton vdekjen e 2000 të sëmurëve kronikë në vend, tregojnë analizat e fundit të Institutit për Shëndet Publik të Maqedonisë. Nga qytetet, më i goditur është Shkupi, ku në një vit e pësojnë 1000 deri 1100 persona. Analizat tregojnë se mortaliteti shkaktohet tek tre grupet e pacientëve me gjendje më të dobët shëndetësore - ata që vuajnë nga sëmundjet ishemike të zemrës, goditjet e trurit dhe kanceri i mushkërive të bardha. Edhe hulumtimet e tjera botërore tregojnë dëmin e madh që shkakton ajri i ndotur jo vetëm për të sëmurët kronik, por për të gjithë popullatën prej dy milionë banorë në Maqedoni. Analizat e ndryshme tregojnë se çdo qytetar që jeton në Maqedoni, duke thithur ajër të ndotur - në mesatare konsumon nga disa cigare në ditë, përkundër faktit se nuk është duhanxhinj. Hulumtimet e profesorit amerikan Riçard Miler, që vështron raportin e grimcave të dëmshme PM në ajër të barazuara me numrin e cigareve, tregojnë se banorët e qyteteve më të ndotura evropiane në mesatare marrin frymë me grimca të ndotura sikur të pinë nga 1.6 cigare në ditë. Në rastin e Maqedonisë, nëse marrim si parametër se një cigare i përgjigjet koncentrimin të grimcave PM 2.3 nga 22 mikrogramë në një kub metër - del se çdo banor i Maqedonisë konsumon nga 3.2 cigare në ditë. Ky rezultat fitohet kur krahasojmë nivelin mesatar të grimcave të rrezikshme prej 70 mikrogramë në metër kub të bazuara tek anali-

## HIQET TRANSPORTI PUBLIK FALAS NË SHKUP

Qyteti i Shkupit njoftoi se prej mbremë në orën 20 hiqet transporti publik falas në Shkup, ndërsa menjëherë hiqen masat dhe rekomandimet e jashtëzakonshme për uljen e ndotjes së ajrit, pas marrjes së informacioneve nga Ministria e Mjedisit të Jetesës dhe Planifikimit Hapësinor se përqendrimet mesatare ditore të PM10 grimca në ajër janë nën pragun e definuar të alarmimit nga 200 µg/m<sup>3</sup> dhe episodit me ndotjen e rritur gjatë dy ditëve radhazi është hequr. "Me këtë, masat dhe rekomandimet për uljen e ndotjes së ajrit hiqen menjëherë. Por, Qyteti i Shkupit t'u mundësojë qytetarëve të cilët në

vendin e tyre të punës kanë mbërritur me autobus, falas të kthehen në shtëpi, prej sonte në orën 20 hiqet transporti publik falas", kumtojnë nga Qyteti i Shkupit. Theksojnë se këto masa dhe rekomandime për uljen e ndotjes së ajrit do të vendosen sërish nëse përsëritet episodi me ndotjen e ajrit, për çfarë qytetarët do të informohen me kohë. Edhe krahas pastrimit të ajrit, Qyteti i Shkupit u bën apel qytetarëve të mos i përdorin pa nevojë automjetet, më shumë persona të voziten në [një makinë, të shfrytëzohet transporti publik, për ngrohjen e shtëpive të mos përdoren materiale të mbeturinave.

zat e Institutit Finlandez të Shëndeti Publik. Për çdo vit, në Maqedoni me ardhjen e sezonit të dimrit, ndotja e madhe e ajrit shihet jo vetëm në Shkup, por edhe në gati të gjitha qytetet më të mëdha në shtet. Stacionet matëse në Shkup dhe disa qytete të tjera më të mëdha me javë të tëra tregojnë koncentrimet më të mëdha të materieve helmuese në ajër. Grimcat e dëmshme PM që rrezikojnë shëndetin e qytetarëve jo vetëm në Shkup, por edhe Tetovë dhe Manastir vitet e kaluara ishin rritur edhe për tetë herë më shumë se kufijtë e lejueshëm. Komunikacioni i dendur, ngrohja me dru dhe materiale tjera, pluhuri nga ndërtimet e ndryshme, oxhaqet e kapaciteteve prodhuese së bashku

me veturat që vozisin me dizel, renditen ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e ndotjes, andaj edhe zgjidhja e problemit duhet të jetë gjithëpërfshirëse thonë njohësit e kësaj problematike. Ekspertët shëndetësor thonë se problemi me ndotjen e ajrit në Maqedoni, nuk zgjidhet me rekomandime, por me masa serioze parandaluese dhe koordinimin më të madh e të gjithë faktorëve me qëllim të zbutjes së problemit të ndotjes. Ekspertët shëndetësor vlerësojnë se ulja e ndotjes së ajrit do të shpëtojë jetën e më shumë pacientëve. "Nëse arrijmë që ndotjen ta zvogëlojmë në nivel evropian, në këtë rast do të shpëtojmë gjysmën e të sëmurëve kronik, shëndeti i të cilëve kërcënohet

nga ndotja. Nëse arrijmë që edhe më tej të zvogëlojmë ndotjen në përputhje me normat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, do të shpëtojmë 80 për qind të tyre", thotë profesori universitar Dragan Gjorgjiev. Nga ana tjetër, analizat tregojnë se nevojiten 50 denarë për çdo amvisëri në shtatë vitet e ardhshme apo 380 milionë euro për tejkalimin e problemit të ndotjes në Shkup. Këto mjete nevojiten për përgjysmimin e ndotjes së ajrit në kryeqytetin e Maqedonisë siç janë izolimi efikas i amvisërive, ndryshimi apo modernizimi i aparateve për ngrohje dhe shfrytëzimin e rrjetit të gazifikimit tregojnë analizat e Akademisë së Shkencave të Maqedonisë. Analizat tregojnë se mbi 90 për qind të emisionit të PM grimcave vijnë nga metalurgjia, prodhimi i energjisë elektrike dhe ngrohjes, ngrohjes me dru në amvisëri dhe përzjerja e asfaltit në rrugë. Nga Banka Botërore rekomandojnë se ulja e ndotjes së ajrit është e mundshme me përdorimin e teknologjive të disponueshme në industri dhe sektorin e rrugëve, gazifikimin e shtetit, si dhe me ndihmën e programeve shtetërore për përdorimin e aparateve moderne efikase për gatim në amvisëri.

## PREJ SOT NDRYSHIM I MOTIT, SHI DHE ERË

Reshje të përkohshme të shiut dhe erë e përforcuar jugore paralajmërojnë meteorologët për sot, ndërsa të shtunën me intensitet më të madh. Sot, vranësirat do të fillojnë nga perëndimi, ndërsa në lindje dhe diku në pjesët qendrore do të ketë reshje të dobëta. Reshjet do të vazhdojnë edhe të shtunën ku do të jenë më intensive dhe do të përcillen me erë të përforcuar jugperëndimore mbi 80 kilometra në orë. Lokalisht do të ketë kushte për paraqitjen e shiut të rrëmbyeshëm dhe bubullimave të rralla, veçanërisht në rajonet perëndimore, ndërsa në viset më të larta malore do të ketë reshje dëbore. Reshjet e përkohshme janë të mundshme edhe të dielën paradite kur në viset më të larta të verilindje do të kalojnë me dëborë të dobët. Të hënën do të ketë stabilizim të motit.




## Doris Pak përsëritet themelimin e MASEE

Shkup, 1 shkurt - Presidentja e Grave të Partisë Popullore Evropiane dhe ish-deputetja e Parlamentit Evropian, Doris Pak, ka përsëritur themelimin e Asociacionit të Mediave të Evropës Juglindore (Media Association of South East Europe), asociacion ky që ka gjashtë media kryesore në Evropën Juglindore. Doris Pak në profilin e saj në Twitter ka përgëzuar gazetën "Vijesti" (Podgoricë), KOHA (Shkup) "Oslobodjenje" (Sarajevë), "AMC" (Beograd), "Koha Ditore" (Prishtinë), si dhe "Sloboden pečat" (Shkup). "Qytetarët dhe demokracitë e vërteta kanë nevojë për informacion të paanshëm. Urime", shkroi Pak. Ndryshe, objektivat kryesore të Asociacionit të Mediave të Evropës Juglindore do të jenë bashkëpunimi dhe mbështetja e ndërsjellë, trajnimi i përbashkët i punonjësve, shkëmbimi i përmbajtjes, qasje të koordinuar për organizmat dhe organizatat shtetërore dhe ndërkombëtare për të përmirësuar cilësinë e gazetarisë dhe për të përmirësuar kushtet dhe pozicionin e mediave në treg. Në këtë drejtim, në një të ardhme të afërm është planifikuar organizimi i një trajnimi të përbashkët për anëtarët e Asociacionit në segmentet e caktuara të biznesit (shitjes, marketingut, video produksionit, e-paper, etj.), dhe organizimi i një konference të madhe vjetore tematike në një prej qendrave rajonale, në të cilën do të ftohen të gjitha mediat relevante të rajonit, BE, ekspertët e kësaj fushe, liderë politik, përfaqësues të shoqatave profesionale nga rajoni dhe BE-ja. Kryetari i parë i Kuvendit të Asociacionit është zgjedhur Zheljko Ivanoviç nga "Vijesti". Ndryshe, Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Podgoricë ka mbështetur këtë ide duke njohur rëndësinë e saj për bashkësinë e mediave të rajonit të Evropës Juglindore, ndërsa së shpejti në të gjitha mediat themeluese të Asociacionit, OSBE do të shpallë edhe konkurs shpërblyes, në të cilin studentët e dizajnit do të ftohen të parashtojnë zgjidhje për logon e Asociacionit



## NDRYSHOHET LIGJI PËR SIGURI NË KOMUNIKACION



# SHOFERËT, 17 VITE MINIMUM

Shoferët-fëmijë, siçi kategorizojnë nga Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacion, që posedojnë lejen e vozitjes të kategorisë "B", nuk guxojnë të drejtojnë veturë nga ora 20:00 deri 05:00. Shfuqizohet kriteri për suksesin e kandidatit në shkollë

vimet të patentë shoferit, nuk duhet të dorëzojnë vërtetim nga psikologu apo pedagogu i shkollës ku janë të regjistruar. Nga ana tjetër kushtet themelor që duhet përmbushur mbesin të njëjta, gjegjësisht nxënësi i shkollës së mesme i cili ka mbushur 17 vite duhet të disponon me letër njoftim, të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht, të ketë pajtim e dy prindërve i cili duhet nostrifikuar në noter. Shoferët-fëmijë, siçi i kategorizojnë nga Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacion, që posedojnë lejen e vozitjes të kategorisë "B", nuk guxojnë të drejtojnë veturë mes orës 20:00 deri 05:00. Ose, të njëjtit gjatë kësaj periudhe mund të vozisin veturë, vetëm nën shoqërimin e njërit prej prindërve, i cili po ashtu ka patentë shoferin, gjegjësisht ndaj tij mos të jetë i shqiptuar ndonjë sanksion për kundërvajtje, në këtë rast ndalesë për drejtim të automjetit. Shpejtësia maksimale të cilët "shoferët-fëmijë", mund ta ngasin një veturë, nuk i tejkalon 60 kilometrat në orë në rrugët publike, apo nga 80 deri në 100 kilometra në orë në autostradë. Fuqia e motorit të veturës, mes tjerash theksohet në Ligji për siguri në komunikacionin, rrugor nuk duhet të jetë më tepër se 77 kuaj fuqi, gjegjësisht kësaj kategorie të shoferëve ju ndalohet drejtimi i automjeteve jashtë territorit të Maqedonisë.

"Një numër shumë i madh i fëmijëve që kapen për timonin e veturave, janë të moshës 15, 16 apo 17 vjeç. Arsyja për shfaqjen e kësaj dukurie është dëshira e madhe për tu eksponuar para

të tjerëve, me theks të posaçëm para shoqërisë. Kjo ndodhë përkundër faktit se ato nuk i kanë aftësi elementare për të drejtuar një veturë, dhe aq më pak kanë njohuri për kushtet ligjor që duhet t'i plotësojnë për drejtim të automjetit. Shpesh herë ndodhë që fëmija të drejton veturë, ndërkohë prindi i tij është i ulur në karrigen tjetër dhe në këtë mënyrë mburret me fëmijën e tij, duke mos pasur parasysh gabimin e madh që e bën", theksojnë nga KRSK-ja.

Raportet e këtij institucioni shtetëror i cili kryesisht merret me edukimin dhe ngritjen e vetëdijes qytetarë për sigurinë në komunikacion, kanë konstatuar se pjesa dërmuese e aksidenteve në komunikacion ndodhin në mjediset urbane.

Ndryshe, Sektori i Punëve të Brendshme në Tetovë, javë më parë bëri të ditur se gjatë vitit 2017 ka zbuluar 1908 raste të vozitjes së automjeteve të ndryshme, pa patentë shoferi. Mesatarisht sipas tyre janë hasur nga 150 shoferë "ilegalë", respektivisht nga pesë në ditë. Ata kanë vozitur vetura, por edhe furgona, kamionë e minibusë. Disa nga këto shofer "ilegal" kanë qenë edhe pjesë e transportit publik. Shqiptimi i gjobave dhe sanksioneve, ka vërtetuar se bëhet fjalë për shofer të të moshave 15, 16 por edhe 35 e deri 40 vjeçare. Pjesë e të evidentuarve, njëherit kanë qenë edhe persona të cilët i kanë përsëritur shkelje ligjore, thënë ndryshe mbi 1500 raste janë hasur kur vetura nuk ka qenë e regjistruar, me çka janë shqiptuar gjoba nga 100 deri më 500 euro.

## KRONIKË

## Policia kërkon maniakun e parkun të qytetit

Një burrë dyzetvjeçar dje pasdite në Parkun e qytetit te diskotekat seksualisht ka ngacmuar dy vajza. Rastin e ka paraqitur në polici S.M. (19) nga Shkupi në orën 18 e 15 minuta, ndërsa ka ndodhur në orën 16 derisa ka qenë duke u shëtitur së bashku me shoqen e saj nëpër Parkun e qytetit, në afërsi të diskotekave. Në kumtesën citohet se në një moment ajo ka vërejtur një burrë, të moshës rreth 40 vjeç, i cili së pari u është afruar dhe i ka pyetur nëse duan të njoftohen. Pasi e kanë refuzuar është afruar pas stolit ku kanë qenë të ulura, pas së cilës denoncuesja dhe shoqja e saj e kanë vërejtur se si vetëkënaqet. S.M. dhe shoqja e saj janë ngritur dhe kanë shkuar drejt diskotekave, por personi ka shkuar pas tyre, pas çka menjëherë janë paraqitur në numrin e telefonit 192, ndërsa pas një kohe të shkurtër personi ka shkuar. Po ndërmerren masa për zbardhjen e rastit dhe gjetjen e autorit.

## 15 të lënduar në Radovish

Pesëmbëdhjetë persona janë lënduar mbrëmë në një aksident që ka ndodhë në rrugën Strumicë-Radovish. Aksidenti ka ndodhur rreth orës 19 dhe në të kanë marrë pjesë shtatë automjete - gjashtë automobila dhe një kamion. Ngjarjen e kanë konfirmuar edhe nga SPB Strumicë, prej ku informuan se ka pasur shumë të lënduar, por vetëm dy janë dërguar në spitalin e Strumicës. Sipas doktor Goshko Goshev, shefi i Repartit kirurgjikal pranë spitalit, tek ata janë sjellë dy udhëtarë. Njëri është ndaluar në egzaminim të mëtutjeshëm dhe përcjellje të gjendjes së tij shëndetësore, ndërsa i dyti pas ndihmës së dhënë është lëshuar në shtëpi. Nga policia e Strumicës më shumë hollësi për aksidentin paralajmërojnë për më vonë.

## Ka ikur nga shtëpia, e kanë paraqitur pas dy javësh

Në stacionin policor Bit Pazar në Shkup, të mërkurën në orën 15:00 shkupjani R.M. (62) ka paraqitur se më 16 janar rreth orës 17:00 nga shtëpia e tij, në drejtim të panjohur, është larguar djali i tij I.M. (30). Policia ndërmerr masa për gjetjen e personit, zhdukja e të cilit është paraqitur madje pas dy javësh.

## I plagosuri me armë zjarri ishte sulmuar nga dy persona

Shkupjani A.T, i cili pasditen e djeshme në orën 15:15 ishte plagosur me armë zjarri në Çair është sulmuar nga dy persona. Ministria e Punëve të Brendshme sot kumtoi se njëri ndër sulmuesit me një objekt të fortë e ka goditur 41 vjeçarin në shpinë, ndërsa sulmuesi tjetër me armë zjarri ka gjuajtur disa plumba në pjesën e poshtme të trupit të tij. Menjëherë pastaj personat e kanë braktisur vendin e ngjarjes që ka ndodhur në udhëkryqin e rrugëve "Nikolla Maleshovski" dhe "Blagoja Paroviq", në afërsi të drejtpërdrejtë të objektit në ndërtim. A.T. me automjet është transferuar në Klinikën për Sëmundje Kirurgjikale "Shën Naumi i Ohrit" ku i janë konstatuar këndime të rënda trupore. "Për shkak të seriozitetit të lëndimeve, A.T. me automjet të Ndhmës së Shpejtë është transferuar në Qendrën Klinike "Nënë Tereza". Ekipi hetimor nga SPB Shkup ka kryer ekspertizë dhe punohet në ndriçimin e plotë të rastit", informon MPB.

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 1 shkurt - Qytetarët, të cilët në të ardhmen dëshirojnë të pajisen me patentë shoferi, duhet t'i kenë mbushur minimum 17 vite. Ndryshimet e fundit të Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor, janë bërë në drejtim të rritjes së moshës minimale nga 16 në 17 vite. Plotësimi shtesë që i është bërë këtij ligjit, është shfuqizimi i kriterit për suksesin e kandidatit në shkollë, i cili deri më tani ishte indikator kyç për marrjen e lejes për vozitje të kategorisë "B". Gjithashtu kandidatët e ri për marrjen e patentë shoferit në Qendrën për pro-



DERI NJË MILIARDË EURO NË VIT VIJNË NGA JASHTË MAQEDONISË

# DIASPORA SHPËTON SHTETIN

Ministri për Diasporën, Edmond Ademi, thotë se shifrat e fundit tregojnë për rreth 460 milionë euro në nivel vjetor, mjete këto që vijnë nga remitencat e diasporës. "Këto janë mjete që hyjnë nëpërmjet sistemit të bankave apo 'money transfere'. Mirëpo, jozyrtarisht - meqë kemi edhe kesh, janë diku 800 milionë, madje disa vite edhe në 1 miliardë euro kanë arritur...", thotë Ademi



burimi i vetëm i të ardhurave të tyre dhe ndikojnë dukshëm në standardin e jetesës. Të hyrat nga jashtë, që zyrtarisht janë mbi 400 milionë euro në vit dhe jozyrtarisht ndonjëherë arrijnë shifrën prej 1 miliardë euro, sipas ministrit për Diasporën, Edmond Ademi, janë injeksion i fuqishëm për ekonominë e vendit.

"Të dhënat formale nga remitencat që vijnë nga diaspora lëvi-

zin nga viti në vit, mirëpo shifrat e fundit janë diku 460 milionë euro në nivel vjetor. Bëhet fjalë për remitencat që kanë hyrë në Republikën e Maqedonisë nëpërmjet sistemit të bankave apo 'money transfere'. Mirëpo, jozyrtarisht meqë kemi edhe kesh që hyn në Maqedoni - janë diku 800 milionë, madje disa vite edhe në 1 miliardë euro kanë arritur... që do të thotë që është një injeksion

shumë i madh financiar dhe që e ndihmon ekonominë e Maqedonisë dhe mu për këtë shkak, mendojmë dhe vlerësojmë se është me rëndësi që diaspora të kyçet në gjithë proceset e shtetit, sepse në njëfarë mënyre përkrah ekonominë e vendit çdo vit me remitencat që i dërgojnë në Maqedoni", tha për gazetën KOHA, ministri Ademi. Jozyrtarisht, mbi 500 mijë qytetarë të Maqedonisë jetojnë jashtë - në vende të ndryshme të botës, tha më tej Ademi. "Për fat të keq, nuk e dimë sa diasporë kemi... kalkulojmë me numra të ndryshëm, mirëpo informatat janë se midis 500 mijë apo 600 mijë janë jashtë vendit. Sidoqoftë, sot në një kohë kur bota është globale, lëvizjet janë të përditshme në vende të ndryshme dhe nuk është aq lehtë të definohet ku saktë sa janë. Është një çështje që duhet ne si shtet dhe Qeveri të dimë, dhe mendojmë se është proces që duhet të realizohet, mirëpo është proces që zgjat, pra nuk mundet brenda gjashtë muajve apo një viti ti numërosh. Sepse, ke persona që shkojnë për 1, 2, 3 muaj dhe kthehen, ka persona që shkojnë për 6 muaj e kthehen, ka kategori të ndryshme që duhet shikuar në gjitha aspektet", u shpreh Ademi për KOHA.

## Deri më 15 mars të paraqiten të ardhurat shtesë

Shkup, 1 shkurt - Drejtorja për të Ardhura Publike ju bën thirrje qytetarëve deri më 15 mars të paraqesin të ardhurat vjetore tatimore nëse në vitin 2017 kanë realizuar të ardhura shtesë në vend dhe jashtë vendit. Siç informojnë, duhet të paraqiten të ardhurat e realizuara në bazë të çmimeve, bonuseve dhe kompensimeve tjera nga marrëdhënia e punës, qirave (dhënia e pronës - qira), të drejta autoriale dhe të drejta nga pronësia industriale, dividendët, pjesëmarrje në përfitime dhe interese nga huat të dhëna personave fizikë dhe juridikë, përfitime kapitale nga shitja e pjesëmarrjes në kapital dhe pronë të patundshme, përfitime nga lojërat e fatit, lojërat elektronike të fatit, lojëra shpërblyese dhe lojëra interaktive të fatit në vlerë më të lartë se 5.000 denarë sipas fitimit individual, të ardhurave nga lojërat e fatit përmes faqeve të huaja të specializuara në internet, të ardhura nga interneti për shembull e-tregti, shërbime të kryera përmes faqeve të specializuara, parashikime - rezultate të ekipeve për ndeshje sportive, të ardhura personale nga jashtë vendit për aktivitete lidhur me punën në Maqedoni, angazhimi i punës në ambasadë, në organizata ndërkombëtare... dhe lloje tjera shtesë të të ardhurave, të realizuara jashtë pagës ose pensionit të rregullt. Paraqitja e të ardhurave vjetore tatimore mund të merret nga ueb faqja e DAP-it dhe të dorëzohet në sportelet tatimore, përmes postës ose në mënyrë elektronike. Nga Drejtorja përkujtojnë se me qëllim të përshtatjes në kohë të mënyrës së re të paraqitjes, llogaritja dhe pagesa e tatimit personal mbi të ardhurat që çdo qytetar të regjistrohet në sistemin e-Tatimi personal.

Koha Aida XHONI

Shkup, 1 shkurt - Remitencat nga diaspora që marrin qytetarët e vendit luajnë rol të rëndësishëm në gjendjen ekonomike dhe sociale të qytetarëve. Madje, në shumë familje remitencat janë

## Prokuroria do ta zbardh rastin e vdekjes së lehonës

Shkup, 1 shkurt - Vendimi i Prokurorisë Publike në lidhje me rastin e lehonës në një institucion shëndetësor privat, konkretisht në spitalin private "Sante Plus" në Shkup do të sillet pas grumbullimit të dokumentacionit të nevojshëm

dhe pas marrjes së protokollit të autopsisë prej Institutit për Mjekësi Ligjore. "Gjatë ditës së djeshme në Prokurorinë Publike Themelore Shkup erdhi njoftim prej SPB Shkup lidhur me vdekjen e lehonës në një institucion privat

shëndetësor në Shkup. Prokurori publik kompetent nga Prokuroria Publike Themelore sollti urdhra për grumbullimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe të dhënave", kumtoi Prokuroria Publike. Pas shqyrtimit dhe analizës së ma-

terialit të mbërritur dhe pas marrjes së protokollit të obduksionit nga Instituti për Mjekësi Ligjore, deontologji kriminaliste dhe mjekësor, siç është theksuar në kumtesë, do të sillet vendim i prokurorial.

## RRITET NUMRI I TË INFEKTUARVE

### 1085 të sëmurë nga gripit

Shkup, 1 shkurt - Gjatë javës së kaluar (nga 22 janari deri më 28 janar), në Maqedoni janë regjistruar 1085 të sëmurë nga gripit, që është rritje për 70 për qind krahasuar me javën para saj kur ishin regjistruar 637 persona të sëmurë, citohet në raportin që në ueb faqen e saj e publikoi Instituti për shëndet publik. Në krahasim me sezonin e kaluar kur ishin regjistruar 1.919 raste, ekziston zvogëlim për nëntë për qind nga numri i të sëmurëve në javën e katërt të vitit. Incidenca e regjistruar këtë javë për herë të parë këtë sezon është mbi kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit, përkatësi-

sht është arritur pragu i hyrjes së sezonit të gripit. Në javën e katërt të vitit numri më i madh i të sëmurëve - 699 janë paraqitur te grupi më i madh i të rriturve prej 15-64 vite, ndërsa incidencë më e lartë prej 71,7 në 100.000 banorë u regjistrua te fëmijët e moshës prej 5-14 vjet. Këtë javë numri më i madh i personave të sëmurë - 292 dhe incidenca më e lartë 243,8 në 100.000 banorë është paraqitur nga rajoni i Njesisë rajonale Gostivar. Prej gjithsej 31 njësive rajonale në vend, në rajonin e njësive rajonale Gostivar dhe Dibër regjistrohet aktiviteti i mesëm, i rajonit të nëntë qendrave për shëndet pu-

blik/njësi rajonale regjistrohet aktiviteti i ulët (sezonal) në 11 njësi rajonale regjistrohet aktiviteti shumë i ulët i virusit të gripit, ndërsa nëntë njësive rajonale të tjera këtë javë nuk kanë paraqitur të sëmurë nga gripit/ sëmundje të ngjashme me gripin. Deri tani në sezonin 2017/2018 numri i tërësisëm i rasteve të paraqitura me sëmundje të ngjashme të gripit arrin 3.478. Numri i regjistruar i rasteve është shumë më i vogël në krahasim me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar kur ka pasur 32.934 të sëmurë. Gjithsej në këtë sezon, janë paraqitur persona të sëmurë nga 25 qendra për shëndet



publik/njësi rajonale. Deri tani, numri më i madh i personave të sëmurë - 887 janë regjistruar në NJR Gostivar dhe 413 në QSHP Te-

rovë, ndërsa incidencë më e madhe prej 1.091,7 në 100.000 banorë është regjistruar në rajonin e NJR Dibër.



## SHKATHËSIA E LEXIMIT


Një hulumtim i kryer nga fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore në Maqedoni, i realizuar më 8 mijë nxënës të 336 shkollave fillore, tregon se nxënësit shqiptarë janë më të shkathët në lexim krahasuar me nxënësit maqedonas dhe turq. Pra, shqiptarët lexojnë më shumë shkronja të sakta dhe me tepër fjalë pa gabime se sa nxënësit e tjerë. Por, pavarësisht kësaj, të gjithë janë shumë larg standardeve ndërkombëtare të leximit të rrjedhshëm dhe me logjikë, gjë e cila vërtetohet edhe me testimet ndërkombëtare PISA

Koha Laura PAPANIKU

*Shkup, 1 shkurt* - Me gjithë rezultatet e dobëta që kanë treguar në vazhdimësi nxënësit tanë nëpër testimet ndërkombëtare të matjes së njohurive, në Maqedoni nuk është bërë ende diçka konkrete për të gjetur shkaqet kryesore dhe për të rekomanduar propozimet për zgjidhjen e problemit. Hulumtime të mirëfillta shkencore, të ndërmarra nga institucione shtetërore, konkretisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) mungojnë sot e kësaj dite, pa çka se dy herë radhazi, PISA 2013 dhe PISA 2015 e radhiti Maqedoninë në mesin e tre-katër vendeve të fundit në botë. Kështu, nga testimet e fundit për nivelin e diturive për shkencë, lexim dhe matematikë në mesin e 70 vendeve në botë, Maqedonia u rangua në vendin e 67 për shkencë dhe lexim dhe në vendin 66 për matematikë.

Organizata Qytetare "Finance Think", duke vlerësuar rezultatet në fjalë konsideronte se dominimi i metodave tradicionale me të cilat mësimdhënësit janë përcjellës të dijeve kurse nxënësit pranues pasiv, janë një prej arsyeve që i kanë lënë kaq prapa nxënësit e Maqedonisë. Testimet me nxënësit e moshës 15 vjeçare, kishin treguar se vetëm 1 për qind e tyre kanë arritur të shkëlqyeshme në të paktën një lëndë, ndërsa mbi 52 për qind kanë rezultatet të dobëta në të gjitha lëndët.

Këtë gjetje janë krejtësisht të kundërta me suksesin që kanë nxënësit tanë nëpër dëftesat e tyre, gjë që tregon edhe për cilësinë ja-



# NXËNËSIT SHQIPTARË PARA ATYRE MAQEDONAS DHE TURQ

shtëzakonisht të dobët të vlerësimet të nxënësve në Maqedoni. Mirëpo, pavarësisht kësaj, shkollat kanë ngecur në vend sa i takon transformimit dhe krijimit të kushteve për mësim cilësor. Për më tepër mungojnë edhe hulumtime gjithëpërfshirëse të iniciuara nga MASH-i. Gati se çdo herë analizat kufizohen në hulumtime të organizatave jo qeveritare. Kështu, një hulumtim i Fondacionit për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore në Maqedoni, ka sjellë gjetje interesante që flasin në mënyrë të drejtpërdrejtë për performancat e leximit të nxënësve sipas gjuhës në të cilën e zhvillojnë mësimin. Hulumtimin në nivel nacional, i realizuar në vitin 2016 dhe ku ishin

të përfshirë 8 mijë nxënës të 336 shkollave fillore (në klasë të dytë, të tretë dhe të katërt), edhe pse shumë larg standardit ndërkombëtar, tregon se nxënësi shqiptarë janë më të shkathët në lexim se nxënësit maqedonas dhe turq. Matjet përsaktësinë e leximit tregojnë se te nxënësit që mësojnë në gjuhën maqedonase, në klasë të dytë, të tretë dhe të katërt tregojnë se mesatarja e shkronjave të lexuara saktë në një minutë është 78, 88 dhe 104. Ndërkaq, te nxënësit që mësojnë në gjuhën shqipe e njëjta mesatare është 84, 96 dhe 106 shkronja, kurse te nxënësit turq 77, 95 dhe 103. Në nivel nacional, nxënësit shqiptarë qëndrojnë më mirë edhe në fjalë të

lexuara saktë në leximin e tregimeve edhe atë me 47, 70 dhe 89 për dalim prej maqedonasve të cilët kanë mesatare prej 44, 68 dhe 94 apo të turqve të cilët janë ende më poshtë me 27 dhe 47 fjalë. Por pavarësisht kësaj, si shqiptarët ashtu edhe maqedonasit dhe turqit janë shumë larg standardeve ndërkombëtare. Fjalët e lexuara saktë në tregim, në Shtete e Bashkuara të Amerikës, sipas këtij hulumtimi janë nga 47 deri 53 fjalë në klasë të dytë, nga 72 deri 89 në klasë të tretë dhe nga 92 deri në 107 në klasë të katërt.

Megjithatë ngecjet më të mëdha vërehen tek të lexuarit me kuptim. Nëse me standardin

ndërkombëtar një nxënës llogaritet se lexon me logjikë në rastet kur është në gjendje t'iu përgjigjet 80 për qind të pyetjeve të parashtruara, këto përqindje në Maqedoni janë shumë më të ulëta. Hulumtimi i Fondacionit për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore, tregon se te nxënësit e klasave të dyta saktësia e përgjigjeve të dhëna nuk kalon 40 përqindëshin për maqedonasit, 35 për shqiptarët dhe 20 për turqit. Në klasë të tretë kemi 60 për qind për maqedonasit, 55 për shqiptarët dhe 40 për turqit. Ky hulumtim, edhe pse me fëmijë të moshës nga 7 deri në 10 vjet, konfirmon rezultatet e testeve PISA që bëhen me nxënës të moshës 15 vjeçare.

## SHTYHEN EMËRIMET NË INSTITUCIONET E KULTURËS

Shumë ushtrues detyre do të vazhdojnë të mbajnë po ato pozicione deri në ndryshimin e statusit të institucionit, që duhet të harmonizohet me ndryshimet e miratuara një javë më parë në Ligjin e Kulturës. Po ashtu, partnerët e koalicionit ende nuk e kanë vendosur se cilat drejtori do të udhëhiqen nga kuadro shqiptarë

## S'ka drejtorë pa u ndryshuar statutet

Koha Evis HALILI

*Shkup, 1 shkurt* - Emërimet në postet drejtuese në institucionet e kulturës do të shtyhen sërish. Shumë ushtrues detyre do të vazhdojnë të mbajnë po ato pozicione deri në ndryshimin e statusit të institucionit, që duhet të harmonizohet me ndryshimet ligjore të miratuara një javë më parë nga Parlamenti. Po ashtu, partnerët e koalicionit ende nuk e kanë vendosur se cilat drejtori do të udhëhiqen nga kuadro shqiptarë. Në Ministrinë e Kulturës nuk kanë ndonjë informacion për numrin e drejtorëve tek të cilat synohet të emërohen kuadro shqiptarë. Si institucione më kryesore që aktualisht drejtohen nga kuadro shqiptarë janë Qendra Nationale e Konservimit, Ga-

leria Nationale, Galeria e Tetovës, Qendra e Konservimit në Gostivar, e të tjera. Kësaj liste mund t'i shtohet Muzeu Arkeologjik, ndërsa për drejtorin e tjerë, si Qendra memoriale e Nënë Terezës, Teatri i fëmijëve dhe të rriturve që është pretenduar në vite se do të drejtohen nga shqiptarë duket se kanë dalë nga lista. Në Ministrinë e Kulturës vonesat në shpalljen e konkurseve i arsyetojnë me ndryshimet e kriterëve të konkurimit. Sipas tyre, pjesa më e madhe e institucioneve, mbi 60, do të vazhdojnë të funksionojnë me drejtorët aktualë, ose me të tjerë, në rastin e skadimit të mandateve.

"Konkurset do të shpallen atëherë kur edhe çdo institucion do të ndryshojë statusin, i cili duhet të jetë në përputhje me ndryshimet e

bëra në Ligjin për Kulturë dhe kriteret e reja për emërimet. Deri sa të bëhet ky proces drejtorët aktualë do të vazhdojnë të jenë në ato poste, në rast se skadojnë mandatet, do të emërohen të rinj, ose atyre aktualë do t'i zgjaten mandatet", thotë këshilltari i ministrit të kulturës, Petrit Saraçini. Një prej institucioneve që i ka adaptuar ndryshimet ligjore është Drejtoria e Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore, e cila ka shpallur konkurs për emërimin e një drejtorit të ri (drejtohet nga ushtrues detyre). Shumë institucione kryesore të kulturës që prej shkarkimeve të disa kohëve më parë prej më shumë se gjashtë muaj udhëhiqen nga ushtrues detyre, mes të cilëve ka edhe nga ato që kanë dhënë dorëheqje, siç ishte rasti i drejtorit (ushtrues

detyre) i Teatrit Nacional, Dragan Spasov, dorëheqja e të cilit një ditë më parë u miratua nga Ministria e Kulturës. Sa i takon drejtorëve shqiptarë në institucione si Galeria Nationale, Qendra Nationale e Konservimit, Teatri Shqiptar, Galeria e Tetovës nuk janë paralajmëruar ndryshime dhe gjasat janë që këto poste të vazhdojnë t'i mbajnë kuadrot e njëjtë. Fillimisht konkurset për emërimin e drejtuesve të rinj u shtynë për shkak të ciklit të zgjedhjeve lokale. Ndërsa shkarkimet nga postet e drejtorëve nisën në muajin korrik, të parët u shkarkuan drejtorët e Teatrit të Komedisë, Teatrit të fëmijëve, Muzeut të Maqedonisë, e të tjerë. Po ashtu, emërimet e reja priten edhe në drejtorin e tjerë, si Mbrëmjet e poetike të Strugës, Vera e Ohrit.



Në bazë të nenit 24 në lidhje me nenin 37 të Ligjit për shfrytëzim dhe posedim të mjeteve në pronësi të shtetit dhe të mjeteve në pronësi të komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15, 106/15, 153/15 dhe 190/16), ndërsa në pajtim me Raportin për vlerësimin e realizuar të Byrosë për ekspertiza gjyqësore SV V 134/17, të datës 15.12.2017, Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, publikon

#### SHPALLJE nr. 01/2018

**Të shpalljes për dhënie me qira të pronës së patundshme në Shkup – 16 (gjashtëmbëdhjetë) bife në pronësi të Republikës së Maqedonisë për mes ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK**

#### I. LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lëndë e ankandit publik elektronik është **dhënie me qira e pronës së patundshme me qëllim për ofrim të shërbimeve hotelerike – 16 (gjashtëmbëdhjetë) bife**, të cilat gjenden në objektet e ministrive dhe organeve të administratës shtetërore, për periudhë prej dy vjet.

#### II. TË DHËNAT PËR OBJEKTET E PATUNDSHME TË CILAT JEPEN ME QIRA

- Bife numër 1**, në Ministrinë për shoqëri informatike, në rr. "Sv. Kiril i Metodij" nr. 54, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 11613, KK Qendër 1, LP nr. 53637, në përdhese, me sipërfaqe prej 9 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 2**, në Agjencinë për barëra dhe mjete mjekësore, në rr. "Sv. Kiril i Metodij" nr. 54, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 11613, KK Qendër 1, LP nr. 53637, në katin 1, me sipërfaqe prej 24 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 3**, në Ministrinë e vetëqeverisjes lokale, në rr. "Sv. Kiril i Metodij" nr. 54, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 11613, KK Qendër 1, LP nr. 53637, në katin 2, me sipërfaqe prej 10,50 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 4**, në Komisionin shtetëror të zgjedhjeve, në rr. "Sv. Kiril i Metodij" nr. 54, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 11613, KK Qendër 1, LP nr. 53637, në katin 4, me sipërfaqe prej 4,80 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 5**, në Entin shtetëror të statistikave, në rr. "Dame Gruev" nr. 4, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 13478, KK Qendër 1, LP nr. 103028, në katin1, me sipërfaqe prej 16,14 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 6**, në Ministrinë e transportit, në rr. "Dame Gruev" nr. 6, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 13478, KK Qendër 1, LP nr. 103028, në katin 7, me sipërfaqe prej 54,52 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 7**, në Ministrinë e punës, në rr. "Dame Gruev" nr. 14-A, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 11943/1, KK Qendër 1, LP nr. 101656, bodrum, me sipërfaqe prej 94,76 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 8**, në Ministrinë e punëve të jashtme, në rr. "Filipi i dytë i Maqedonisë" nr. 7, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 13829/8, KK Qendër 1, LP nr. 55711, në katin 1, me sipërfaqe prej 339,10 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 9**, në Ministrinë e kulturës, në rr. "Gjuro Gjakoviq" nr. 61, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 9819, KK Qendër 1, LP nr. 53461, bodrum, me sipërfaqe prej 90,29 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 10**, në Ministrinë e bujqësisë, në rr. "Aminta Treti" nr. 2, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 5340/1 KK Qendër 1, LP nr. 106777, në përdhese, me sipërfaqe prej 69,140 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 11**, në Ministrinë e drejtësisë, na rr. "Dimitrie Çupovski" nr. 9, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 11952, KK Qendër 1, LP nr. 10092, në përdhese, me sipërfaqe prej 54,58 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 12**, në Ministrinë e ekonomisë, në rr. "Jurij Gagarin" nr. 15, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 3, KK Qendër 2, LP nr. 5210, në katin 2, me sipërfaqe prej 11,10 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 13**, në Qendrën për menaxhim me kriza, na rr. "Dimçe Mircev" nr. 9, Shkup, ndërtesa 1, hyrja 1, PK nr. 2499, KK Qendër 2, LP nr. 57255, në katin 4, me sipërfaqe prej 7 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 14**, në Sekretariatit për çështje evropiane, në rr. "Kej Dimitar Vlahov" nr. 4, Shkup, ndërtesa 2, hyrja 1, PK nr. 9521, KK Qendër 1, LP nr. 9099, në katin4, me sipërfaqe prej 8 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 15**, në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, në rr. "Kej Dimitar Vlahov" pn (objekti i RTVM), Shkup, ndërtesa 3, hyrja 1, PK nr. 12231, KK Qendër 1, LP nr. 9157, në katin 10, me sipërfaqe prej 13,65 m<sup>2</sup>;
- Bife numër 16**, në Shërbimin për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në Bul. "Kuzman Josifovski Pitu" nr. 17 (objekti QT Skopjanka), Shkup, PK nr. 315, KK Kisella Vodë 2, LP nr. 49418, në katin 2, me sipërfaqe prej 12 m<sup>2</sup>;

#### III. TË DREJTË PËR PJESEMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik kanë të gjitha palët e vendit dhe të huaja që pëmbushin kushtet në vijim:

- Të jetë i regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë që ka të bëjë me lëndën ankandit publik elektronik;
  - Në pesë vitet e fundit të mos u jetë shqiptuar vendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash;
  - Të mos u jetë shqiptuar dënim detyësor ndalesë për pjesëmarrje në procedura të thirrjes publike, ndarje të marrëveshjeve për furnizime publike dhe marrëveshje për partneritet publik-privat;
  - Të mos u jetë shqiptuar dënim detyësor ndalim i përkohshëm ose përhershëm për kryerje të veprimtarisë së veçantë;
  - Të mos jetë në procedurë të falimentimit dhe në procedurë për likuidim;
  - Të mos ketë të papaguara tatime, kontribute ose pagesa të tjera publike;
  - Të mos u jetë shqiptuar sanksion kundërvajtjeje – ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, ose ndalesë të përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë dhe të kenë së paku pesë të punësuar në momentin e parashtrimit të fletëparaqitjes;
  - Të ketë së paku 5 (pesë) të punësuar në momentin e parashtrimit të fletëparaqitjes;
- Nëse ofertuesi – subjekti i huaj juridik, në pajtim me dispozitat pozitive ligjore të vendit ku ka seli, nuk mund të parashtrorë ndonjë dokument për dëshmi të kushteve të kërkuara, mund të parashtrorë deklaratë të vërtetuar në organin kompetent.

#### IV. KUSHTET PËR PJESEMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK:

Subjektet e interesuara juridike parashtrorë **Fletëparaqitje elektronike për pjesëmarrje në ankandin publik**, në pajtim me kushtet e Shpalljes, që duhet të përmbajë të gjitha të dhënat dhe dëshmitë, që janë përcaktuar në shpallje për ankand publik elektronik, në internet faqen në vijim: <http://e-aukcii.finance.gov.mk>

Ofertuesit e interesuar, krahas fletëparaqitjes elektronike, parashtrorë dhe fletëparaqitje në formë të shkruar në zarf të mbyllur me shënim "mos hap" dhe me shenjë "për shpallje për dhënie me qira të pronave të patundshme numër 01/2018", të adresuar deri tek Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në bul. "Kuzman Josifovski Pitu" nr. 17, Shkup.

Fletëparaqitja duhet të jetë e plotësuar dhe nënshkruar me dorë nga personi përgjegjës ose i autorizuar nga ai (e bashkëngjitur të

parashtrorët edhe autorizimi), me të dhënat e përgjithshme të ofertuesit, personi për kontakt me numër telefoni **edhe e-mail adresë në të cilin do të parashtrorët emri përdorues dhe shifra për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik.**

Informacione shtesë për shumën e çmimeve të shërbimeve hotelerike, të përcaktuara nga ana e Shërbimit, ofertuesit e interesuar mund të marrin në Arkivin e Shërbimit, përmes personit përgjegjës ose i autorizuar prej tyre (në shtojcë të parashtrorët edhe autorizimi) i ofertuesit.

Së bashku me fletëparaqitjen parashtrorët shtojcë në vijim:

- Vërtetim për veprimtari të regjistruar, të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
  - Deklaratë se në 5 vitet e fundit ofertuesit nuk i është shqiptuar vendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash, të dhënë edhe nënshkruar me dorë nga vet personi përgjegjës i ofertuesit, jo më të vjetër se nga omenti i publikimit të shpalljes;
  - Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të kryera penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim detyësor ndalesë për pjesëmarrje në procedura për thirrje publike, ndarje të marrëveshjeve për furnizim publik dhe marrëveshje për partneritet publik-privat, të dhënë nga organi kompetent në vendin ku është regjistruar operatori ekonomik, ndërsa në Republikën e Maqedonisë organi kompetent për dhënie të këtij vërtetimi është Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se 6 muaj nga dita e publikimit të shpalljes;
  - Vërtetim të Regjistrin të dënimeve për vepra të kryera penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim detyësor ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerje të veprimtarisë së veçantë, të dhënë nga organi kompetent në vend ku është regjistruar operatori ekonomik, ndërsa në Republikën e Maqedonisë organ kompetent për dhënie të këtij vërtetimi është Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se 6 muaj nga dita e publikimit të shpalljes;
  - Vërtetime se nuk është hapur procedurë për falimentim dhe se nuk është hapur procedurë për likuidim, të dhënë nga organi kompetent në vendin ku është regjistruar operatori ekonomik, ndërsa në Republikën e Maqedonisë organ kompetent për dhënie të këtij vërtetimi është Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se 6 muaj nga dita e publikimit të shpalljes;
  - Vërtetim për tatime, kontribute dhe pagesa tjera publike të paguara nga organi kompetent i vendit ku është regjistruar operatori ekonomik, ndërsa në Republikën e Maqedonisë, organi kompetent për dhënie të këtij vërtetimi është Drejtoria për të hyra publike, jo më të vjetër se 6 muaj nga dita e publikimit të shpalljes;
  - Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë, të dhënë nga organi kompetent në vendin ku është regjistruar operatori ekonomik, ndërsa në Republikën e Maqedonisë organ kompetent për dhënie të këtij vërtetimi është Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se 6 muaj nga dita e publikimit të shpalljes;
  - Pasqyrë të regjistrimeve/çregjistrimeve si dëshmi se ka së paku 5 persona të punësuar, jo më të vjetër se nga dita e publikimit të shpalljes (02.02.2018), të dhënë nga Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë ose nëse bëhet fjalë për ofertues – person i huaj, nga organi kompetent nga vendi ku ka seli;
  - Gjendja aktuale e ofertuesit, të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
  - Ofertë e cila do të përmbajë të dhëna të sakta për të cilën patundshmëri ofertuesi do të licitojë;
  - Garanci bankare për seriozitet të ofertës në shumë prej 2% të vlerës së përgjithshme të vlerësuar për pronën e patundshme për të cilën liciton, me kohëzgjatje të së njëjtës prej 30 ditë nga dita e publikuar si afat përfundimtar për parashtrim të fletëparaqitjeve (12.02.2018);
- Shpallja zgjatë 10 (dhjetë) ditë kalendarike, duke filluar nga 02.02.2018 (e premte), deri më 12.02.2018 (e hënë).**
- Ankandi publik do të mbahet në mënyrë elektronike, në internet adresën në vijim: <http://e-aukcii.finance.gov.mk>**
- Ankandi publik do të realizohet më datë 14.02.2018 (e mërkurë).**

#### V. ÇMIMI FILLESTAR I QIRASË, SHUMA E GARANCISË BANKARE DHE TERMINI I ANKANDIT PUBLIK

- Çmimi fillestar i qirasë mujore pa TVSH të përfshirë është:
- Bife nr. 1**
    - Shuma e qirasë mujore është **2.511,00 denarë**;
    - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 502.200,00 denarë;
    - Garancia bankare prej 2% është **10.044,00 denarë**;
    - Ankandi publik do të fillojë në ora 09:00 dhe zgjatë deri në ora 09:15;**
  - Bife nr. 2**
    - Shuma e qirasë mujore është **6.336,00 denarë**;
    - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 1.267.200,00 denarë;
    - банкарската гаранција од 2% изнесува **25.344,00 denarë**;
    - Ankandi publik do të fillojë në ora 09:30 dhe zgjatë deri në ora 09:45;**
  - Bife nr. 3**
    - Shuma e qirasë mujore është **2.940,00 denarë**;
    - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 588.000,00 denarë;
    - Garancia bankare prej 2% është **11.760,00 denarë**;
    - Ankandi publik do të fillojë në ora 10:00 dhe zgjatë deri në ora 10:15;**
  - Bife nr. 4**
    - Shuma e qirasë mujore është **1.544,00 denarë**;
    - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 308.800,00,00 denarë;
    - Garancia bankare prej 2% është **6.176,00 denarë**;
    - Ankandi publik do të fillojë në ora 10:30 dhe zgjatë deri në ora 10:45;**
  - Bife nr. 5**
    - Shuma e qirasë mujore është **4.229,00 denarë**;
    - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 845.800,00,00 denarë;
    - Garancia bankare prej 2% është **16.916,00 denarë**;

- Ankandi publik do të fillojë në ora 11:00 dhe zgjatë deri në ora 11:15;**
- Bife nr. 6**
  - Shuma e qirasë mujore është **14.860,00 denarë**;
  - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 2.972.000,00 denarë;
  - Garancia bankare prej 2% është **59.440,00 denarë**;
  - Ankandi publik do të fillojë në ora 11:30 dhe zgjatë deri në ora 11:45;**
- Bife nr. 7**
  - Shuma e qirasë mujore është **23.134,00 denarë**;
  - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 4.626.800,00 denarë;
  - Garancia bankare prej 2% është **92.536,00 denarë**;
  - Ankandi publik do të fillojë në ora 12:00 dhe zgjatë deri në ora 12:15;**
- Bife nr. 8**
  - Shuma e qirasë mujore është **95.965,00 denarë**;
  - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 19.193.000,00 denarë;
  - Garancia bankare prej 2% është **383.860,00 denarë**;
  - Ankandi publik do të fillojë në ora 12:30 dhe zgjatë deri në ora 12:45;**
- Bife nr. 9**
  - Shuma e qirasë mujore është **21.750,00 denarë**;
  - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 4.350.000,00 denarë;
  - Garancia bankare prej 2% është **87.000,00 denarë**;
  - Ankandi publik do të fillojë në ora 13:00 dhe zgjatë deri në ora 13:15;**
- Bife nr. 10**
  - Shuma e qirasë mujore është **20.327,00 denarë**;
  - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 4.065.400,00 denarë;
  - Garancia bankare prej 2% është **81.308,00 denarë**;
  - Ankandi publik do të fillojë në ora 13:30 dhe zgjatë deri në ora 13:45;**
- Bife nr. 11**
  - Shuma e qirasë mujore është **16.356,00 denarë**;
  - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 3.271.200,00 denarë;
  - Garancia bankare prej 2% është **65.424,00 denarë**;
  - Ankandi publik do të fillojë në ora 14:00 dhe zgjatë deri në ora 14:15;**
- Bife nr. 12**
  - Shuma e qirasë mujore është **3.308,00 denarë**;
  - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 661.600,00 denarë;
  - Garancia bankare prej 2% është **13.232,00 denarë**;
  - Ankandi publik do të fillojë në ora 14:30 dhe zgjatë deri në ora 14:45;**
- Bife nr. 13**
  - Shuma e qirasë mujore është **1.960,00 denarë**;
  - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 392.000,00 denarë;
  - Garancia bankare prej 2% është **7.840,00 denarë**;
  - Ankandi publik do të fillojë në ora 15:00 dhe zgjatë deri në ora 15:15;**
- Bife nr. 14**
  - Shuma e qirasë mujore është **2.144,00 denarë**;
  - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 428.800,00 denarë;
  - Garancia bankare prej 2% është **8.576,00 denarë**;
  - Ankandi publik do të fillojë në ora 15:30 dhe zgjatë deri në ora 15:45;**
- Bife nr. 15**
  - Shuma e qirasë mujore është **3.775,00 denarë**;
  - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 755.000,00 denarë;
  - Garancia bankare prej 2% është **15.100,00 denarë**;
  - Ankandi publik do të fillojë në ora 16:00 dhe zgjatë deri në ora 16:15;**
- Bife nr. 16**
  - Shuma e qirasë mujore është **3.084,00 denarë**;
  - Çmimi i përgjithshëm i vlerësuar i objektit është 616.800,00 denarë;
  - Garancia bankare prej 2% është **12.336,00 denarë**;
  - Ankandi publik do të fillojë në ora 16:30 dhe zgjatë deri në ora 16:45;**

**VI. AFATI PËR PARASHTRIMIN E FLETËPARAQITJEVE**

Fletëparaqitjet elektronike për pjesëmarrje në ankandin publik mund të parashtrorën deri më 12.02.2018 deri në mesnatë.

Fletëparaqitjet e shtypura me tërë dokumentacionin e bashkëngjitur parashtrorën në Arkivin e Shërbimit, në adresën: **Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, bul. "Kuzman Josifovski Pitu" nr. 17, Shkup**, deri më 12.02.2018, më së voni deri në ora 16.30.

#### VII. PROCEDURA

Komisioni kryen evaluimin e fletëparaqitjeve të arritura, më së voni deri më 13.02.2018;

Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me të gjitha dëshmitë të theksuara në fletëparaqitje, do të refuzohen dhe nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për çka do të informohen në mënyrë elektronike.

Ofertuesve me fletëparaqitje të kompletuara me dëshmitë e nevojshme për pëmbushje të kushteve të kërkuara, u dërgohet emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, në e-mail adresë të cilën janë të obliguar ta shënojnë në fletëparaqitje.

Ankandi publik fillon me publikimin e çmimit fillestar të qirasë mujore për secilën Bife veç e veç dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve.

Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik.

Pjesëmarrësit kanë të drejtë për Ankesë vetëm përmes procedurës për ankand publik deri tek Komisioni pranë Shërbimit në afat prej 24 (njëzetkatër) orë nga mbajtja e ankandit publik.

Për ofertues më të volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi i cili ka ofruar çmimin më të lartë të qirasë dhe me atë lidhet Marrëveshje për qira për shërbimet hotelerike.

Shpenzimet për solemnizim të marrëveshjes bien mbi qiramarrësin.



Që nga fillimi i vitit janë duke u realizuar edhe aksione të përforcuara në komunikacion nga ana e pjesëtarëve të policisë, ku kontrollohet shpejtësia, rregullshmëria teknike, parkimi dhe drejtimi i automjetit nën ndikim të alkoolit, si dhe skadimi i regjistrimit

RRUGËT RAJONALE ENDE TË RREZIKSHME

POLICIA

MËNJANON

“PENGESAT”

RRUGORE



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 1 shkurt - Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë në koordinim me Stacionin për siguri në komunikacionin rrugor në Tetovë dhe me pushtetin lokal dhe ndërmarrjen publike Rrugët e Maqedonisë, pas analizave paraprake ka larguar dhjetëra pengesa në rrugë të cilët në mënyrë vullnetare janë vendosur në disa rrugë. “Këto pengesa kryesisht prej betoni në rrugë janë larguar në fshatrat Siničan, Tenovë dhe Pirok, ndërsa kjo do të bëhet edhe në shumë vende ku të njëjtat janë vendosur pa asnjë procedurë dhe dakordimin e nevojshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme në bazë të ligjit për siguri në komunikacionin rrugor”, njoftuan nga Policia. Nga ana tjetër, të njëjtat ishin vendosur nga ana e banorëve për shkak të sigurisë në rrugët regjionale në rajonin e Pollogut, ku dukshëm ishin shtuar edhe aksidentet. “I kemi vendosur para disa viteve për shkak të sigu-

risë së këmbësorëve, sepse në këto rrugë ka frekuencim të madh të automjeteve dhe shpeshherë kanë pësuar edhe fëmijët, të cilët shkojnë në shkollë përgjatë këtyre rrugëve. Me vendosjen e këtyre ndoshta edhe pa ndonjë rregull, por është ulur numri i aksidenteve me këmbësorë”, thonë banorët që jetojnë në këtë zonë. Krahas kësaj, rruga Tetovë-Pirok është kthyer në një rrugë mjaft të rrezikshme kohëve të fundit. Kësajsoj, rruga regjionale Tetovë-Pirok është bërë tmerr i vërtetë për vozitësit dhe këmbësorët. Kjo rrugë, e cila kalon përmes fshatrave të Tetovës dhe Komunës së Bogovinës gjatë këtij viti është shndërruar në arenë aksidentesh të cilët në shumë raste janë edhe të pazakonshme. Mure të thyera të shtëpive, shtylla elektrike të goditura, dëmtime të mureve të varrezave, shkelje të këmbësorëve, hyrje me veturë në burektore, dëmtim të reklamave

të pompës së benzinës... janë vetëm disa nga aksidentet që kanë ndodhur kohëve të fundit në këtë rrugë.

Pikërisht këto kishin qenë arsyet që ishin vendosur edhe pengesa rrugore për të ngadalësuar shpejtësinë e qarkullimit të automjeteve. “Fëmijët kanë vetëm një trotuar në njërin anë të rrugës për të lëvizur, por ata duhet që të kalojnë rrugën dhe janë në rrezik. Kërkojmë që organet policore dhe pushtetet lokale të marrin masa që të krijojnë siguri në këtë rrugë pasi që bëhet fjalë për një gjatësi prej 2 kilometrave që përfshinë fshatin tonë”, thotë Shuip Kadriu, kryetar i Bashkësisë Lokale të fshatit Pallçisht. Sipas policisë, mos respektimi i procedurës adekuate në kuadër të masave të veçanta për siguri në komunikacion sanksionohet me procedurë adekuate dhe dënimet janë nga 300 deri në 4000 euro. “Si shkaktarë të këtyre

aksidenteve janë mospërshtatja e shpejtësisë me kushtet në rrugë. Si rrugë më kritike, shikuar në aspektin e sigurisë, janë nga fshati Poroj deri në Tearcë dhe në rajonin Bërvenicë-Çellopek. Sa i përket gjendjes së rrugëve Tetovë-Pirok dhe Tetovë-Jazhincë, ajo vlerësohet e mirë, ndërsa rruga Tetovë-Vollkovijë, e krahasuar me këta të tjerat - dukshëm është më e vështirë, në një gjendje të palakmueshme, që poashtu ndikon negativisht në sigurinë dhe kontribuon në shkaktimin e aksidenteve”, tha Marrijan Josifovski, zëdhënës i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë. Krahas kësaj, në fillim të këtij viti janë duke u realizuar edhe aksione të përforcuara në komunikacion nga ana e pjesëtarëve të policisë, ku janë duke u kontrolluar shpejtësia, rregullshmëria teknike, parkimi dhe drejtimi i automjetit nën ndikim të alkoolit si dhe skadimi i regjistrimit.

## Shilegovi siguron: Uji nuk do të shtrenjtohet

Shkup, 1 shkurt - Kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov, mbetet në qëndrimin se derisa është në funksion nuk do të lejojë për shkaqe politike uji në Shkup të shtrenjtohet, si dhe se vendimi i Komisionit Rregullator është joparimor dhe i motivuar për arsye të tjera, e jo për nevoja reale. Thotë se derisa e udhëheq Qytetin nuk do ta zbatojë. Kërkesa për shtrenjtimin e ujit deri te Rregullatorja, e ka parashtruar udhëheqësia paraprake NP “Ujësbellësi”. Ai tha se analizat që i kanë bërë kanë treguar se me shkurtrimin e shpenzimeve joproduktive edhe pa shtrenjtimin e ujit mund të mirëmbahen sistemet, posaçërisht ato filtruese. “Realisht në Shkup nuk ka nevojë për rritje të çmimit, edhe pse ka ujë më të lirë”, tha Shilegov duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve pas nënshkrimit të Memorandumit për ndërtimin e filtruesve pranë Vardarit në rajonin qendror të qytetit. Kryetari i Shkupit thotë se kërkesën deri te Komisioni Rregullator për shtrenjtime më të mëdha nga ai që ky komision e ka miratuar si vendim, e ka parashtruar edhe ekipi menaxhues i udhëheqësia paraprake dhe jo ekipi i ri.



## UNDP, partner i rëndësishëm i MVL-së

Shkup, 1 shkurt - Ministri i Vetëqeverisje Lokale, Suhejl Fazliu, është takuar me përfaqësuesen e përhershme të UNDP-së në Republikën e Maqedoni, Luisa Vinton. Në takim, Vinton shprehu interesimin e UNDP-së për të vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë për Vetëqeverisje Lokale në avancimin e reformës në sistemin e vetëqeverisjes lokale dhe decentralizimit, si dhe në forcimin e kapaciteteve të Ministrisë për sigurinë e rolit koordinues në nivel horizontal dhe atë vertikal. Ministri Fazliu theksoi se e vlerëson lartë interesin e UNDP-së për vazhdimin e bashkëpunimit. UNDP është partner i përher-

shëm i Ministrisë në zbatimin e procesit të decentralizimit që nga fillimi dhe kuptohet se sfida e kësaj fushe do të vazhdojmë t'i zgjidhim bashkërisht, tha ministri Fazliu. Në takim u bisedua edhe për zbatimin e dy projekteve aktuale përmes së cilëve Ministria për Vetëqeverisje Lokale në bashkëpunim me UNDP është duke punuar për forcimin e kapaciteteve të komunave për përmirësimin dhe ofrimin e shërbimeve si dhe përmirësimin e sistemit të qeverisjes vendore, përmes vendosjes së sistemit për monitorimin e funksionimit të komunave, njofton Ministria e Vetëqeverisjes Lokale.



## Në Momin Potok për dy muaj janë përkujdesur 40 të pastrehë

Shkup, 1 shkurt - Në dy muajt e fundit, 40 të pastrehë janë përkujdesur në vendin e pranimit në Momin Potok të hapur për shkak të temperaturave të ulëta, ku kanë kaluar 692 net. “Në periudhën nga 6 dhjetori i vitit të kaluar deri më 31 janar të këtij viti për shkak të temperaturave ekstreme të ulëta është hapur Vendi i pranimit për bujtje, i cili ka strehuar të pastrehë nga ora 20:00 në mbrëmje deri në orën 08:00 të mëngjesit. Në këtë periudhë gjithsej janë realizuar 692 bujtje nga ana e 40 të pastrehëve të cilët njëherit kanë marrë edhe vakte me çaj të ngrohtë”, kumtoi Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit.

Nga gjithsej 692 bujtje, 610 bujtje janë realizuar nga ana e burrave dhe 28 bujtje nga ana e grave. Nga 40 personat e pastrehë të përkujdesur, 34 janë burra, ndërsa gjashtë janë gra. Prej tyre 11 persona për herë parë kanë ardhur në këtë pikë për t'i marrë gjërat e nevojshme të cilat iu mungojnë. Janë angazhuar edhe ekipet e cilat ishin 24 orë të

gatshëm për të reaguar në terren pas informacionit për persona të gjetur në rrugë në gjendje të rëndë shëndetësore nga ana e qytetarëve, policisë, ndihmës së parë mjekësore, qendrës klinike dhe të ngjashme. Në terren janë realizuar nëntë intervenime. “Gjatë valës së ftohtë Kryqi i Kuq ka angazhuar 42 vullnetarë nga Ekipi për përgjigje gjatë katastrofave, si dhe shtatë persona nga shërbimi profesional pranë pikës për të pastrehë në Momin Potok. Gjatë temperaturave ekstreme të ulëta në pikën për të pastrehë, katër restorante të Shkupit kanë dhuruar supë të ngrohtë për këtë grup personash, ndërsa numër i madh i personave privatë kanë ndihmuar me veshje të ngrohtë dhe ushqim për këtë kategori të cenushme”, thonë nga Kryqi i Kuq. Ata në punë kanë angazhuar tre të pastrehë të cilëve njëherit u është ndihmuar edhe me pagesën e qirave mujore për strehim deri në rregullimin e statusit të tyre si të punësuar.



# Fejsbukut i bëhet vonë vetëm për Fejsbukun

Nga

Ethan ZUCKERMAN



Goditja e fortë e Fejsbukut kundër mediave të pavarura erdhi vjeshtën e kaluar në Sllovaki, Kamboxhia, Guatemalë dhe tre vende të tjera. Gjigandi social hoqi lajmet e këtyre botuesve nga News Feeds i përdoruesve, duke i fshehur në një burim të ri, të vështirë për t'u gjetur. Botuesit e pavarur raportuan se humbën deri 80 për qind të audiencës gjatë këtij eksperimenti. Fejsbukut nuk i bëhet vonë. Të paktën, zakonisht kështu duket.

Pavarësisht reagimit të zemëruar në gjashtë vendet që u prekën prej lojës së Fejsbukut me algoritmin, tani kompania po vazhdon me ndryshime të ngjashme në News Feed-in e vet, globalisht. Këto ndryshime me gjasë do të ulin prioritetin e lajmeve nga botues profesionistë, dhe në vend të kësaj do të favorizojnë postimet nga miqtë dhe familja e një përdoruesi. Shumë prej organizatave të medias do të shohin rënie të fortë të trafikut - nëse nuk e paguajnë Fejsbukun për t'i përfshirë lajmet e tyre në News Feed-et e përdoruesve. Në thelb të këtij ndryshimi qëndron përpjekja e Fejsbukut për të mos u parë si një botues lajmesh, por si një platformë neutrale për ndërveprimet mes miqve. I gjendur përballë kritikave të forta për rolin e tij në përhapjen e disinformimit, dhe ndoshta në ndikimin në zgjedhjet e SHBA dhe Mbretërisë së Bashkuar, Fejsbuku po përpjetë të kufizojë ekspozimin duke kufizuar rolin e vet. Kështu ka ndodhur prej një kohe të gjatë. Ky riekulibrim nënkupton gjëra të ndryshme për aktorë të ndryshëm - për botuesit, do të thotë që pothuaj me siguri do të ndëshkohen për faktin që u mbështetën tek një platformë, e cila kurrë nuk ka qenë një partner tërësisht i besueshëm. Fejsbuku nuk foli fare me botuesit në Sllovaki, sepse botuesit janë më pak të rëndësishëm se sa palët e tjera në këtë rimishërim të ri të Fejsbukut. Por më në përgjithësi, Fejsbuku nuk flet me ty, sepse Fejsbuku e di se çfarë do ti.

Fejsbuku mbledh informacione mbi ndërveprimet e çdo njeriu me faqen - dhe shumë veprime të tjera online - kështu që Fejsbuku di shumë gjëra se ku është e orientuar vëmendja jonë. Njerëzit thonë se janë të interesuar për një gamë të gjerë lajmesh nga preferenca të ndryshme politike, por Fejsbuku e di që ata në të vërtetë duan artikuj të zemëruar, që konfirmojnë anshmërinë politike. Botuesit në Sllovaki dhe në SHBA mund të paralajmërojnë për dem ndaj demokracisë, nëse lexuesit e Fejsbukut marrin më pak lajme, por Fejsbuku e

di se njerëzit do të jenë shumë të lumtur - shumë të angazhuar - me më shumë postime nga miqtë dhe familjarët. Për Fejsbukun, preferencat tona - të zbuluara nga analizimi i sjelljes sonë - flasin shumë. Fjalët që themi, nga ana tjetër, shpesh herë thjesht injorohen. (Mbajeni parasysh kur t'i përgjigjeni pyetjes së Fejsbukut se cilave media u besoni).

Tristan Harris, një kritik i fortë i internetit të mbështetur tek reklamat, kohët e fundit më ofroi një analogji për të shpjeguar një problem me preferencat e zbuluara. Unë premtoj të shkoj në palestër më shpesh në vitin 2018, por çdo mëngjes kur zgjohem, partnerja më jep një pjatë me petulla dhe më kërkon të rri në shtrat dhe t'i ha. Preferencat e mia të zbuluara tregojnë se jam më shumë i interesuar të ha petulla se sa të ushtrohem. Por është shumë perverse që partneri më jep ato që dëshiroj aq shumë të ha, duke injoruar atë që kam shpallur se aspiroj. Ndryshimi i ardhshëm i Fejsbukut në News Feed nuk do të eliminojë lajmet e rreme... të paktën kjo nuk ndodhi në Sllovaki. Njerëzit ndajnë lajme sensacionale apo shokuese, ndërkohë që lajmet më të besueshme kanë prirjen të mos bëhen virale. Kur njerëzit zgjedhin të abonohen në burime të besueshme informacioni, ata po kërkojnë të shkojnë në palestër. Me këto ndryshime në News Feed, Fejsbuku ju hodhi nga dri-


tarja atletet e stërvitjes dhe ju regjistroi në një shërbim që jua sjell petullat në shtëpi. Përse 2 miliardë njerëz pranojnë një shërbim, i cili u kujton se është projektuar për mirëqenien e tyre, ndërkohë që vazhdimisht injoron preferencat e tyre të shpallura? Shumë njerëz ndihen sikur nuk kanë zgjedhje. Fejsbuku është i vetmi rrjet social, për shembull, ku unë takohem përkohësisht me disa prej miqve të mi, sidomos ata të femijërisë dhe shkollës së mesme. Unë nuk dua që Fejsbuku të ikë - dua të përmirësohet. Por gjithnjë e më shumë, mendoj se e vetmja mënyrë që Fejsbuku të dëgjojë preferencat e shprehura të njerëzve, është nëse njerëzit nisin të ndërtojnë alternativat e tyre. Në këtë moment, Fejsbuku zgjedh se cilat lajme do të dalin në krye të News Feed-it tënd, duke optimizuar "angazhimin" dhe "kohën cilësore". Nuk ju pëlqejnë zgjedhjet e Fejsbukut? Shumë keq. Mund ta bëni Fejsbukun që përkohësisht t'ju japë ushqimin me lajme në mënyrë kronologjike, por kur mbyll dritaren e internetit, do të rikthehesh tek algoritmi paternalist i Fejsbukut. Këtë vjeshtë, unë dhe kolegët e mi nxorëm gobo.social, një mbledhës lajmesh që mund të përshtatet. Gobo paraqet postime nga miqtë, por edhe ju ofron disa "sliders" që menaxhojnë se çfarë lajmesh shihni dhe çfarë ju fshihen. Doni më shumë lajme serioze, më pak

**Çfarëdo që Mark Zuckerberg thotë për komunitetin njerëzor apo trashëgiminë e tij, kompania e tij po vepron për interesat e veta - dhe kundër të mirës publike. Dhe, vendimi i Fejsbukut për t'u ikur lajmeve është një përpjekje për t'iu shmangur këtij debati sfidues. Dhe ndoshta e kishim gabim që e ftuam Fejsbukun në këtë debat, që në krye të herës**



humor? Lëvizni një prej tyre. Doni të dëgjoni më shumë zëra femërore? Përshtasni slider-in e gjinisë, ose klikoni në "hesht të gjithë burrat". Aktualisht Gobo ka një duzinë mënyrash për të përshtatur prurjen e lajmeve, dhe më shumë do të vijë. Gobo është provokim, jo produkt. Ndërkohë që është një mjet i mirë për të lexuar Tuiterin, Fejsbuku na lejon vetëm t'ju tregojmë Fejsbuk Pejxhis (faqet që po u hiqet prioriteti në News Feed) dhe jo postimet nga miqtë, duke e gjymtuar kështu funksionimin e tij si një mbledhës rrjetesh sociale. Qëllimi ynë nuk është t'ju bindim që të lexoni mediat tuaja sociale përmes Gobos (edhe pse jeni të mirëpritur ta bëni!), por të inkurajojmë platforma si Fejsbuku që t'u japin lexuesve më shumë kontroll mbi atë që shohin. Nëse doni që ta përdorni Fejsbukun për të ndjekur lajmet, duhet të jeni në gjendje ta bëni, edhe nëse algoritmi i Fejsbukut e di se çfarë e tërheq vëmendjen tuaj. Ka një debat të fortë mbi mënyrën se si Fejsbuku duhet t'ua paraqesë lajmet lexuesve. A duhet të filtrojë dhe lërë jashtë lajmet e rreme? Të prioritizojë lajmet me cilësi të lartë? Të fokusohet tek miqtë e familja në vend të politikës? Vendimi i Fejsbukut për t'u ikur lajmeve është një përpjekje për t'iu shmangur këtij debati sfidues. Dhe ndoshta e kishim gabim që e ftuam Fejsbukun në këtë debat, që në krye të herës. (The Atlantic)

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 1 shkurt | Numri i parë i gazetës do të 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



# Binjak në Ballkan



Nga  
Artan XH. DUKA

**M**inistri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kotzias në një intervistë për mediat greke citohet se ka deklaruar që "... Ligji i luftës duhet hequr, pasi është i pakuptimtë..." Një deklaratë kjo e paparë dhe që duhet përshëndetur për një push-tetar grek. I cilësuar budallallëk nga vetë pala greke, ligji atavik i luftës po "bezdis" me sa duket edhe ata vetë ndonëse si ligj "shejtan-budalla" mori peng me dekada pronat e shqiptarëve në Greqi. Një ligj ky që fshehu gjërat gjatë nën rrogos por që sot ekspozon jo për mirë Greqinë dhe është pengesë për bashkëpunimin e duhur mes nesh në rajon. Ai vërtet është hall i madh, por jo vetëm për ne por dhe për vetë Greqinë e marrë peng nga e shkuara e saj. Pa lënë mënjanë budallallëqet, kot që ulesh në tryezë pastaj.

Greqia nuk humbet por fiton dinjitet e respekt më tej në rajon nëse rishikon të shkuarën e saj. Se ndërsa minoriteti grek tek ne gëzon të njëjtat të drejta, në mos më shumë se popullsia shqiptare, shqiptarët autoktonë apo të shkuar në Greqi mbeten ende anonim dhe kjo nuk i shkon vendit që e prezantoi botën me demokracinë. Tryeza e bisedimeve është e vetmja rrugë përpara dhe që kjo tryezë të jetë "fair" (korrekte) duhet të aplikohet parimi i reciprocitetit dhe ekuivalencës mes nesh për gjëra reale.



Nuk ka rëndësi kush e ka listën e kërkesave më të gjatë (ndonëse historia i ka hyrë në hise më shumë shqiptarëve). Boll të jenë të vërteta historike dhe jo pretendime të paqena. Të drejta, për të cilat edhe mund të lëshohet pe, pa kompromentuar thelbin e saj, sa kohë pala tjetër nuk lan duart me lëshime për budallallëqe! E vërteta e budallallëku nuk kanë vend në një "thes".

Për palën greke kërkesa reale që duhet të vlerësohen janë psh. konsolidimi i mëtejshëm i statusit të minoritetit grek, kufiri korrekt detar, menaxhimi efektiv i kufirit për të kontrolluar emigracionin ilegal, kontrabandën e trafikun kriminal, gjetja e trupave të të rënëve të luftës etj. Sa për kërkesat e tjera (nga vëndprejja e

ushtarëve, nënshtetësia e kryepfriftit, zbatimi ligjit urbanistik në Himarë etj) ato nuk burojnë nga të drejta historike por janë ndërhyrje e pretendime që krijojnë tensione artificiale që mund të qorrollepsin çdo tryezë dialogu mes nesh dhe lëshimet në këto raste prej nesh janë reale dhe jo lëshime për budallallëqe. Mbi bazën e respektit reciprok e ekuivalencës, një memorial përkujtimor i të rënëve të luftës italo-greke tek ne do të mund të mirëkuptohet nga shqiptarët sa kohë respektohen viktimat dhe martirët e gjenocidit grek në Çamëri. Ku ne lëshojmë më shumë sepse popullsia çame ishte në tokën e të parëve.

Mbi bazën e respektit reciprok e ekuivalencës, tapia e minoritarë-



Reflektimi grek ndaj historisë, veç e lartëson imazhin e këtij vendi. Rajoni vetëm fiton nga një Greqi e Shqipëri e fortë që bëhen bashkë për sfiadat e së ardhmes. Fundja, jemi popuj binjak. Arvanitasit, epirotët... plus, mijëra vjet që ushqehemi nga e njëjta tokë!

ve sipas 7501 duhet të shoqërohet me njohjen dhe rikthimin e pronave historike shqiptare në Greqi. Ku ne lëshojmë më shumë sepse 7501 u mori tokën pronarëve shqiptarë. Mbi bazën e reciprocitetit dhe ekuivalencës, kërkesat legjitime greke ndaj mirëqenies së minoritetit grek në jug të vendit, duhet të shoqërohen me njohjen e respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë, minoritetit arvanitas e atij autokton shqiptar çam epirot që u kategorizua si minoritet jo se i çoi rruga atje por se 1913 i la jashtë shtetit amë. Ku ne lëshojmë më shumë se një pjesë e tanëve janë minoritet në tokën e të parëve. Deklarata e ministrit është një ogur i mirë. Stabiliteti, harmonia dhe mirëqenia afatgjatë në rajon është përgjegjësia e dy kombeve më të vjetra në të. Lëshimet reciproke që respektojnë historinë, janë "kurbani" për të ardhmen e përbashkët. Dhe nëse duhen bërë, duhen bërë në emër të saj dhe jo të argumentit "se zhblllokuam vendimet e qeverisë së mëparshme". Se i bie që dhe kufiri detar të zbatohet ndonëse antikushtetues. Reflektimi grek ndaj historisë, veç e lartëson imazhin e këtij vendi. Rajoni vetëm fiton nga një Greqi e Shqipëri e fortë që bëhen bashkë për sfiadat e së ardhmes. Fundja, jemi popuj binjak. Arvanitasit, epirotët... plus, mijëra vjet që ushqehemi nga e njëjta tokë!

# Ta përdorësh Amerikën



Nga  
Ben Andoni

**P**as votimit tonë në OKB për Jerusalemin, shqiptarët e politikës janë ndarë sakaq në dy tabore. Njëri që shprehte pikëllimin e madh sesi nuk i mbështetëm amerikanët në këto momente të vështira, kurse tjetra më patetike se ky veprim duhej pasi ne jemi pjesë e familjes së madhe të shteteve evropiane. Në ato ditë, siç ndodh në këto raste, u përmendën të gjitha ato që na kish bërë Amerika dhe që na garantonte, por që ne njiheshim kështu... si të pabesë. Të tjerët, që janë të lidhur me qeverinë, u përshatën më pranueshëm duke rrëfyer listën e vendeve që votuan pro-Amerikës. Pak orë më parë, Ambasada amerikane në Tiranë, i

është dashur t'i përgjigjet mesazhit të një interviste të kryetares së njëres prej partive opozitare Monika Kryemadhi, në të cilën ajo shprehej se opinioni ligjor për ndryshimin e kryeprokurorit ishte vetëm i misionit të BE, EURALIUS, kurse misioni i SHBA, OPDAT, nuk ishte shprehur. Përgjigjja që erdhi ishte e thjeshtë: "Kushtetuta dhe ligji për Prokurorinë janë të qarta. Ambasada e SHBA mbështet opinionin ligjor që OPDAT dhe EURALIUS i kanë dhënë Parlamentit", thuhej në deklaratën e ambasadorit Lu. Ky lloj komunikimi është bërë i shpeshtë sepse mesazhet e Amerikës tek ne lexohen si palë, por asesi si një lloj arbitri. Kaq mjaftoi edhe këtë

herë që shqiptarët ta përdorin imazhin e SHBA-së, sikur të jetë një gjë fare e zakonshme, njësoj me miqësitë që kanë prishur dhe rregulluar në këto njëqind vitet e fundit.

Të shkojmë në një vend tjetër! Shqiptarët kur flasin për luftën dhe mbrojtjen e Kosovës, ia dedikonin mbrojtjen dhe garantimin e pavarësisë Amerikës. Veçse në vitet e fundit ia shpërblyen me gati një kontingjent të tërë në përbërje të ISIS, kurse pak orë më parë ambasadorit Delawie në Prishtinë, kryetari i UÇK-së iu drejtua me fjalën palaço!!! Po jo vetëm kaq. Në të gjitha këto ditë: Ambasadorit të SHBA në Prishtinë i është dashur të luftojë

shumë që deputetët kosovarë t'i thërrisin mendjes dhe të mos tentonin ta shpërbënin Gjykatën Speciale, ashtu si në kohët e fundit i është dashur t'u kujtojnë investimin e madh amerikan, që është edhe një dukje identiteti.

Ndërsa analisti amerikan për rajonin Daniel Serwer ka thënë më shumë atë që në hapësirat shqiptare është kaluar thatë... "Mund të supozojmë se nuk do të jemi gjithmonë të mirëpritur në Kosovë. Kosovarët e rinj shqiptarë nuk e kuptojnë pse vendi i tyre nuk ka një armatë. NATO po shihet si një barrierë për ta pasur atë. Disa ndërkombëtare mendojnë se Kosovës nuk i duhet një armatë sepse e ka praninë e

NATO-s aty. Por, kjo nuk do t'u shtet gjatë qytetarëve të Kosovës. Më mirë të zgjidhet problemi se sa t'i presim të protestojnë", ka shkruar ai. se Fjala ishte për bazën, e cila mund të zhvendosej prej alternativave të tjera më të pranueshme por edhe qëndrimin në përgjithësi.

A janë të ndara këto shembuj? Në dukje po. Por të gjitha i bashkon një fill, që shqiptarët gjatë të gjithë historisë kanë dashur të luajnë me shumë porta, thjesht nga individë për të ruajtur benefice personale por assesi interesat e mëdha të vendit, që për fatin e madh në këto dekadat e fundit na kanë përkuar me palën amerikane. (Javanews)



# SKLLEVËR TË MEDIAVE SOCIALE

Media sociale mund të shkaktojë varësi dhe ata që bien pre e saj shfaqin të njëjta simptoma sjelljeje të lidhura me ato kimike si alkooli apo e nikotina: ndryshim humori, izolim social, konflikt dhe rënie. Karakteristika kryesore e varësisë është të ketë një ndikim shkatërrues mbi jetën e një personi



**TË VARUR NGA MEDIAT SOCIALE.** Disa njerëz përkufizohen të tillë dhe e shkruajnë në profilin e tyre në LinkedIn. Çfarë do të thotë me të vërtetë të kesh varësi nga media sociale? A ka një diagnozë për këtë gjendje dhe si e kuptojmë që kemi arritur në kufi? Për këtë duhen shumë vite kërkim dhe kritere të sakta përkufizimi. Studimet mbi këtë fushë janë të reja dhe as OBSH-ja nuk e parashikon si një çrregullim.

**SHENJA TË DALLUESHME.** Për Mark Griffiths-in, psikolog në Nottingham Trent University, media sociale mund të shkaktojë varësi dhe ata që bien pre e saj shfaqin të njëjta simptoma sjelljeje të lidhura me ato kimike si alkooli apo e nikotina: ndryshim humori, izolim social, konflikt dhe rënie. Karakteristika kryesore e varësisë është të ketë një ndikim shkatërrues mbi jetën e një personi. Meqë një dëfrim nuk ndikon negativisht mbi jetën e punës ose mbi marrëdhëniet nuk duhet shqetësuar.

**FAKTORI KOHË.** Edhe vendo-

sja e një limiti kohor për orët që qëndrojmë në linjë sipas të cilit "jemi të sëmure" për Griffiths është pak çorientuese. Pjesa më e madhe e përdoruesve në rrjet kalon më shumë se dy orë në ditë e megjithatë pjesa më e madhe e popullatës nuk ka probleme me varësinë nga kjo media. Pra nuk është vetëm faktori kohë për të përcaktuar këtë çrregullim psikologjik. Atëherë cila është? Griffiths zbuloi se ekstrovertët e përdorin rrjetin për vetëpërmirësim social dhe introvertët si formë kompensimi. Meqë e ushqejnë trurin me rikompensim mund ta përdorin si ngushëllim për luhatjet e humorit e të arrijnë kështu në një varësi psikologjike.

**CILËT JANË MË TË RREZIKUARIT.** Meqë nuk është koha që përcakton këtë rrezik atëherë cilët janë ata që janë më të rrezikuarit? Femër, beqare dhe në moshë të re me nivele bazë të arsimimit, të ardhurash dhe vetëvlerësim të ulur.

Origjina e kësaj nevojë kompulsive për të postuar dhe lexuar të tjerët vjen nga frika e të mbeturit jashtë ose mund të lidhet me varësinë nga telefoni celular. Megjithatë të dhënat janë të pakta dhe jo të ekuilibruara në Facebook. Disa kërkime të kohëve të fundit tregojnë Instagramin si rrjetin social më të rrezikshëm për shëndetin mendor sidomos për adoleshentët. Në pritje që ekspertët të prononcohen mbi ekzistencën ose jo të varësisë sociale, shkencë ndahet në dysh për pasojat e kohës së kaluar në këto komunitete virtuale. Disa kërkime kanë përcaktuar se të rinjtë që kalojnë më shumë se dy orë në rrjetet sociale në ditë kanë risk për të patur çrregullime mendore. Realiteti që propozohet në këto rrjete nuk reflekton atë që ndodh në të vërtetë dhe këta përdorues besojnë se kanë një jetë më të keqe se të tjerët



**Disa kërkime kanë përcaktuar se të rinjtë që kalojnë më shumë se dy orë në rrjetet sociale në ditë kanë risk për të patur çrregullime mendore. Realiteti që propozohet në këto rrjete nuk reflekton atë që ndodh në të vërtetë dhe këta përdorues besojnë se kanë një jetë më të keqe se të tjerët**



**DOZA TË VOGLA NUK PRISHIN PUNË.** Disa studime të tjera thonë se deri në një farë mase favorizojnë një mirëqenie psikologjike sepse na bëjnë të lidhemi, të mos mbetemi jashtë. Sipas Andrew Przybylski-it nga universiteti i Oksfordit përdorimi i mediave sociale deri në një farë mase bën pjesë në rininë dhe nuk bëhet shkatërrimtare, derisa kur fillon qëndrimi për 6, 7 ose 8 orë.

Por, si t'ua bësh të ditur përdoruesve që media sociale po bëhet e tepërt? Një mundësi është dërgimi i një mesazhi në ekranin e një telefoni ose kompjuteri me të cilin përballësh me atë të një përdoruesi mesatar pa e paragjykuar apo dhënë gjykim negativ. Për shembull, një adoleshent që në orën 3 të mëngjesit përdor Instagramin mund të njoftohet në atë orë se vetëm 3% e bashkëmoshatarëve është në linjë. Këto sinjalizime kanë dhënë rezultat për lojërat e fatit.

## Të dhëna mbi dhurimin e gjakut. Pse na bën heronj?

Në momentin e dhurimit të gjakut - nga ne merren edhe mostra gjaku për kryerjen e analizave, të cilat tregojnë të dhëna bazë mbi infektimin me HIV, hepatit etj. Pra, ne marrim edhe të dhëna të rëndësishme për shëndetin tonë falas. Rëndësia më e madhe mbetet shpëtimi i jetës së dikujt. Kur dhurojmë gjak, ne i japim më shumë mundësi jete një personi në nevojë për transfuzion gjaku



Dhurimi i gjakut është mënyra e vetme e përfutimit të tij, pasi ende nuk është siguruar një rrugë e prodhimit të gjakut në mënyrë

laboratorike. Qelizat e gjakut nuk janë mundur të krijohen në laborator, ndaj kjo gjë e bën dhurimin e gjakut, mënyrën e vetme

të përfutimit të tij për sigurimin e nevojave për gjak. Transfuzioni i gjakut ka një vlerë shumë të madhe në pacientët me patologji

malinje, në pacientët që i nënshtrohen kirurgjive të ndryshme dhe, mbi të gjitha, në ata që vuajnë nga talasemia. Talase-

mikët kanë nevojë të vazhdueshme për gjak, nevojë që mbulohet nga bankat e gjakut në gjithë vendet e botës. Duke parë rënie



# NUK IU KUJTOHET EMRI I LADY DIANA? FAJIN E KA ANA E MAJTË E TRURIT!

Studimi i një grupi anglez botuar në "Cerebral Cortex". Sfida e hartës së 256 llojeve të kujtesës

Një herë një psikolog eksperimental u përpoq të numërojë të gjitha llojet ekzistuese të kujtesës, duke arritur një shifër të mrekullueshme 256. Edhe nëse ky numër nuk duhet të merret shumë seriozisht, mbetet fakti se kujtesa ka forma të shumëfishta dhe ndoshta ka shumë mënyra për të harruar. Duke mos qenë në gjendje të mbani mend emrin e një personi të famshëm është ndryshe nga harrësia e asaj që quhet djalë qesharak i cili na fut në shtëpinë e një shoku, vetëm për të dhënë një shembull. Ajo përfshin të gjitha llojet e kujtesës, pra, është një ndërmarrje sfiduese për neuro-shkencën. Elementin e fundit të enigmës e ka organizuar një grup anglez, duke botuar një studim mbi "Cortexin Cerebral". Titulli i shpalljes së Universitetit të Mançesterit nuk ka shkuar pa u vënë re: "A nuk ju kujtohet emri i Princeshës Diana? Faji qëndron në anën e majtë të trurit". Por çfarë saktësisht zbuluan studiuesit?

## TESTET PSIKOLOGJIKE

Grace Rice dhe kolegët llogaritën me ndihmën e 41 pacientëve epileptikë, të cilët janë operuar për t'iu jetës normale. Kirurgët ndërhyjnë në një pjesë të indeve të



përfshira në kujtesë, për të hequr epiqendrën e krizave. Në rreth gjysmën e pacientëve operacioni ka të bëjë me lobin e përkohshëm anterior të majtë, në gjysmën tjetër të djathtë. Kur këta njerëz u janë nënshtruar një sërë testeve psikologjike për të vlerësuar efektet, u konfirmua se të dy hemisferat e trurit janë

të rëndësishme për kujtesën. Por doli gjithashtu se ata që ishin operuar në të majtë e kishin më të vështirë se të tjerët të shprehnin verbalisht njohuritë e tyre për faktet e njohura. Në mënyrë të veçantë, duke parë fotot e njerëzve të famshëm duke përfshirë edhe Princeshë Dianën, të përjetshmen Eliza-

beth II dhe një hollivudian të bukur si Brad Pitt, ndoshta ju kujtohet diçka nga identiteti i tyre, por jo emrat. Në praktikë, shprehja verbale e "kujtesës semantike" u dëmtua.

## AMNEZIA

Rastësisht, kujtesa semantike apo konceptuale është ajo që

lejon një konkurrente të përgjigjet edhe kur prezantuesi i një kuiz televiziv pyet: "Sa "Oscar" për aktorin më të mirë fitoi Brad Pitt?". Por i njëjti emër dhe e njëjta fytyrë do të aktivizojë një tjetër lloj të kujtesës quajtur episodike, nëse kërkesa do të ishte drejtuar për Angelina Jolie që ka kujtime personale në lidhje me të. Lexuesit e Umberto Eco kanë një dallim shumë të qartë, sepse protagonist i "Flaka misterioze e mbretëreshës Loana" humbet kujtimet autobiografike duke i mbajtur të paprekur njohuritë ruajtur në kujtesën e tij enciklopedike. Është ngushëlluese të mendojmë se mund të jetë faji i diferencës midis kujtesës episodike dhe semantike nëse një koleg herë pas here vjedh një nga idetë tona pa njohur meritën: kur e ka dëgjuar mund ta ketë ruajtur atë mirë dhe ka harruar rrethanat. Megjithatë, në jetën e përditshme, mekanizma të tjerë me siguri marrin përsipër kur njohim fytyrën e dikujt, por nuk e kujtojmë emrin. Fytyra përmban një informacion shumë të rëndësishëm, sepse ajo përcjell emocionet, kështu që truri ynë është veçanërisht i aftë në identifikimin e tipareve të fytyrës. Ndërkohë emrat thonë pak, janë sekuenca vetëm arbitrare të simboleve, kështu që për t'i mbajtur mend duan më shumë përpjekje dhe është më e lehtë për t'i harruar. Përveç nëse personit në fjalë nuk i pëlqen aq shumë që të shkaktojë goditje rrufe. Në këtë rast, sigurohuni, mbani mend emrin tuaj dhe madje mbani numrin tuaj të telefonit.

## OPTIMISTËT KANË ZEMËR TË SHËNDETSHME

Optimistët kanë shanse dy herë më të mira për shëndetin ideal kardiovaskular, shkruan EurekAlert. Njerëzit me një qëndrim pozitiv ndaj jetës kanë shëndet në mënyrë të konsiderueshme më të mirë kardiovaskular, thotë një studim i ri që ekzaminuar lidhjen mes optimizmit dhe shëndetin e zemrës në më shumë se 5.100 të rriturit. "Njerëzit me nivelin më të lartë të optimizmit kanë dy herë më shumë



gjasa që të ketë shëndet ideal kardiovaskular në krahasim me njerëzit pesimistë," thotë autori kryesor Rosalba Hernandez, profesor i punës sociale në Universitetin e Illinois. "Kjo lidhje mbetet e fortë edhe pas auditimit rezulton në lidhje me karakteristikat socio-demografike dhe shëndetin e dobët mendor", shton ai. Optimistët kanë nivel të ulët të sheqerit dhe kolesterolit në gjak, thuhet në studimin amerikan.

në vite të dhuruesve vullnetarë të gjakut, politikant e vendeve të ndryshme kanë ndërmarrë masa për zëvendësimin e rezervave të shtruar të gjakut në spitalet e vendeve. Tashmë edhe në vendin tonë nuk mund të kryhet asnjë lloj ndërhyrjeje kirurgjikale pa pasur 3-4 familjarë që të dhurojnë fillimisht gjak (nuk ka rëndësi grupi i gjakut) dhe më pas kryhet operacioni. Kjo është një metodë për t'i ndërgjegjësuar njerëzit se duhet të dhurojnë gjak, për aq kohë sa me të shpëtojnë jetë.

Grupet e gjakut janë A, B, AB dhe O. Nevojat janë për secilin grup, por më tepër për grupin O, pasi është i vetmi dhurues universal që mund të përdoret për transfuzione në çdo individ. Ndërkohë, grupi AB është një marrës universal, pasi mund të

marrë gjak nga të gjithë grupet e tjera të gjakut. Kjo bëhet në sajë të pranisë së antigjenëve në gjak, të cilat i kanë përcaktuar edhe këto "rregulla" bazë të tranfuzionit të gjakut.

Në momentin që ne dhurojmë gjak, nuk duhet të jemi të sëmurë, qoftë edhe me grip, pasi imuniteti ynë është shumë i dobët dhe gjaku ynë do t'i dhurohet një personi tjetër. Nuk duhet të kemi bërë tatuazhe në 6 muajt e fundit, nuk duhet të kemi marrë antibiotikë, nuk duhet të konsumojmë drogëra, alkool, të mos vuajmë nga tensioni, nga anemia etj. Të gjitha këto rregulla janë të shënuara në çdo mjedis të dhurimit të gjakut.

Përveç faktit që ne shpëtojmë jetë me gjakun tonë, ne gjithashtu mësojmë edhe mbi



**Nuk ka gjë më humane se të shpëtohet jetë, kur ke mundësi, ndaj nëse dëshiron të shpëtohet edhe ti jetë, shko të dhurosh gjak. Asgjë e keqe nuk do të ndodhë. Plazma jote do të zëvendësohet pas maksimalisht 1 dite, kurse qelizat e gjakut për një javë. Ti do të jesh i gatshëm t'i rikthehesh aktivitetit të zakonshëm disa minuta pas dhurimit dhe do të jesh në gjendje të dhurosh sërish (nëse dëshiron) vullnetarisht pas gjashtë muajsh**

gjendjen tonë shëndetësore. Në momentin e dhurimit të gjakut nga ne merren edhe mostra gjaku për kryerjen e analizave, të cilat tregojnë të dhëna bazë mbi infektimin me HIV, hepatit etj. Pra, ne marrim edhe të dhëna të rëndësishme për shëndetin tonë

falas. Rëndësia më e madhe mbetet shpëtimi i jetës së dikujt. Kur dhurojmë gjak, ne i japim më shumë mundësi jete një personi në nevojë për transfuzion gjaku. Nuk ka gjë më humane se të shpëtohet jetë, kur ke mundësi, ndaj nëse dëshiron të shpëtohet

edhe ti jetë, shko të dhurosh gjak. Asgjë e keqe nuk do të ndodhë. Plazma jote do të zëvendësohet pas maksimalisht 1 dite, kurse qelizat e gjakut për një javë. Ti do të jesh i gatshëm t'i rikthehesh aktivitetit të zakonshëm disa minuta pas dhurimit dhe do të jesh në gjendje të dhurosh sërish (nëse dëshiron) vullnetarisht pas gjashtë muajsh, pasi thuhet se një person mund të kryejë rreth dy dhurime në vit. Në rastet kur kemi të afërm të shtruar për operacione, mund të dhurojmë gjak tre muaj pas dhurimit të fundit vullnetar. Ndaj, mos ngurro të dhurosh edhe ti gjak. Kur e ke mundësinë të shpëtohet një jetë, shko dhe shpëtoje. Është detyrë morale e secilit nga ne për t'u kujdesur për njerëzit në nevojë dhe të sëmurë.



# STRATEGJIA E ZGJERIMIT TË BE-së

Të martën e ardhshme, më 6 shkurt, Komisioni Evropian pritet të publikojë strategjinë për Ballkanin Perëndimorë dhe afatet e mundshme të anëtarësimit të këtyre vendeve në BE

Publikimi i strategjisë është një nga zhvillimet e rëndësishme për rajonin gjatë këtij viti. Në muajin prill, Komisioni Evropian do të publikojë raportin e përparimit të këtyre vendeve, ndërsa në muajin maj në Sofje pritet të mbahet takimi i lartë i vendeve të Ballkanit Perëndimorë. Strategjia e zgjerimit do të diskutohet më pas në qershor në takimin e lartë të Bashkimit Evropian, ndërsa në korrik në Londër do të mbahet takimi i radhës i vendeve të Ballkanit Perëndimorë, raporton VOA.

Këto zhvillime shihen si një

përpjekje e ripërtërirë e Bashkimit Evropian për një qasje ndryshe ndaj rajonit të trazuar për shkak të rritjes së ndikimit rus, krizës së emigracionit, rrëshqitjes së Turqisë drejt autoritarizmit dhe synimit për të forcuar integrimin evropian pas largimit të Britanisë në vitin 2019.

Hapi i parë është publikimi i raportit të Komisionit më 6 shkurt në Strasburg.

Projekt dokumenti që është ende duke u diskutuar, me gjithë përfshirjen e të gjashtë vendeve të rajonit, parasheh që Serbia dhe

Mali i Zi të hyjnë më parë se vendet e tjera në Bashkimin Evropian, ndoshta para vitit 2025.

Për katër vendet tjera, Shqipërinë, Maqedoninë, Bosnjën dhe Kosovën thuhet se deri atëherë duhet të jenë thellë në procesin e anëtarësimit. Por, derisa për Shqipërinë e Maqedoninë paralajmërohet që shpejt të hapin negociatat për anëtarësim, Bosnja mund të marrë vitin që vjen statusin e vendit kandidat. Kosova përmendet në kuadër të bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, që është kushti kryesor për

Beogradin në përparimin e tij drejt Bashkimit Evropian. Viti që vjen parashihet si periudhë e përmblyljes së procesit të këtij normalizimi.

Kosova ndërkaq përfitoi marrëveshjen e stabilizim asocimit me Bashkimin Evropian, por mbetet e fundit në proceset integruese në rajon. Ajo ka dështuar deri tash të përmbushë edhe një nga kriteret kryesore për përfshirjen në regjimin e udhëtimit pa viza, duke mos e ratifikuar një marrëveshje për shënimin e kufirit me Malin e Zi, transmeton VOA.



## NATO, stabiliteti i Kosovës nuk është shqetësues

Komandanti i Forcave të përbashkëta të NATO-s, admiral James G. Foggo, nuk është i shqetësuar për stabilitetin në Kosovë dhe thotë se "NATO respekton neutralitetin e Serbisë dhe lidhjet e saj politike dhe ushtarake me Rusinë". Ai i tha Radio Televizionit Serbisë se "NATO e shpreh qartë dëshirën për zgjerim në rajon, por që nuk ka konflikt interesi".

"Ne jemi në Partneritetin për Paqe, dhe kjo është e shkëlqyer. Në Statutin e Aleancës shkruan se një sulm ndaj njërit prej anëtarëve është sulm mbi të gjithë. Megjithatë, misioni i NATO-s është, para së gjithash, mbrojtja dhe parandalimi i konflikteve. Pranimi i Malit të Zi i ka kontribuar sigurisë së kufijve të rajonit", tha Foggo.

I pyetur nëse NATO do ta kryejë mirë punën e saj kur bëhet fjalë për sigurinë në Kosovë dhe rajon, Foggo tha se më shumë se 4,000 ushtarë të KFOR-it "po kryejnë shumë mirë detyrat për garantuar sigurinë".

"Për këtë siguri, në radhë të parë është kompetente Policia e Kosovës, pastaj EULEX-i dhe KFOR-i. Detyra e tyre është të parandalojnë destabilizimin dhe dhunën", tha Foggo.

Në konstatimin se Departamenti i Shtetit paralajmëroi amerikanët për sigurinë në Kosovë dhe në Bosnjë e Hercegovinë, i cili u pasua nga vrasja e Oliver Ivanoviqit, Foggo vuri në dukje se bëhet fjalë për një krim që duhet të dënohet, por që nuk është i shqetësuar për stabilitetin në Kosovë.

## Shqipëria ka korrupsionin më të lartë në rajon

Shqipëria renditet e 68-a nga 122 shtete, në Indeksin e Sundimit të Ligjit 2017-2018, të publikuar nga "World Justice Project", një institut kërkimor ndërkombëtar me qendër në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shqipëria merr 0.51 pikë, e pandryshuar në raport me një vit më parë, por është përmirësuar me 4 pozicione për shkak të përkeqësimit të shteteve të tjera (zero është vlerësimi më i ulët dhe 1 është më i lartë). Me këtë vlerësim, Shqipëria përfshihet në zonën e verdhë, me zbatim të dobët të ligjeve, në të njëjtën nivel me disa vende të tje-



ra të Ballkanit, Azisë jugore dhe Amerikës së Jugut. Shqipëria ka treguesin e përgjithshëm të zbatimit të ligjit pak më mirë sesa Serbia (që është në vend të 76). Qeverisje

më të fortë ka Maqedonia (në vend të 57), Bosnja po në vend të 47. Shqipëria ka një renditje tepër negative në treguesin e korrupsionit, ku është në vendin e 93 nga 113 shtete

që janë në renditje. Ajo perceptohet që ka korrupsionin më të lartë në rajon. Bosnja është në vend të 73, Maqedonia në vend të 60, Serbia në vend të 74. Tre shtetet me ecurinë më të mirë në raportin e 2017-2018 ishin Danimarka (1), Norvegjia (2), dhe Finlanda (3); tre të fundit janë Afganistan (111), Kamboxhia (112), dhe Venezuela (113). vropa Perëndimore dhe Amerika e Veriut përbëjnë 8 nga 10 vendet e para në renditjen globale, ndërsa Danimarka mbetet vendi më i lartë i 113 shteteve të indeksuar, pasuar nga Norvegjia.



## Po bie PBB në Serbi

Në raportin e Perspektivave të Ekonomisë Globale të nxjerrë në janar të këtij viti, Banka Botërore parashikon që rritja e PBB-së së Serbisë në 2018 do të jetë 3%. Ndërsa nëse do t'i referohehin raportit të qershorit 2017, ky parashikim arrinte në shifrën 3.5%. Ndërsa për vitin 2019 dhe 2020, BB-ja shprehet se Serbia do të ketë rritje të PBB-së prej 3.5 dhe 4%. Gjatë vitit që lamë pas, ekonomia e Serbisë u rrit me 2%.

## Tensione në Kuvendin e Shqipërisë

Seanca plenare e ditës së enjte ka shënuar tensione mes mazhorancës dhe opozitës ku këta të fundit kanë bllokuar foltoren e kuvendit, duke detyruar kryetarin Gramoz Ruçi, që të ndërpris seancën për 5 minuta. Shkak i ndërprerjes së seancës plenare ishte marrja e fjalës nga deputeti Edmon Spaho, i cili nisi të diskutojë për çështje jashtë rendit të ditës, çka nuk u lejua nga kryetari Ruçi i cili i mbylli mikrofonin deputetit. Kjo solli reagimin e kreut të partisë Demokratike Lulzim Basha dhe deputetëve të kësaj force politike, të



cilët ju drejtuan foltores se kuvendit, duke e bllokuar atë. Pas zaptimit të foltores kreu i kuvendit bëri apel për qetësi por thirrja

nuk u morë parasysh nga deputetët e opozitës, çka detyrojë kryetarin e kuvendit që të përjashtoi nga seanca plenare dhe nga

komisionet parlamentare, kryetarin e grupit të PD, Edmond Spaho, pasi ky i fundit bllokojë foltoren për më shumë se 2 minuta.

Pavarësisht kësaj dhe disa ndërprerjeve të shkurtra, opozita ka qendruar në sallë dhe ka protestuar me thirrjet "Hajdut-kriminel" drejtuar Ruçit. Deputetët e PD kanë vazhduar me thirrjet e tyre "hajdut-kriminel" përreth foltores, ndërkohë që Ruçi ka tentuar të vazhdojë me qetësi seancën duke hedhur në votim projektligjet sipas rendit të ditës.





## SHBA shpall "terrorist" liderin e Hamasit

Departamenti amerikan i Shtetit ka njoftuar se ka shpallur terrorist, Ismail Haniyeh, liderin e grupit islamist palestinez, Hamas, transmeton Reuters. Në deklaratën e këtij departamenti thuhet se Haniyeh, së bashku me dy grupe të tjera islamike që janë aktive në Egjipt dhe një tjetër në territorin e Autoritetit Palestinez, janë listuar si terroristë globalë. Aty është cituar Sekretari amerikan i Shtetit, Rex Tillerson duke thënë se emërimet "kanë cak grupet terroriste dhe liderët", duke përfshirë dy të sponsoruara dhe drejtuara nga Irani, e cila konsiderohet kërcënuese e stabilitetit në Lindjen e Mesme, shkatërruese e procesit të paqes dhe sulmuese e aletatëve tanë, Egjiptit dhe Izraelit". Në Gaza, zyrtari i Hamasit, Abu Zuhri i ka thënë agjencisë së lajmeve Reuters, se "ne kundërshtojmë dhe dënojmë vendimin dhe e shohim atë si reflektim të dominimit të bandës së zoistëve në vendimin amerikan".



## Turqi, lirohet pas 8 muajsh presidenti i Amnesty International

Një gjykatë në Stamboll, ka urdhëruar lirimin me kusht të presidentit të organizatës "Amnesty International" në Turqi, Taner Kiliç. Ai qëndroi në paraburgim për 8 muaj. Konfirmimi për lirimin e Kiliç është bërë nga vetë organizata ndërkombëtare. Zyrtari i saj akuzohej për terrorizëm dhe për lidhje të dyshuar me rrjetin e imamet Fetullah Gylen. Ky i fundit akuzohet nga qeveria e Ankarasë, si urdhëruesi i grushtit të dështuar të shtetit, verën e vitit 2016.

# PA SHIH, KUSH PO KTHEHET!



Njeriu që shpiku populizmin bunga-bunga po rikthehet si një i moderuar, shkruan Foreign Policy

Revista amerikane Foreign Policy i ka kushtuar një artikull të gjatë atij që duket se do të jetë rikthimi i radhës i Silvio Berlusconi në politikën italiane. "Karriera politike e Silvio Berlusconi është shenjuar gjithmonë nga surrealja", shkruan John Foot. "Por kurrë kjo gjë nuk ka qenë më e vërtetë se sa sot".

81-vjeçari që pak a shumë shpiku populizmin modern në PERëndim, tashmë po shfaqet si një i moderuar. Berlusconi nuk është transformuar vetëm në një antipopulist, por është bërë edhe një proEuropean me zë të fortë; jo vetëm një liberal i vetëdijshëm, por edhe një njeri që i do fort kafshët dhe që përqafton qingjat. Dhe mbi të gjitha, Silvio nuk ka marrë fund: ai tani shihet si favorit për të fituar në zgjedhjet e ardhshme në Itali. "E gjithë kjo mund të tingëllojë absurde për cilindo që ka studiuar karrierën politike dhe atë të biznesit të këtij njeriu në 25 vitet e fundit. A nuk është ai që praktikisht shkroi librin e rregullave të anti-establishmentit, atë libër që tani po e ndjek presidenti i SHBA, Donald Trump? Silvio Berlusconi krijoi një parti nga hiçi në vitin 1994, dhe ai bazoi një seri fushatash zgjedhore, mbi një mesazh

që sfidonte normat, postpolitik, antiparti. E gjitha e lidhur me suksesin e tij personal si biznesmen dhe sipërmarrës në futboll, si dhe gjenialitetin e tij si personalitet televiziv. Ai predikonte një dietë taksash të ulëta dhe më pak ndërhyrje të shtetit, por edhe karizmë personale dhe pushtet".

Sipas Foreign Policy, transformimi i Berlusconi është ndoshta pjesërisht një shenjë pjekurie politike në moshë të vonë. Por është edhe shprehja më e fundit e mprehtësisë së tij strategjike. Dikur ai përfitoi duke qortuar establishmentin e BE, ndërsa tani është avantazh që të shihet si njeri që përkëdhel eurokratët në Bruksel. Berlusconi po paraqitet si një forcë moderuese, sepse ka pranuar që vetë politika italiane ka ndryshuar. Në vitet 1990, Berlusconi dhe Lega Nord ishin "të vetmit populistë në qytet". Tani, populistë ka plot, sidomos Pesë Yjet e Bepe Grillos. Dhe çfarë po bën Berlusconi? Po vetëofrohet si një ledh

mbrojtës përballë tyre. Edhe gazetari veteran Eugenio Scalfari - ai vetë një kundërshtar i fortë i Berlusconi - ka deklaruar se do të preferonte Kavalierin, më mirë se sa Pesë Yjet. Por Berlusconi mund të ofrohet edhe si një forcë moderuese brenda vetë koalicionit të djathtë. Kjo për shkak të jetëgjatësisë së tij në politikë, por edhe sepse, për shumëkënd, ai shihet si më i moderuar se partnerët e tjerë të koalicionit. "Fakti që Berlusconi po përfiton tani në krahasim me rritjen e neofashistëve është ironik, duke qenë se ishte i pari udhëheqës i pasluftës që i rehabilitoi në vitet 1990. Por ish kryeministri duket se ka përllogaritur saktësisht se publiku italian do të harronte (ose të paktën falte) pozicionet e tij të mëparshme - që nga tensionet me udhëheqësit evropianë, tek flirtimet me ksenofobinë - nëse do i ofrohej një vëllim i mjaftueshëm imazhesh të reja në televizorët e tyre, që sugjerojnë një përkushtim ndaj qëndrimeve të kundërta. Si zakonisht, ai ka refuzuar masa gjysmake: Nëse do të kandidojë si paragon i virtytit dhe përgjegjshmërisë, përse të mos përqafojë kafshë përpara kamerave televizive?", përfundon artikulli i Foreign Policy.

## INTERPOL-i në alarm: 50 luftëtarë të ISIS-it kanë zbarkuar në Itali

Sipas Interpol-it, 50 persona të dyshuar si luftëtarë të ISIS-it, të gjithë me kombësi tuniziane, kanë mbërritur së fundmi në Itali përmes detit. Lajmi është publikuar në gazetën britanike "The Guardian" në versionin e saj online, sipas të cilës, organizata ndërkombëtare e policisë, i ka dërguar në 29 nëntor ministrit të Brendshëm, listën me emrat

e të dyshuarve. Ministria nga ana e saj, e ka qarkulluar listën në agjencitë evropiane të anti-terrorit.

Sipas një funksionari të anti-terrorizmit evropian i pyetur nga "Guardian", militantët e dyshuar të Shtetit Islamik kanë mbërritur në Itali mes korrikut dhe tetorit të shkuar në bordin e varkave të vogla që janë braktisur më pas në zonat

e plazhit. Disa nga luftëtarët, shpjegon gazeta britanike, ishin identifikuar nga autoritetet italiane sapo kanë zbarkuar në brigjet siciliane.

Katër prej tyre ishin të njohur për agjencitë e inteligjencës evropiane dhe njëri nga këta mund të ketë kaluar kufirin italo-francez për të mbërritur në Gard, në jug të Francës.

## Jolie i kërkon NATO-s të ndihmojë gratë e dhunuara

Ylli hollivudian Angelina Jolie njëherësh aktiviste e fuqishme në mbrojtje të grave, i ka bërë apel Aleancës së Atlantikut të Veriut, të marrë masa dhe të ndërhyjë në parandalimin e dhunës ndaj grave në vendet e konflikteve të armatosura. Përmes një konference të përbashkët mes Jolie-s dhe Sekretarit

rit të Përgjithshëm të NATO-s, u njoftuan përpjekjet që do të bëjë Aleanca në mbrojtje të dhunës ndaj grave dhe në zbardhjen e krimeve të luftës. Aktorja e famshme, njëherësh e dërguara e posaçme e agjencisë së refugjatëve, Angelina Jolie, i bëri thirrje NATO-s që të ndërhyjë në ndalimin e

dhunës seksuale ndaj grave, si një armë luftar.

Ylli i hollivudit amerikan përmes një konference të përbashkët me sekretarin përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, bëri të qarta përpjekjet e saj ndërkombëtare për të mbrojtur të drejtat e grave.





Në bazë të Vendimit për shitje të materialit bartës dhe nenit 2 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për shitje të materialit të nxjerrë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup përmes ankandit publik me gojë nr. 0202-3572 të datës 30.09.2016, publikohet:

#### THIRRJE PUBLIKE

##### Për shitje të materialit shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit e lumit

Shoqëria aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup bën shitjen e materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit dhe brigjet e trupave sipërfaqësor ujqor të Lumit Vardar, në aksin Mrzenci – Gjevgjeli, KK Bogdanci PK 3732/5, KK Gjevgjeli PK 2045/2, KK Mrzenci PK 16666, KK Stojkovë PK 8137 dhe KK Bogorodica PK 768 në rajonin e rrjedhës së Lumit Vardar për shkak të rregullimit të regjimit të ujërave në pajtim me Lejen për nxjerrje të rërës dhe gurëve gurë nga shtretërit dhe brigjet e trupave sipërfaqësor ujqor të Lumit Vardar, në aksin Mrzenci – Gjevgjeli, KK Bogdanci PK 3732/5, KK Gjevgjeli PK 2045/2, KK Mrzenci PK 16666, KK Stojkovë PK 8137 dhe KK Bogorodica PK 768 në rajonin e rrjedhës së Lumit Vardar për shkak të rregullimit të regjimit të ujërave nr. UP1 -11/5-1548/17 të datës 26.01.2018 të dhënë nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Çmimi fillestar i materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit është 85,00 denarë plus 7 % kompensim për ujërat plus 18 % TVSH, ndërsa sasia nuk guxon të kalojë më shumë se 168.928,7 m<sup>3</sup>.

Ngarkimi i materialit të lumit bie në barrë të blerësit. Shpallja zgjatë 3 (tri) ditë nga dita e publikimit.

Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur me shenjë **“OFERTË – MOS HAP”**, për Komisionin për realizim të procedurës së ankandit publik, pa adresë, vulë dhe shenja të tjera në të.

Oferta duhet të përmbajë: emrin dhe selinë e firmës, numër tatimor, personi përgjegjës, kontakt telefon, llogari dhe bankë deponuse, me theksim të saktë shumës së ofruar në ofertë të mbyllur.

Së bashku me ofertën parashtrihen dokumentet në vijim për dëshmim të:

#### 1. Gjendjes personale:

- Deklaratë të operatorit ekonomik se në pesë vitet e fundit nuk i është shqiptuar vendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për falimentim nga organi kompetent,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për likuidim nga organi kompetent,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë për pjesëmarrje në procedurë për thirrje publike, ndarje të marrëveshjes për furnizim publik dhe marrëveshje për partneritet publik privat,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerje të veprimtarive të veçanta,
- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë
- Vërtetim për tatime të paguara.

#### 2. Aftësi për kryerje të veprimtarisë profesionale:

- Dokument për veprimtari të regjistruar – si dëshmi se është i regjistruar si subjekt fizik ose juridik,

Dokumentet e kërkuara nuk guxojnë të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj, ndërsa parashtrihen në original ose kopje të vërtetuar nga ofertuesi.

Së bashku me ofertën duhet të parashtrihet dëshmi për depozitë të paguar në shumë prej 400.000,00 denarë. Ofertuesve që nuk janë të zgjedhur u kthehet depozita e paguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit.

Depozita duhet të paguhet në llogarinë me numër 200002947890520 deponent Stopanska Banka SHA Shkup. Hajpen e ofertave do ta realizojë Komisioni për realizim të procedurës për ankad publik, emëruar nga Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup më datë 05.02.2018 në ora 11.00 në lokalet e SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup në rr. “3-ta Makedonska Brigada” nr. 10a Shkup.

Shitja e materialit shkarkues bëhet përmes ankandit publik me gojë. Procedura për ankandin publik realizohet në tri faza: Faza e parë – përcaktimi i kandidatëve që përmbushin kushtet për pjesëmarrje në ankad Faza e dytë – identifikim të regjistrimit të pjesëmarrësve Faza e tretë – ankand publik Në ankandin publik mund të merr pjesë vetëm personi përgjegjës i ofertuesit ose personi i autorizuar nga ai.

Pas zgjedhjes së realizuar, SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup do të lidhë marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm të zgjedhur për rregullim të të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella, që është i obliguar që të parashtrijë garanci bankare në shumë prej 10% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Informacione më të detajuara mund të merren në numrin e telefonit 078-440-515 – Andrea Najdenovski.

Në bazë të Vendimit për shitje të materialit bartës dhe nenit 2 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për shitje të materialit të nxjerrë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup përmes ankandit publik me gojë nr. 0202-3572 të datës 30.09.2016, publikohet:

#### THIRRJE PUBLIKE

##### Për shitje të materialit shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit e lumit

Shoqëria aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup bën shitjen e materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë për shkak të mbrojtjes dhe përmirësimit të regjimit të ujërave nga shtrati i Lumit Vardar, aksi para f. Bistrica, Komuna e Demir Kapisë, rajoni i rrjedhës së Vardarit në pajtim me Lejen për nxjerrje të rërës, zhavorrit dhe gurit për shkak të mbrojtjes dhe përmirësimit të regjimit të ujërave nga shtrati i Lumit Vardar, aksi para f. Bistrica, Komuna e Demir Kapisë, rajoni i rrjedhës së Vardarit nr. UP1-11/5-1585/2017 të datës 07.12.2017 të dhënë nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Çmimi fillestar i materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit është 42,00 denarë plus 7 % kompensim për ujërat plus 18 % TVSH, ndërsa sasia nuk guxon të kalojë më shumë se 62.612,54 m<sup>3</sup>.

Ngarkimi i materialit të lumit bie në barrë të blerësit. Shpallja zgjatë 3 (tri) ditë nga dita e publikimit.

Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur me shenjë **“OFERTË – MOS HAP”**, për Komisionin për realizim të procedurës së ankandit publik, pa adresë, vulë dhe shenja të tjera në të.

Oferta duhet të përmbajë: emrin dhe selinë e firmës, numër tatimor, personi përgjegjës, kontakt telefon, llogari dhe bankë deponuse, me theksim të saktë shumës së ofruar në ofertë të mbyllur.

Së bashku me ofertën parashtrihen dokumentet në vijim për dëshmim të:

#### 1. Gjendjes personale:

- Deklaratë të operatorit ekonomik se në pesë vitet e fundit nuk i është shqiptuar vendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për falimentim nga organi kompetent,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për likuidim nga organi kompetent,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë për pjesëmarrje në procedurë për thirrje publike, ndarje të marrëveshjes për furnizim publik dhe marrëveshje për partneritet publik privat,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerje të veprimtarive të veçanta,
- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë
- Vërtetim për tatime të paguara.

#### 2. Aftësi për kryerje të veprimtarisë profesionale:

- Dokument për veprimtari të regjistruar – si dëshmi se është i regjistruar si subjekt fizik ose juridik,

Dokumentet e kërkuara nuk guxojnë të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj, ndërsa parashtrihen në original ose kopje të vërtetuar nga ofertuesi.

Së bashku me ofertën duhet të parashtrihet dëshmi për depozitë të paguar në shumë prej 1.400.000,00 denarë. Ofertuesve që nuk janë të zgjedhur u kthehet depozita e paguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit.

Depozita duhet të paguhet në llogarinë me numër 200002947890520 deponent Stopanska Banka SHA Shkup. Hajpen e ofertave do ta realizojë Komisioni për realizim të procedurës për ankad publik, emëruar nga Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup më datë 05.02.2018 në ora 10.00 në lokalet e SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup në rr. “3-ta Makedonska Brigada” nr. 10a Shkup.

Shitja e materialit shkarkues bëhet përmes ankandit publik me gojë. Procedura për ankandin publik realizohet në tri faza: Faza e parë – përcaktimi i kandidatëve që përmbushin kushtet për pjesëmarrje në ankad Faza e dytë – identifikim të regjistrimit të pjesëmarrësve Faza e tretë – ankand publik Në ankandin publik mund të merr pjesë vetëm personi përgjegjës i ofertuesit ose personi i autorizuar nga ai.

Pas zgjedhjes së realizuar, SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup do të lidhë marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm të zgjedhur për rregullim të të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella, që është i obliguar që të parashtrijë garanci bankare në shumë prej 10% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Informacione më të detajuara mund të merren në numrin e telefonit 078-440-512 – Kosta Malzarkov.

Në bazë të Vendimit për shitje të materialit bartës dhe nenit 2 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për shitje të materialit të nxjerrë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup përmes ankandit publik me gojë nr. 0202-3572 të datës 30.09.2016, publikohet:

#### THIRRJE PUBLIKE

##### Për shitje të materialit shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit e lumit

Shoqëria aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup bën shitjen e materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i Lumit Pçinja, aksi v.q Breg KK Konjare e Epërme, përmes ujit në v.q Kornalti KK Konjare e Mesme në gjatësi prej 2114.09 m në rajonin e rrjedhës së Lumit Pçinja ne pajtim me Lejen për nxjerrje të rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtretërit dhe brigjet e trupave sipërfaqësor ujqor të shtrati i Lumit Pçinja, aksi v.q Breg KK Konjare e Epërme, përmes ujit në v.q Kornalti KK Konjare e Mesme në gjatësi prej 2114.09 m në rajonin e rrjedhës së Lumit Pçinja, për shkak të rregullimit të regjimit të ujërave nr. UP1 11/5-97/18 të datës 31.01.2018 të dhënë nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Çmimi fillestar i materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit është 61,00 denarë plus 7 % kompensim për ujërat plus 18 % TVSH, ndërsa sasia nuk guxon të kalojë më shumë se 83.716,48 m<sup>3</sup>.

Ngarkimi i materialit të lumit bie në barrë të blerësit. Shpallja zgjatë 3 (tri) ditë nga dita e publikimit.

Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur me shenjë **“OFERTË – MOS HAP”**, për Komisionin për realizim të procedurës së ankandit publik, pa adresë, vulë dhe shenja të tjera në të.

Oferta duhet të përmbajë: emrin dhe selinë e firmës, numër tatimor, personi përgjegjës, kontakt telefon, llogari dhe bankë deponuse, me theksim të saktë shumës së ofruar në ofertë të mbyllur.

Së bashku me ofertën parashtrihen dokumentet në vijim për dëshmim të:

#### 1. Gjendjes personale:

- Deklaratë të operatorit ekonomik se në pesë vitet e fundit nuk i është shqiptuar vendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për falimentim nga organi kompetent,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për likuidim nga organi kompetent,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë për pjesëmarrje në procedurë për thirrje publike, ndarje të marrëveshjes për furnizim publik dhe marrëveshje për partneritet publik privat,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerje të veprimtarive të veçanta,
- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë
- Vërtetim për tatime të paguara.

#### 2. Aftësi për kryerje të veprimtarisë profesionale:

- Dokument për veprimtari të regjistruar – si dëshmi se është i regjistruar si subjekt fizik ose juridik,

Materiali i tepërt ngarkues do të mënjanohet nga parcelat katastrale të theksuara në Projektin themelor dhe lejen. Dokumentacioni projektues do të mund të shqyrtohet më së voni deri në hapjen e ofertave.

Dokumentet e kërkuara nuk guxojnë të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj, ndërsa parashtrihen në original ose kopje të vërtetuar nga ofertuesi.

Së bashku me ofertën duhet të parashtrihet dëshmi për depozitë të paguar në shumë prej 2.400.000,00 denarë. Ofertuesve që nuk janë të zgjedhur u kthehet depozita e paguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit.

Depozita duhet të paguhet në llogarinë me numër 200002947890520 deponent Stopanska Banka SHA Shkup. Hajpen e ofertave do ta realizojë Komisioni për realizim të procedurës për ankad publik, emëruar nga Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup më datë 05.02.2018 në ora 09.00 në lokalet e SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup në rr. “3-ta Makedonska Brigada” nr. 10a Shkup.

Shitja e materialit shkarkues bëhet përmes ankandit publik me gojë. Procedura për ankandin publik realizohet në tri faza: Faza e parë – përcaktimi i kandidatëve që përmbushin kushtet për pjesëmarrje në ankad Faza e dytë – identifikim të regjistrimit të pjesëmarrësve Faza e tretë – ankand publik Në ankandin publik mund të merr pjesë vetëm personi përgjegjës i ofertuesit ose personi i autorizuar nga ai.

Pas zgjedhjes së realizuar, SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup do të lidhë marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm të zgjedhur për rregullim të të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella, që është i obliguar që të parashtrijë garanci bankare në shumë prej 10% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Informacione më të detajuara mund të merren në numrin e telefonit 078-440-515 – Andrea Najdenovski.

Në bazë të nenit 28 të Statutit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 187/2015, 94/16 dhe 158/16) dhe nenit 2 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për shitje të materialit të nxjerrë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup përmes ankandit publik me gojë nr. 0202-3572 të datës 30.09.2016, me autorizim të Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup nr. 0204-3308 të datës 10.11.2017 publikon:

#### THIRRJE PUBLIKE

##### Për shitje të materialit shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit e lumit

Shoqëria aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup bën shitjen e materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit dhe brigjet e trupave sipërfaqësor të Lumit Vardar, në aksin Krivollak KK Pepelishë, PK 2249/1 dhe PK 4210 në rajonin e rrjedhës së Lumit Vardar, për shkak të rregullimit të regjimit të ujërave, në pajtim me Lejen për nxjerrje të rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtretërit dhe brigjet e trupave sipërfaqësor të Lumit Vardar, në aksin Krivollak KK Pepelishë, PK 2249/1 dhe PK 4210 në rajonin e rrjedhës së Lumit Vardar, për shkak të rregullimit të regjimit të ujërave nr. UP1 11/5-1753/17 të datës 15.01.2018 të dhënë nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Çmimi fillestar i materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit është 85,00 denarë plus 7 % kompensim për ujërat plus 18 % TVSH, ndërsa sasia nuk guxon të kalojë më shumë se 298.972,8 m<sup>3</sup>.

Ngarkimi i materialit të lumit bie në barrë të blerësit. Shpallja zgjatë 3 (tri) ditë nga dita e publikimit.

Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur me shenjë **“OFERTË – MOS HAP”**, për Komisionin për realizim të procedurës së ankandit publik, pa adresë, vulë dhe shenja të tjera në të.

Oferta duhet të përmbajë: emrin dhe selinë e firmës, numër tatimor, personi përgjegjës, kontakt telefon, llogari dhe bankë deponuse, me theksim të saktë shumës së ofruar në ofertë të mbyllur.

Së bashku me ofertën parashtrihen dokumentet në vijim për dëshmim të:

#### 1. Gjendjes personale:

- Deklaratë të operatorit ekonomik se në pesë vitet e fundit nuk i është shqiptuar vendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për falimentim nga organi kompetent,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për likuidim nga organi kompetent,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë për pjesëmarrje në procedurë për thirrje publike, ndarje të marrëveshjes për furnizim publik dhe marrëveshje për partneritet publik privat,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerje të veprimtarive të veçanta,
- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë
- Vërtetim për tatime të paguara.

#### 2. Aftësi për kryerje të veprimtarisë profesionale:

- Dokument për veprimtari të regjistruar – si dëshmi se është i regjistruar si subjekt fizik ose juridik,

Dokumentet e kërkuara nuk guxojnë të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj, ndërsa parashtrihen në original ose kopje të vërtetuar nga ofertuesi.

Së bashku me ofertën duhet të parashtrihet dëshmi për depozitë të paguar në shumë prej 2.400.000,00 denarë. Ofertuesve që nuk janë të zgjedhur u kthehet depozita e paguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit.

Depozita duhet të paguhet në llogarinë me numër 200002947890520 deponent Stopanska Banka SHA Shkup. Hajpen e ofertave do ta realizojë Komisioni për realizim të procedurës për ankad publik, emëruar nga Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup më datë 05.02.2018 në ora 12.00 në lokalet e SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup në rr. “3-ta Makedonska Brigada” nr. 10a Shkup.

Shitja e materialit shkarkues bëhet përmes ankandit publik me gojë. Procedura për ankandin publik realizohet në tri faza: Faza e parë – përcaktimi i kandidatëve që përmbushin kushtet për pjesëmarrje në ankad Faza e dytë – identifikim të regjistrimit të pjesëmarrësve Faza e tretë – ankand publik Në ankandin publik mund të merr pjesë vetëm personi përgjegjës i ofertuesit ose personi i autorizuar nga ai.

Pas zgjedhjes së realizuar, SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup do të lidhë marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm të zgjedhur për rregullim të të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella, që është i obliguar që të parashtrijë garanci bankare në shumë prej 10% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Informacione më të detajuara mund të merren në numrin e telefonit 078-440-512 – Kosta Malzarkov.





Nga Qerim LITA

# KËRKESA E DEPUTETËVE SHQIPTARË DREJTUAR STOJAN ANDOVIT

Të premten e kaluar e publikuam letrën e Këshillit të prindërve dhe të shoqatave joqeveritare shqiptare nga Shkupi, drejtuar organeve më të larta shtetëror, përmes së cilës ata protestonin kundër politikës diskriminuese ndaj shqiptarëve, i cili diskriminim asaj kohe më së shumti shprehej ndaj arsimit dhe kulturës shqiptare. Si rrjedhojë e mospërbushjes së kërkesave të pareshtura të shqiptarëve për hapjen e paraleleve në gjuhën shqipe në të gjitha shkollat mesme, në disa qytete, si në Shkup, Kumanovë, Kërçovë, Strugë etj, me nismën e disa profesorëve shqiptarë u hapën disa paralele të gjimnazit të cilat funksiononin jashtë sistemit shkollor. Në këto rrethana, deputetët të grupit parlamentar të PPD-PDP-së: Muhamet Halili, Ismet Ramadani, Avdi Murtezani, Agim Fazliu dhe Hysni Shaqiri, më 3 tetor të vitit 1991 përmes një parashtrise, i drejtohen kryetarit të Kuvendit, Stojan Andov, nga i cili kërkuan që në mbledhjen e radhës të Parlamentit, në rend dite të përfshihet kjo pikë:

"Arsimi i mesëm me mësim në gjuhën shqipe - situatat dhe problemet". Ky problem, siç vë në dukje deputetët shqiptarë, ishte tepër urgjente, për arsye se arsim të mesëm me mësim në gjuhën shqipe, nga viti 1983 thuhet se ishte ndërprerë në tërësi "me qëndrimet partiake të ish KQ të PKM-së në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe dispozitave të Ligjit për arsim të mesëm të orientuar...". Më pas në të thuhej se përkundër "mirëkuptimit të lartë" të shprehur nga ana e Qeverisë dhe nga strukturat e larta të republikës, për hapjen e serishme të paraleleve me mësim në gjuhën shqipe "tërë kjo nuk u arrit, për shkak siç shprehen ata "bllokadave të mëdha të cilat vijnë nga të gjitha strukturat më të ulta, duke filluar nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës Fizike, e deri te drejtorët me orientim burokratik të shkollave të mesme në Republikë...". Një konstatim i tillë i grupit parlamentar të PPD-PDP-së, fare nuk korrespondonte me realitetin, për arsye se tërë kjo koordinohet nga lartë, përkatësisht nga kryetari i Republikës, Kiro Gligorov, kryetari i Kuvendit, Stojan Andov dhe kryeministri Nikolla Klusev si dhe tre partitë e atëhershme më të mëdha Maqedonase: VMRO DPMNE, LKM-PTD-ë dhe Lidhja e Forcave Reformuese. Pa dashur të futemi në një analizë më thelluar rreth problemeve të shumta që asaj kohe pati arsimi shqip në këtë republikë, në vazhdim po e paraqesim të plotë parashtrësën e lartëpërmendur që deputetët shqiptarë ia dorëzuan Stojan Andovit:

## "KRYETARIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, SHKUP

Në bazë të nenit 32 nga rregullorja për punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë kërkohet që në mbledhjen e 24 të Kuvendit të Maqedonisë në rendit ditë të jetë pika:

**ARSIMI I MESËM NË GJUHËN MËSIMORE SHQIPE - SITUATAT DHE PROBLEMET**  
Arsyetimi për urgjencën e debatit për këtë pikë ju është dhënë si shtojcë të kësaj kërkesë.  
Deputetët e PPD-PDP:  
Muhamet Halili  
Ismet Ramadani  
Avdi Murtezani  
Agim Fazliu  
Isni Shaqiri

QYTET	SHKOLLA	PARALELE	NXËNËS
Shkup	Gjimnazi "Zef Lush Marku"	4	160
Shkup	SHQ "Pançe Arsovski"	3	120
Shkup	SHQN "Zdravko Cvetkovski" nuk është hapur asnjë paralele		
Gostivar	Gjim. "Pançe Popovski"	4	100
Gostivar	SH. Ekon. "Ç. Filipovski"	2	60
Gostivar	QSHMO "Zllate Mallakovski" nuk është hapur asnjë paralele		
Tetovë	Gjim. "K. Pejçinoviç"	6	200
Tetovë	QSHM "Nikolla Shtejn"	3	90
Tetovë	QSHT "Goce Stojçevski" nuk është hapur asnjë paralele përkundër faktit se në vitin e parë janë regjistruar 165 nxënës shqiptarë dhe vetëm 5 nxënës maqedonas		
Tetovë	Shkolla Bujqësore - nuk është hapur asnjë paralele		
Dibër	Gjim. "Zdravko Çoçkovski"	4	110

Si rrjedhojë e mospërbushjes së kërkesave të pareshtura të shqiptarëve për hapjen e paraleleve në gjuhën shqipe në të gjitha shkollat mesme, në disa qytete, si në Shkup, Kumanovë, Kërçovë, Strugë etj, me nismën e disa profesorëve shqiptarë u hapën disa paralele të gjimnazit të cilat funksiononin jashtë sistemit shkollor




### ARSYETIM

Arsimi i mesëm në gjuhën mësimore shqipe në Republikë thuhet se është ndërprerë me qëndrimet partiake të ish KQ të PKM-së në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe dispozitave të Ligjit për arsim të mesëm të orientuar. Deri në vitin shkollor 1990-91 mësim në gjuhën mësimore shqipe ekzistonte në qytetet si vijon: Shkup, Tetovë, Gostivar e Dibër me përfshirjen e përgjithshme të nxënësve prej rreth 3%. Për këtë vit shkollor u bënë përpjekje të shumta të hapen sërish paralelet në të gjitha ato shkolla të mesme ku mësimi zhvillohej në gjuhën mësimore shqipe deri në vitin 1983.

Mirëpo, edhe përkundër mirëkuptimit të lartë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe të strukturave më të larta politike në Republikë, megjithatë ekziston një obstrukcion i madh në realizimin e këtyre përcaktimeve. Bllokada të mëdha të cilat vijnë nga të gjitha strukturat më të ulta, duke filluar nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës Fizike, e deri te drejtorët me orientim burokratik të shkollave të mesme në Republikë. Duke e pas parasysh këto obstrukcione e bllokada, në këtë vit shkollor përfundimisht me datë 18 shtator 1991

edhe përkundër përpjekjeve të mëdha thuhet se nuk u bë asgjë në hapjen e serishme të paraleleve në gjuhën mësimore shqipe në shkollat e mesme.

Për sa më sipër shihet se në qytetet Kumanovë, Kërçovë dhe Strugë nuk është hapur asnjë paralele me mësim në gjuhën shqipe, edhe pse ekzistonte pajtueshmëri që në Kumanovë të hapen 3 paralele me mësim në gjuhën shqipe nga orientimi i gjimnazit. Grupi parlamentar i PPD-së disa herë ka vërë në pah për situatën alarmante në arsimin të mesëm me mësim në gjuhën shqipe, mirëpo përpjekje konkrete deri më tash për përballimin e këtyre vështirësive nuk dhanë rezultatin e duhur. Për arsye se në disa qytete revolta e popullatës është në rritje e sipër për shkak moshapjes së paraleleve me mësim në gjuhën shqipe, e cila revoltë, siç është paralajmëruar, do të shprehet përmes demonstratave më të ndryshme, propozojmë që në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë të hapet debat për këtë problematikë, krejt me qëllim që përmes dialogut të tejkalohen problemet e theksuara më lartë. Shpresojmë se pohimi ynë do të hasë në mirëkuptim të madh te të gjithë deputetët e Kuvendit".





# FILM PËR GAZETARIN FRANCEZ TË LUFTËS

Një dramë e re luftime të titulluar "Mëshirë për djallin", bazuar në kujtimet e Paul Marchandit – gazetari francez që raportoi nga Sarajeva e rrethuar – fillon xhirimet muajin që vjen.

"Marchand raportonte nga Sarajeva e rrethuar gjatë viteve 1992-1993 dhe botoi një libër me të njëjtin titull si filmi që do të fillojë të xhirohet", tha për BIRN, Amra Baksij Camo, producente e filmit në kompaninë e filmit dhe televizionit boshnjak Pro.ba.

Raportimet nga fillimi i viteve 1990 e përshkruajnë Marchandin – i cili ka kreu vetëvrasje në vitin 2009 në moshën 47-vjeçare – si një rebel që pinte puro dhe preferonte kapele kashte e jo helmete mbrojtëse.

"Mos qëlloni! Harxhoni kot plumbat. Unë jam i pavdekshëm", thuhet në mesazhin paralajmërues që ai vendosi në makinën e tij, shkroi New York Times në vitin 1992.

"Marchand po rrezikonte jetën e tij, duke ngarë makinën, duke u



përpjekur t'i shmangej sulmit të snajperëve në Sarajevë, ndërkohë që luhej kënga e famshme 'Mëshirë për djallin', tha Baksij Camo.

Rrethimi 1,425-ditor i Sarajevës nga 5 prilli 1992 deri më 29 shkurt 1996, ishte më i gjati i një kryeqyteti në historinë e kohëve të fundit. Filmi është bashkëprodhim franko-kanadezo-belg, me pjesëmarrjen e Bosnje dhe

Hercegovinës, ndërsa do të xhirohet në Sarajevë.

"Do të xhirojmë në të gjithë Sarajevën në vende të ndryshme, por autentike, edhe pse Sarajeva tani është ndryshe nga ajo që ishte gjatë kohës së luftës," tha Baksij Camo.

Niels Schneider, i cili fitoi një çmim Cesar në Francë si aktori më premtes në vitin 2016 për rolin e tij në "Dark Inclusion", do të luajë

rolin e Marchandit.

"Zyrtarët e Sarajevës do t'i mbështesin xhirimet duke siguruar qasje pa pagesë", tha Baksij Camo.

Buxheti i kulturës i Bosnjës është i vogël, kështu që shumica e producentëve kinematografik në vend fokusohen në projekte me mbështetje të huaj dhe grante nga organizata ndërkombëtare. /BIRN/



## Agron Tufa vlerësohet për poezinë më të mirë në vitin 2017

Më 26 janar, Akademia Europiane e Shkencave, Arteve dhe Letërsisë në Paris ka vlerësuar për poezinë më të mirë në vitin 2017 shkrimtarin shqiptar, Agron Tufa. Kjo është një garë për poezinë më të mirë të përkthyer në gjuhën frënge. Shkrimtarit shqiptar, Tufës iu dha çmimi "Taras Shevchenko", poeti kombëtar i Ukrainës. Kjo është një garë për poezinë më të mirë të përkthyer në gjuhën frënge, me disa fitues me çmime të ndryshme (japoneze, amerikane, ruse) sipas figurave poetike emblematike për Europën, kryesisht poetë kombëtarë. Shkrimtarit shqiptar, Tufës, iu dha çmimi "Taras Shevchenko", poeti kombëtar i Ukrainës. Në një kohë që flitet për krizë leximi, e për poezinë sidomos ka një tërheqje dyshuese, Tufa ndan vlerësimin, por dhe qëndrimin e tij, në një gjuhë që shpesh konsiderohet e papërfillshme, dhe autorët e saj me mure të pakapërcyeshme kufijsh.

Tufa ka treguar se mori pjesë në këtë konkurrim me 20 poezi me përkthime të Ardian Marashait dhe Edmond Tupjes, që si duket kanë marrë vlerësime nga Akademia franceze, duke shkuar në nominim dhe bërë fitues për çmimin letrar për poezinë 2017, që jepet çdo vit. Veprat më të njohura të Tufës janë romanet "Dueli" (Tiranë 2002), "Fabula Rasa" (Tiranë 2004), "Mërkuna e zezë", "Tenxherja", "Gurit të varrit ia rrëfej", por njëkohësisht është vlerësuar edhe për poezinë e tij. Institucioni që e nderoi shkrimtarin shqiptar De l'Academie e Europenne des Sciences, des Arts et lettres është një projekt ambicioz që pati idenë fillestare të themelimit, në vitin 1973, për të sjellë së bashku krijuesit më të shquar të Europës, studiues, por edhe shkrimtarë, artistë. Por themelimi i saj u vendos në vitin 1980, me seli në Paris, një institucion i pranuar dhe me mjaft influencë në UNESCO.



## Ermonela Jaho nominohet për "International Opera Awards"

Sopranoja e mirënjohur shqiptare Ermonela Jaho ka gjasë që për herë të dytë të fitojë një nga çmimet më të rëndësishëm që jepen për artistet e operës. Kjo pasi që me publikimin e listës së të nominuarve sivjet për çmimin prestigjioz "International Opera Awards" që njihet edhe si "Oscar i operës", merret vesh se Jaho është sërish në garë. Ajo është e nominuar në kategorinë për këngëtarën më të mirë, kurse për Ermonela Jahon këto ethe nuk janë të panjohura pasi që artistja shqiptare tashmë ka një trofe nga ky institucion, atë të "Reader's Award", për të cilin Ermonela në vitin 2016 ishte shpallur fituese.

## Ekponatet e Isa Boletinit do të sillen në Kosovë

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, qëndroi në Tiranë për të realizuar vizitën e tij të parë zyrtare, me ç'rast ka takuar homologen e tij, ministren e Kulturës, Mirela Kumbaro Furxhi.

Ministri Gashi gjatë takimit me ministren Kumbaro ka diskutuar për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit midis dy ministrive përkatëse në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore dhe atë të së drejtës së autorit, duke krijuar edhe hapësira dhe mundësi për intensifikim e bashkëpunimit edhe ndërmjet skenës së pavarur kulturore të të dyja vendeve.

Ndër temat konkrete të bashkëpunimit të dy ministrive të kulturës asaj të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë për vitin 2018 u nënvizua nënshkrimi i kalendarit të përbashkët kulturor, si një traditë e mirë dhe shumë domethënëse për kulturën në të dyja vendet, gjë e cila do të ndodhë brenda muajit shkurt. Marrë parasysh që viti 2018 është shpallur edhe Viti mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit – Skenderbeut, dy ministrat u pajtuan që të ketë më shumë aktivitete për të shënuar këtë përvjetor me rëndësi për shqiptarët.

Gashi, me këtë rast, ka kërkuar nga ministrja



shqiptare "huazimin" e disa ekspozitave që i përkisnin heroit kombëtar Isa Boletinit, për të qenë pjesë e ekspozitës së përhershme në Muzeun e Kosovës, që do të hapet më 17 Shkurt – Përvjetorin e Dhjetë të Pavarësisë së Kosovës, duke theksuar se ekspozimi i gjërave që i përkasin Isa Boletinit në Muzeun e Kosovës është një ngjarje me rëndësi për kulturën dhe historinë tonë, meqë kjo është një dëshmi që personalitetet nga Kosova kanë dhënë shumë për çështjen kombëtare.

## Entela Kasi, fituese e "Penës së Flakës"

Në hapësirat e Bibliotekës "Fan S. Noli" në Gjiilan ishin dy veprimtari letrare, Ora e Madhe Letrare, ku poetët e përzgjedhur paraprakisht konkurruan për çmimin e poezisë më të mirë të Manifestimit, "Pena e Flakës", si dhe shpallja e rezultateve të Konkursit anonim letrar për poezi e tregim të shkurtër.

Për dallim nga herët e tjera, vlerësues të poezisë më të mirë, në "Pena e Flakës" 2018, kësaj here ishte paraparë të jenë vetë poetët konkurrues, të cilët me votën e tyre do të përcaktonin poezinë fituese,



por pas votimit doli që dy poete kishin numër të njëjtë votash (Entela Kasi dhe Rakela Yzeiri), andaj sërish është dashtë përcaktimi të bëhet nga juria e grupit punues (Xhevat Latifi, Fatushe Haliti dhe Sabit Rru-

stemi), që kishte bërë edhe përzgjedhjen e të gjitha poezive për t'u lexuar në këtë orë letrare. Vota e tyre përcaktoi fituesen Entela Kasi. Kur jemi te rezultatet e konkursit anonim letrar, juria në përbërje

të Ramadan Musliut, Donikë Dabishveci dhe Bardh Frangut, dha këto vlerësime: Në poezi shpërblimi i parë i jepet poezisë "Në sheshin e Shkupit", shifra "Cracka"; shpërblimi i dytë poezisë, "Buka, toka, njeriu", shifra "Hija e shtetit"; shpërblimi i tretë poezisë, "Shtëpia e puthjeve", shifra "20-9". Në prozë shpërblimi i parë i jepet tregimit "Figura shtatëmbëdhjetë", shifra "Shahu i përgjakur", shpërblimi i dytë, "Natë lutjesh", shifra "Najazum"; shpërblimi i tretë, "Mjaltë e hidhur", shifra "Unë dhe vetvetja".



Milot Rashica ka nënshkruar kontratë 4-vjeçare me Verder Bremen, është prezantuar dhe ka nisur stërvitjen me skuadrën e Bundesligës. Ai u largua nga Vitesë në Holandë pas dy sezonesh mbresëlënëse atje. Futbollisti i përfaqësueses së Kosovës ka marrë fanellën me numrin 11, ndërsa ka dhënë edhe intervistën e parë si lojtar i Verder Bremenit

Që nga dita e martë ai po qëndron në shtëpinë e tij të re, në Bremen të Gjermanisë. Milot Rashica kompletoi transferimin e tij te Verder Bremenit për një shumë prej 7.5 milionë eurosh, kurse vet futbollisti nga Kosova menjëherë shkoi të vizitonte stadiumin e ri. Transferimi i ri i Verderit i gëzohet shumë kalimit në Bundesliga.

**Verder.de: Sa po i gëzohesh nënshkrimit tënd me Verder Bremenin?**

**Rashica:** Jam me fat që jam tashmë një lojtar i Verder Bremenit. Ditët e fundit ishin stresuese, sidomos dita e djeshme (e martë). Jam vërtet i gëzuar që tashmë kemi mundur të sqarojmë gjithçka. Verderi është klub i madh me shumë traditë, që luan në një prej kampionateve më të mira në botë. Kjo është një gjë shumë e madhe për mua.

MILOT RASHICA JEP INTERVISTËN E PARË PAS KALIMIT TE VERDERI

# MEZI PO PRES TA NIS KËTË SFIDË TË RE



**Verder.de: Si 21 vjeç je lojtar mjaft i ri që ka tashmë rreth 100 paraqitje për Vitesse si profesionsit. Si e cilëson karrierën tënde të deritanishme?**

**Rashica:** Kur jam transferuar nga Kosova në Vitesse, ishte një hap shumë i rëndësishëm për mua. Unë kam mundur të luaj dhe të kuptoj futbollin profesional më ndryshe dhe të krijoj shumë përvojë. Vitesse ishte përvoja ime e parë tamam profesionale. Me transferimin te Verderi unë kam bërë hapin e radhës, një hap shumë i rëndësishëm.

**Verder.de: Si e ke njohur deri tash Bundesligan?**

**Rashica:** Bundesliga është një kampionat i shkëlqyer. Shumë tifozë, stadione të mëdha dhe atmosferë e mirë. Edhe në vendlindjen time e kam shikuar Bundesliga nga televizori.

**Verder.de: Cilat janë synimet tua me Verderin?**

**Rashica:** Unë besoj se synimet e mia personale dhe ato të klubit përshtaten mjaft shumë. Ne duam të luajmë në secilën ndeshje për fitore dhe të ngjitemi sa më shpejt në tabelë. Për mendimin tim, ne kemi gjasa të mëdha që ta arrijmë këtë. Në ndeshjet e kaluara të cilat i kam ndjekur, ne kemi pasur mundësi të fatit. Për fatin tash ne duhet

që të punojmë.

**Verder.de: Si dëshironi ta bëni këtë? Çfarë lloj futboll do të bëni për të arritur synimet tabelore?**

**Rashica:** Mënyra si luajmë dhe guximi si ekip më pëlqen. Më përshtatet shumë si lojtar ofensivë. Ekipi ka shumë shpejtësi në lojë. Kjo është një rrugë që duhet at ndjekim dhe kështu dua që edhe të kontribuoj në këtë lloj loje.

**Verder.de: Me cilat forca dëshiron që të kontribuosh? Cilat janë pikat tua të forta në fushë?**

**Rashica:** Unë e shoh veten në pozitë anësore. Në Vitesse kam luajtur më shpesh në krahun e

djathtë. Në fushë e kërkoj me shumë dëshirë duelin një me një me kundërshtarit dhe shfrytëzoj shpejtësinë time. Këtë do ta bëj edhe këtu. Shkurt dhe qartë, do të jap gas (qesh).

**Verder.de: Në fundjavë është menjëherë ndeshja ndaj Shalkes, shpreson të jesh direkt pjesë e kësaj ndeshje?**

**Rashica:** Natyrisht, kjo do të ishte super. Ndihej i gatshëm dhe mund ta paramendoj veten në lojë, por këtë e vendos trajneri dhe nëse këtë javë nuk do të jem në lojë, atëherë do të punoj shumë që të jem pjesë në ndeshjen e ardhshme.

## Memushaj mbetet te Benevento

Ledian Memushaj mbetet pjesë e Beneventos në Serinë A të paktën deri në fundit të sezonit. Edhe pse u kërkuar me shumë ngulm nga Bari në Serinë B, palët nuk gjetën gjuhën e përbashkët për kalimin e 31-vjeçarit te skuadra puljeze. Fillimisht u tha se Bari ofronte 500 mijë euro për mesfushorin, të cilit i garantonte një kontratë deri në vitin 2022, por në orët e fundit skuadra që drejtohet nga Fabio Grosso, këmbënguli për huazim me të drejtë blerjeje, propozim që nuk u pranua nga Benevento. Në orët e fundit të merkatos edhe Salernitana tentoi të siguronte shërbimet e mesfushorit, por tratativat nuk patën sukses.



## Kaçe transferohet te Panatinaikos

Merr fund telenovela Ergys Kaçe. Në ditën e fundit të merkatos mesfushori i kombëtares shqiptare u transferua zyrtarisht te Panatinaikos. Ishte vetë klubi nga Athina që e bëri publik transferimin e 24-vjeçarit nga Korça në faqen zyrtare. Kaçe në mungesë të hapësirave në formacion la Paokun për Panatinaikosin teksa te jeshilët e Athinës do të luajë në formë huazimi deri në fund të këtij sezoni ndërkohë që në

marrëveshjen mes dy klubeve është përfshirë edhe opsioni i blerjes nga ana e Panatinaikos. Për Kaçen u fol edhe për një transferim të mundshëm te Apoel Nikosia në ditët e fundit të merkatos, por tifozët e skuadrës qipriotë dolën kundër kalimit të shqiptarit te skuadra e tyre, me Kaçen që në fund bëri hapin e madh duke u transferuar te gjigandët grekë të Panatinaikos të cilët këmbëngulën më shumë për të marrë shërbimet e tij.

## Holivud beson në fitoren e Krasniqit



Gjithmonë janë parë bashkë por ditëve të fundit i shohim çdo ditë e gati 24 orë bashkë, por duket se janë miq mjaft të mirë. Po flasim për personazhin Ceni Holivud dhe boksierin e njohur Robin Krasniqi, ku ai do ta shoqërojë boksierin edhe në meqin që ka më 3 shkurt kundër Polakut ne Frankfurt. Madje mësojmë se Ceni beson në fitoren e Haxhi Krasniqit, dhe e sheh se së bashku me të do të kthehen me rripin e fitores. Edhe ne urojmë dhe shpresojmë që do të jetë fitimtar boksieri i famshëm shqiptar.

## Sahiti, futbollist i ri i Hajdukut

Shkup, 1 shkurt - Emir Sahiti pas largimit nga Rabotnički është bërë me skuadër të re. Sulmuesi i krahut është huazuar deri në fund të sezonit te skuadra e njohur kroate Hajduk, por në fillim ai do të luajë për ekipin e dytë të Hajduk Split. Repreruesi i ri i shpresave të Shqipërisë dy vite e gjysmë është pjesë e Rabotniçkit, për të cilën ka luajtur 35 ndeshje, duke shënuar një gol dhe katër asistime. Cekim. vitin e kaluar flitej se për vëllezërit Emiri dhe Suad Sahiti janë të interesuar Hajduku dhe Dinamo, por ja që vetëm i riu Sahiti arriti të transferohet te Hajduku, derisa Suadi aktualisht mbron ngjyrat e Skënderbeut. (B.K.)





Në këtë transferim janë përfshirë edhe mjaft lojtarë të tjerë që lëvizin nga njëri ekip në tjetrin, por natyrisht që gjithçka vërtitet rreth emrit të Griffin, një prej lojtarëve më të mirë në NBA. Te skuadra e Detroit, bashkë me Griffin do të vijin edhe Uilli Reed dhe Brice Xhanson, ndërsa te skuadra e Klippers do të shkojnë Boban Marjanović, Tobias Harris, Avery Bradley dhe dy zgjedhje në draft

Pas 8 sezonesh e gjysmë, Blejk Griffin divorcon me Los Anxhelos Klippers dhe nga dita e sotme ai është një lojtar i Detroit Pistons. Një lëvizje e papritur e merkatos, që ka befasuar të gjithë, ku çdo gjë është vendosur dhe

## GRIFFIN LË KLIPPERS, TRANSFEROHET TE DETROITI



zyrtarizuar brenda pak orësh. Në këtë transferim janë përfshirë edhe mjaft lojtarë të tjerë që lëvizin nga njëri ekip në tjetrin, por natyrisht që gjithçka vërtitet rreth emrit të Griffin, një prej lojtarëve më të mirë në NBA. Te skuadra e Detroit, bashkë

me Griffin do të vijin edhe Uilli Reed dhe Brice Xhanson, ndërsa te skuadra e Klippers do të shkojnë Boban Marjanović, Tobias Harris, Avery Bradley dhe dy zgjedhje në draft. Griffin është zgjedhur në draft nga skuadra e Klippers në vitin

2009, sezon në të cilin ai nuk luajti për shkak të një dëmtimi. Por nga viti 2010, ai është një nga yjet e NBA-së dhe të skuadrës së Klippers, duke luajtur mbi 500 ndeshje me këtë fanellë. Në karrierën e tij, ai ka një mesatare prej 21,6 pikësh, 9,3 kërcime dhe 4,2 asistime për ndeshje. Largimi i Griffin e dëmton shumë skuadrën kaliforniane, që në muajt e verës humbi edhe Kris Pol, duke nisur kështu një revolucion. Madje përfillet se mund të largohen edhe DeAndre Xhordan e Lou Uilliams, për të ndërtuar një ekip me emra të rinj për të ardhmen.

## Alonso do të marrë pjesë në garën "24 orë të La Mansh"

MekLaren ka konfirmuar sot se piloti i saj Fernando Alonso do të marrë pjesë më datat 16-17 qershor në garën "24 orë të La Mansh". Spanjoli mori pjesë ditën e diel në një tjetër garë të ngjashme, atë "24 orë të Daytona", ku u klasifikua në vendin e 38-të, në përvojën e tij të parë në një eveniment të tillë. Në La Mansh, ai do të garojë me skuadrën e Toyota Gazoo Racing. MekLaren bëri me dije se parvarësisht kësaj pjesëmarrje, Alonso nuk do të heqë dorë nga asnjë garë e Botërorit të Formula 1, siç bëri vjet, ku mungoi në Montekarlo. "Jam gati. Nuk është një sekret që këtë sezon dua të realizoj një triplet të veçantë: Të fitoj në Montekarlo, në Indy 500 dhe në 24 orët e La Mansh. Në Indi e provova edhe vjet, por nuk ia dola mbanë, ndërsa këtë vit kam sërish mundësinë përmes MekLaren, për të provuar fitoren në La Mansh. Do të jetë një sfidë e madhe, shumë gjëra mund të mos funksionojnë, por jam gati. Por pohoj se përparësi për mua mbetet Formula 1, për të qenë kompetitiv në çdo garë dhe fituar titullin e tretë kampion aty", tha Alonso.



Publicitet

Republika e Maqedonisë  
Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

### KORRIGJIM

#### Të shpalljes publike për emërim të drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve në pajtim me ligjet e veçanta materiale

Qeveria e Republikës së Maqedonisë më datë 31.01.2018 ka publikuar shpallje publike në gazetën ditore "Sloboden Peçat", "Nova Makedonija" dhe "Koha", për emërim të drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve në të cilën bëhet korrigjim ashtu që në:

#### - Shpalljen publike për emërim të drejtorit të Drejtorisë për mbrojtje të trashëgimisë kulturore

Në bazën "39/2016" i shtohet edhe "11/2018", në pikën 2 alineja 5 pas fjalëve "BULATS – së paku 60 pikë" shtohen fjalët "edhe APTIS – së paku niveli B2", ndërsa alineja 6 fshihet.

#### - Shpalljen publike për emërim të revizorit kryesor dhe zëvendës revizorit kryesor të trupit revizor për revizion të instrumentit për ndihmë paraqasëse

Në bazën në vend të "Ligjit për rezerva të domosdoshme të naftës" duhet të qëndrojnë "Ligjin për revizion të instrumentit për ndihmë paraqasëse (IPA)" dhe pas "27/2016" i shtohet edhe "190/2016" dhe në pikën 2 pas alinesë 7 shtohet alineja 8 e cila thotë "të kenë certifikatë për njohuri të fituara nga sfera e revizionit" dhe

#### - Shpallje publike për emërim të drejtorit të Agjencisë për barëra dhe mjete medicinale

Në pikën 2 alineja 3 në vend të "të ketë të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të arsimit nga sfera e farmacisë" duhet të qëndrojnë "të ketë të baruar fakultetin e farmacisë" dhe në alinenë 4 pas fjalëve "farmacia" shtohen edhe fjalët "dhe të ketë të mbaruar studime postdiplomike" specializim ose doktrat nga sfera e farmacisë".

Në bazë të nenit 150 nga Ligji për sigurim shëndetësor (Gaz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), neni 13 nga Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësor me arsimim të lartë nga fusha e medicinës (Gaz. zyrtare e RM nr. 85/15) dhe neni 6 nga Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë me arsimim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 137/12 dhe 121/13), Fakulteti i mjekësisë pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup shpall:

#### Plotësim të

Shpalljes publike për paraqitje të kandidatëve për regjistrim gjegjësisht lejim të specializimit dhe subspecializimit të punëtorëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor me arsim sipëror nga sfera e medicinës për vitin 2018

Nr. rend.	Subspecializim	Për të punësuar shëndetësor gjegjësisht bashkëpunëtor shëndetësor të punësuar në Institucionet private, persona tjerë juridik dhe të papunësuar
1	Perinatologjia	1
2	Nefrologjia	2

Kërkesa për miratim të specializimeve së bashku me dokumentacionin e kompletuar dorëzohet nga ana e Institucionit privat shëndetësor në të cilën është i punësuar punonjësi shëndetësor, gjegjësisht nga punëtori shëndetësor i papunësuar apo bashkëpunëtori shëndetësor, në pajtim me dispozitat nga Ligji për mbrojtje shëndetësore dhe Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor me arsim sipëror dhe Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësor me arsim sipëror nga sfera e medicinës më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të Shpalljes, deri në arkivin e Fakultetit të mjekësisë pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, rr. "50-ta Divizija" nr. 6, 1000 Shkup.

Ligji për mbrojtje shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16) dhe Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësor me arsim sipëror nga sfera e medicinës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 85/15) mund të gjenden në ueb faqen e Fakultetit të mjekësisë [www.medf.ukim.edu.mk](http://www.medf.ukim.edu.mk).

UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI"  
FAKULTETI I MJEKËSISË – SHKUP



Republika e Maqedonisë  
Komuna e Sopihtes

Tel. ++389 2 27 85 100  
Faks. ++389 2 27 85 109  
Rr. 2, nr. 2, f. Sopihte, 1054  
Shkup, Republika e Maqedonisë  
[www.opstinasopiste.gov.mk](http://www.opstinasopiste.gov.mk)  
[gradonacalnik@opstinasopiste.gov.mk](mailto:gradonacalnik@opstinasopiste.gov.mk)

Nr i procedurës: 10858  
Nr. 28-33/17 e datës 22.01.2018

#### LAJMËRIM

Për organizim të Anketës publike dhe prezantimit publik në lidhje me Dokumentacionin planor lokal urbanistik për vendosje të qelive fotovoltaike, për prodhim të energjisë elektrike në pjesën nga PK 37/1, KK Jabollcë, Komuna e Sopihtes.

Realizohet prezantim publik dhe anketë publike për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për vendosje të qelive fotovoltaike, për prodhim të energjisë elektrike në pjesën nga PK 37/1, KK Jabollcë, Komuna e Sopihtes.

Përfshirja planore e dokumentit Dokumentacioni planor lokal urbanistik për vendosje të qelive fotovoltaike, për prodhim të energjisë elektrike në pjesën nga PK 37/1, KK Jabollcë, Komuna e Sopihtes është me sipërfaqe prej 25.000 m<sup>2</sup>.

5. Prezantimi publik dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës Sopihte më datë 07.02.2018 në ora 11.00.
6. Anketa publike do të zgjasë deri më 14.02.2018, në bazë të nenit 51 paragrafi 10 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).
7. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni përkatës të përfshirë në plan në afatin e lartpërmendur të parashtrajnë vërejtje, propozime dhe mendime në listat anketuese në administratën komunale.
8. Informacione në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës së Sopihtes  
Stefçe Trpkovski

I. Nr. 324/2014

SHPLLJE PUBLIKE  
(në bazë të nenit 46-b, të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përbarim, Gazeta Zyrtare nr. 8 të datës 17.01.2008)

Përbaruesi Vanço Markovski duke vepruar me propozim të kreditorit Eshref Ajruli, përmes aut. avokatit Branko Trajkovski nga Tetova dhe vendbanim në rr. Drenoec – Poroj nr. 8, kundër borxhliut Husein Memedi nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubo Bozhinovski Pish nr. 69, dhe borxhliut pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë, për shkak të realizimit në holla në shumë prej 24.600.000,00 denarë më datë 26.01.2017

FTON  
Borxhliut pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë të paraqitet në zyrën e përbaruesit Vanço Markovski në rr. Ilindenska nr. 64 Tetovë, për parashtrim të akteve në vijim: Konkluzion për shitje publike me gojë i nr. 324/2014 të datës 15.01.2018, Konkluzion për përcaktim të vlerës nga data 15.01.2018 dhe Konkluzion për mënyrën e shijes së patundshmërisë i nr. 324/2014 të datës 15.01.2018, NË AFAT PREJ 1 (NJË) DITE, duke llogaritur nga dita e publikimit të fundit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHET borxhliut pengmarrës Imer Shaqiri se mënyra e këllitë e dorëzimit llogaritet si dorëzim në rregull dhe se për pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.

Kjo shpallje paraqet PUBLIKIMIN E PESTË të thirrjes publike

PËRMBARUES  
Vanço Markovski

#### LAJMËRIM

Për anulimin e Shpalljes publike nr. 1/2018

SHMK „Niko Nestor„-Strugë Ju informon se në pajtim me Vendimin e Këshillit të shkollës me nr. 02-102/7 të datës 31.01.2018, ANULOHE T Shpallja publike me nr. 1/2018 për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar, më së voni deri më 31.8.2018 e publikuar në gazetën „Koha„ dhe „Veçer„, më 10.1.2018.

SHMK „Niko Nestor„-Strugë  
U.d.Drejtor,  
Besime Jonuzi



Afati kalimtar i janarit ka shkuar më mirë se sa tifozët më optimistë të Arsenalit kanë mundur të paramendojnë

# FITUESIT DHE HUMBËSIT MË TË MËDHENJ TË AFATIT KALIMTAR TË JANARIT



Me afatin kalimtar dimëror tashmë të mbyllur, është koha që të hedhim një shikim se kush ishin fituesit dhe humbësit në tregtitë e lojtarëve muajin e fundit

## 1. FITUES: ARSENALI

Me disfatën shokuese të Svonsi që rrëmbeu vëmendjen e të gjithëve, Arsenali u duk se ka ende probleme të mëdha për të zgjidhur në mbrojtje dhe ndoshta edhe në portë. Është e vërtetë se asnjë portier në top pesë ligat evropiane nuk ka bërë më shumë gabime që çuan te goli se sa Petr Çeh (katër gola). Sidoqoftë, afati kalimtar i janarit ka shkuar më mirë se sa tifozët më optimistë të Arsenalit kanë mundur të paramendojnë. Topçinjtë e filluan muajin duke u përballur me idenë e humbjes së dy prej yjeve më të mëdha, Aleksis Sançez dhe Mesut Ozil—gjatë kësaj vere në parametra zero. Sançez tashmë është paraqitur në fanellën e Mançester Junajtedit, por kjo është pozitive nëse marrim parasysh ndikimin negativ që ai ka sjellë në zhveshtoren e Arsenalit. Për më shumë, Topçinjtë kanë marrë në shkëmbim një lojtar të shkëlqyer si Henrik Mikitarian që duhet të shkëlqej nën një trajner që ja lejon atij liri më të madhe sulmuese, sidomos pasi pritet që të luajë bashkë me ish-shokun e tij të vjetër te Dortmundi, Pierre—Emerik Aubameyang. Vendimi i befasishtëm, por më i mirëpritur për të rinovuar kontratën po ashtu ka ndikuar në vendin e atij që quhet pasardhësi i Hanri, Aubameyang. Natyrisht, 56 milionë funtet e paguara te Dortmundi për shërbimet e sulmuesit konfirmojnë një rekord të ri transferues, por kur merren parasysh largimet, mund të kuptohet se ky transferim është financiar nga largimet e Teo Ualkott dhe Francis Koquelin që u larguan për shumë të kombinuar prej 37 milionë funtesh, e më pas është e pamundur që të shikohet kah puna e bërë e Vengerit në këtë afat kalimtar dhe të mos konstatohet se kjo periudhë ishte e suksesshme për londinezët. A do të përfundojë Arsenali në top katërshe? Kjo mbetet të shihet. Por, a kanë më shumë gjasa që këtë ta arrijë? Absolutisht.

## 2. FITUES: HOZE MURINJO

Duke parë mënyrën në të cilën Hoze Murinjo i bën arsyetimet dhe fabrikon faktet, është e radhë që një njeri ta gjejë veten në pajtueshmëri me mjeshtrin e manipulimit të mediave. Sidoqoftë, bosi i Mançesterit ka pasur të drejtë kur ka thënë se ishte mjeshtri shkëmbimi i Mikitarian për të kërkuarin Aleksis Sançez. "Ai ishte i lirë, pse jo? Transfer i lirë. Ai ishte i lirë. Kë-

shtu, për këtë çmim, ai është fantastik. Mendoj se të gjithë mendojnë njëjtë. Të gjithë duhet të pajtohen se ai është lojtar fantastik dhe ekipi që e mori atë e ka një plus", tha Murinjo. Nuk ka kundërshtime këtu. Aleksis do t'i japë një dimension krejt të ri vijës së sulmit që shpesh u duk e varfër në aspektin e kreativitetit ndaj ekipeve më të mira. Se sulmuesi i shumë anshëm kilian ishte i kërkuar nga Guardiola para kalimit të Junajted, e bën transferimin e tij të shijojë më ëmbël në gjuhën e portugezitetit kontravers.

## 3. FITUES: BARCELONA

Ishte vetëm gushti i muajit të kaluar kur mbrojtësi i Barcelonës, Xherard Pike, pranoi hapur: "Në nëntë vitet e fundit që kam qenë këtu, kjo është hera e parë që jam ndërjerë inferior ndaj Real Madridit". Me fat të mbarë për katalanasin krenar, ky sensacion depresiv nuk zgjati shumë. Gjatë pjesës së parë të sezonit, Blaugranët rigjetën veten si ekipi më i mirë në La Liga, madje duke shkelur Real Madridin në Bernabeu para festave të fundvitit. Thënë shkurt, nëse dikush ka pasur nevojë për transferime në dimër, ishte pikërisht Real Madridi, por përderisa nuk ka pasur asnjë transferim në kryeqytetin spanjoll gjatë janarit, Barcelona ka qenë shpenzuesja më e madhe e afatit kalimtar dimëror. Blaugranët shpenzuan një shumë të kombinuar prej 131.8 milionë euro për Filip Kuntinjo dhe Jerry Minan, për të shtuar shpresat e Ernesto Valverdes për një replikim të suksesit të paraardhësve të tij Pep Guardioli dhe Luis Enrike duke fituar tripletën në sezonin e parë në krye të detyrës. Lojtari dominues në ajër, Mina, është një biznes i shkëlqyer i bërë nga Barcelona për çmim modest prej 11.8 milionë eurosh teksa ardhja e Kuntinjos në gjysmë sezon për 120 milionë euro (të cilat mund të kapin shifrën e 160 milionë eurosh me bonuse) i ka edhe anët negative, pasi që ai nuk mund të luajë

në Ligën e Kampionëve, por liderët e kampionatit spanjoll mund të pushojnë Andres Iniestan në mënyrë që ai të jetë i gatshëm për sfidat e LK-së. Pos kësaj, Barca ka arritur që të largojë një numër të përfituesve të mëdhenj nga lista e pagave si Javier Mascherano dhe Arda Turan, teksa në të njëjtën kohë i dërgoi në huazim Rafinjan dhe Deulofeun. Reali në kontratë të plotë tash po përgatitet për një ndeshje "o jetë, o vdekje" në Ligën e Kampionëve me PSZH-në me të njëjtën bazë të ekipit dhe grup të lojtarëve që janë dukur qesharak muajt e fundit. Shkurt e shqip, PiKE ndihet superior sërish.

## 4. HUMBËS: LIVERPOOLI

"Liverpooli nuk është klub që duhet të shesë lojtarë", deklaroi menaxheri Jugen Klopp verës pasi Barcelona riti ofertën për Kuntinjon. "Kjo është e vendosur me vullë, kështu që nuk ka lidhje kush sa ofron". Por, pse atëherë Liverpooli u pajtua ta shesë brazilianin te Blaugranët në janar, në një kohë kur "The Reds" janë në një betejë me Junajtedin, Çellsin, Totenhemin dhe me shumë mundësi edhe me Arsenalin, për tri vendet e mbetura nga top katërsheja, ashtu sikurse ka para një duel shumë të mundur për t'u fituar me Porton në fazën e ardhshme të eliminimit direkt në Ligën e Kampionëve? Të hollat në ofertë (120 milionë euro dhe potencialisht 40 milionë të tjera si bonuse) ishin kolosale, ndoshta për shkak se Kuntinjo mund të konsiderohet një prej top pesë lojtarëve në botë, por a do të kishte qenë shumë më pak në fund të sezonit nëse do të ndodhte transferimi? Vështirë të thuhet. Për më shumë, teksa Kuntinjo dëshiroi të largohet, a do të shfrytëzonte ai mundësitë e këqija për të refuzuar të luajtur, në një vit kur zhvillohet Botërori? Ai dërgoi një kërkesë transferuese gjatë verës, por kontribuoi me 12 gola dhe nëntë asistime gjatë pjesës së parë të sezonit 2017/2018? A do të grevonte ai po

që se do t'i thuhet se ëndrra për Barcelonën do t'i përmbushet vetëm gjatë verës? Natyrisht, frustrimi i Liverpoolit që humbi Kuntinjon u ngushëllua nga transferimi i Virgil van Dijk, pasi nuk ka dyshime se holandezi forcon mbrojtjen e klubit nga "Merseyside". Sidoqoftë, kur vjen puna te vlerësimet e afatit kalimtar dimëror, duhet të pyesim veten nëse skuadra është e fortë ose më e dobët se sa që ka qenë në fillim të muajit? Liverpooli është më i dobët. Ata kishin në dorë të gjithë aset, por në fund kanë copa të thyera të një konstelacioni të mrekullueshëm që mirë e ndërtoan në të kaluarën e afërt. Qendra e mbrojtjes është përmirësuar, por mbetet në varësi të dy prej portierëve më të dobët në Ligën Premier. Lorus Karius është promovuar si zgjedhja e parë, një vendim kontravers pasi që ai ka përqindjen më të dobët të intervenimit (44.44 për qind), më pak se cili do portier tjetër në pesë kampionatet evropiane. Duke parë që Roma dëshpërimisht po kërkonte para në janar, Liverpooli është dashur që të shtyjë përpara për portierin e parë të Romës, Alisson.

## 5. HUMBËS: DAVID LUIZ

David Luiz mund të falet nëse është gëzuar që lëndimi i bashkëlojtarit, Andreas Kristensen, i ka dhënë atij minutazhë për të luajtur. Bosi i Bluve, Antonio Conte, rregullisht ka insistuar se është një lëndim në gju pse braziliani s'ka startuar nga tetori, por është e qartë se Luiz ka rënë nga preferencat e tij në "Stamford Bridge", përkundër faktit se ai ishte një prej njerëzve kyç në triumfin për titull. Përkundër pohimeve të kundërta, dihet se marrëdhëniet mes të dyve janë përkeqësuar, kështu që Luiz mirëpriti spekulimet se ai mund të jetë pjesë e marrëveshjes për Zhirudin. 30 vjeçari nuk është ftuar as nga Brazili që prej qershorit dhe nëse dëshiron të ketë ndonjë gjasë që të jetë në kombëtare për kam-

pionatin Russia 2018, atëherë ai duhet të luajë në baza javore. Realiteti zhgënjës është që edhe nëse ai tejkalon lëndimin në gju, ka pak gjasa që ai t'u kthehet fushave të blerta. Luiz sipas të gjitha gjasave po e pret raportin mjekësor me më shumë interes se sa vet danezi i lënduar. Për më shumë, huazimi i Starrigj te VBA do të thotë se Liverpooli është një lëndim larg që të aktivizojë Ings dhe Solanke (pa gol këtë sezon) që të udhëheqin sulmin që ka mungesë të shumëanshmërisë me largimin e Kuntinjos. Presioni mbi Salahun, Firminon dhe Manen që të mbajnë mbi supet këtë ekip të madh për pjesën e mbetur të sezonit është bërë edhe më i madh.

## 6. HUMBËS: FUTBOLLI

Agjenti i famshëm Erik Hall një herë potencoi: "Gjëja më e keqe për punën time është se lojtari i merr 90 për qind të fitimeve të mia". Sa shumë do të dëshironte bohemi duhanxhi nga Londra të ishte pjesë e biznesit të futbollit të ditëve të sotme. Fernando Feliceviç përfitoi 15 milionë funte nga shkëmbimi që e pa klientin e tij, Sançez, drejt Junajtedit nga Arsenali, teksa Mikitarian shkoi në drejtim të kundërt. Është raportuar se agjenti i këtij të fundit, Mino Raiola, ka bllokuar marrëveshjen një kohë të gjatë për shkak të përqindjes së tij. Raiola, natyrisht, është njeriu që ka fituar 24 milionë funte nga transferimi Paul Pogbas verën e vitit 2016 që vërtet i bëri njerëzit të mendojnë se sa shumë para po largohen nga loja e futbollit e po përfundojnë në duart e agjentëve. Më herët gjatë muajit, Grupi Profesional për Strategji të Futbollit pranë UEFA-s zbuloi një studim ku dy mijë transferimet e ndodhura mes viteve 2014-2017 i ka parë agjentët duke operuar në mënyrë efektive pa ndonjë pengesë në aspektin e përqindjeve të tyre. Përqindja mesatare e fituar prej tyre ishte 12.6 për qind, mjaft neveritëse kjo, por kishte edhe të tillë agjentë që pohonin se fitonin gjysmën e shumës transferuese mes dy klubeve. Edhe më keq se kjo, studimi gjeti se sa më e vogël marrëveshja, aq më shumë para bënin agjentët, që do të thotë se derisa klubet e mëdha nuk e kanë problem, janë klubet e vogla që po vuajnë më së shumti nga këta agjentë. Agjentët duhet të bëjnë punën e tyre. Askush nuk po e konteston këtë. Por, lojtarët duhet që të mbrohen. Ata duhet të kenë këshilla financiare. Por, e pamohueshme është që futbollit po humbet qindra miliona euro çdo vit te një grup i njerëzve që ka interes monetar në këtë lojë dhe asgjë më shumë.





## Kielini përgatit rinovimin

Është e gjitha bardhezi e ardhmja e Gjergji Kielini. "Rinovimi i kontratës? Së shpejti do të finalizojmë marrëveshjen dhe nuk do të ketë asnjë problem", tha mbrojtësi i Juventusit. Në lidhje me luftën për titullin kampion, ai shtoi: "Do të vendoset në muajin maj, është një sfidë mes nesh dhe Napoli. Kemi shumë respekt për Napolin. Jemi të dyja skuadra të ndryshme me njëra-tjetrën, por të dyja mund të fitojmë". Nuk mungon as një mendim për "shokun" Buffon, i cili sapo ka mbushur 40 vjeç. "Buffon është një lider dhe forca e tij më e madhe është qetësia. Ai duket se ka fuqinë për të ndalur kohën". Kielini ka folur me shumë respekt për Napolin, rivalin e bardhezinjve në garën e titullit në Serie A. "Jemi dy ekipe që ndryshojmë shumë, edhe në filozofinë e lojës. Ne jemi më të fortë fizikisht, ata janë më shpejtë dhe teknikë, por nuk mendoj se njëra skuadër është më e fortë dhe tjera më e dobët. Duhet të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë që kemi në dispozicion". Në fund, qendërmbrojtësi flet për sfidën e ardhshme në Çampions Ligës kundër Totenhemit. "I gjithë ambienti ynë pret me padurim sfida të tilla në arena të rëndësishme Evropiane. Ndihe mi gati për t'u përballur me ekipet më të forta në Evropë dhe Totenhemin është një e tillë", përfundoi Kielini.

## Dua të luaj te Junajted deri 40-vjeç!

Huan Mata do të dëshironte ta rinovonte qëndrimin e tij në "Old Trafford", duke imituar të madhin Rajan Giggs, i cili luajti me "dajtë" deri në moshën 40-vjeçare. Pati disa zëra se 29-vjeçari nga Spanja do të largohej nga "dajtë", pasi drejtimin e skuadrës e mori Hoze Murinjo, trajneri që e largoi nga Çellsin në janar 2014, por Mata ka luajtur rregullisht nën urdhrat e Murinjos dhe tani ekziston mundësia e rinovimit të kontratës në "Old Trafford", pasi marrëveshja aktuale skadon në verën e ardhshme. I pyetur nëse e shihte veten e tij duke e mbyllur karrierën me fanelën e Mançester Junajtedit, Mata tha. "Unë jam 29 vjeç dhe shpresoj që mund të luajë futboll edhe për shumë vite të tjerë. Do të ishte shumë e bukur po të luaja deri në moshën 40 vjeç si Rajan Giggs, por kjo është disi larg, sepse duhet edhe 11 vjet. Jam ende i lumtur këtu. Ky është një klub masiv dhe mbështetja që kemi pasur është e jashtëzakonshme. Jam i lumtur dhe do të doja të qëndroja sa më gjatë te kjo skuadër", deklaroi Mata.



## VIZIONI I MURINJOS PËR VITIN 2020

# MANÇESTERI PRETENDENT PËR GJITHÇKA

Hoze Murinjo ka përshkruar vizionin e tij të vitit 2020 për Mançester Junajtedin, pasi ka në plan ta drejtojë klubin në një pozicion, ku të jetë sfidues në të gjitha frontet, brenda dy viteve. Portugezi e mbajti ndeshjen në "Wembley" të mërkurën, pasi skuadra e tij u mund 2-0 ndaj Totenhamit, i cili hapi rezultatin brenda 11 sekondave, me Kristian Eriksen. Autogoli i Fil Xhons, pak para gjysmë ore, e ka shantur Mançesterin, që nuk ishte në gjendje ta kthente "baticën". Kësisoj, Mançester Siti shkon në +15 pikë në krye të Premier Ligë, falë fitores 3-0 ndaj Uest Brom. Kjo gjë i ka shqetësuar tifozët e Mançester Junajted që shikojnë një periudhë dominimi të "qytetarëve", nën drejtimin e Pep Guardiols. Megjithatë, Mu-

"Më mirë se tani. Luftë për atë që po luftojmë tani, por me municione të ndryshme. Unë shoh që jemi pretendentë të vërtetë për gjithçka, ky është niveli që duam të arrijmë", shprehet Murinjo

rinjo, kur u pyet se ku e sheh skuadrën e tij në vitin 2020, u përgjigj në mënyrë tipike: "Më mirë se tani. Luftë për atë që po luftojmë tani, por me municione të ndryshme. Unë shoh që jemi pretendentë të vërtetë për gjithçka, ky është niveli që duam të arrijmë". Pavarësisht se arriti në Mançester në maj të vitit 2016, Murinjo ende jeton në hotelin e qytetit, në vend që të kërkojë më shumë strehim të përhershëm. Portugezi lëvizi për ta larguar bisedën nga gjendja e jetesës, se ajo ka një ndikim të keq në sjelljen e tij. "Njerëzit nuk ndajnë me mua intimitetin e dyerve të brendshme. Mendoj se jam një njeri i këndshëm ndonjëherë, ndoshta me disa shaka pa kuptim, apo diçka të tillë", - deklaroi ai.

## Do të kualifikohemi në finale në Romë



Milani barazoi pa gola kundër Lacios në ndeshjen e parë gjysmëfinalen të Kupës së Italisë, të luajtur në "San Siro". Qendërmbrojtësi i kuqezinjve, Leonardo Bonucci, e sheh gotën gjysmë plot dhe mendon se skuadra e drejtuar nga Xhenaro Gattuso do ta arrijë finalen në "Olimpico".

Milani i kishte mposhtur bardhekaltërit në ndeshjen e luajtur në kampionat, tre ditë më parë, megjithatë këtë herë nuk arriti të shënojë. Kjo nuk e pengoi futbolistin e ardhur nga Juventus gjatë merkatos së verës që të jetë optimist për arritjen e suksesit në Kupën e Italisë. "Ka qenë një

ndeshje e vështirë sepse Lacio sulmoi shumë sidomos në pjesën e parë, por ne treguam se dimë të mbrohem dhe dimë të vuarjmë.

Rezultati është pozitiv dhe mund të shkojmë në finale në ndeshjen e ardhshme, duhet të vazhdojmë të përmirësohemi ditë pas dite ashtu si po bëjmë. Të gjithë ne, duke nisur nga unë i pari kemi shumë për të dhënë dhe mendoj se në pjesën e dytë të sezonit mund të arrijmë gjëra të rëndësishme. Kryesorja është që kemi larguar humbjet dhe parqitet e dobëta. Do të kualifikohemi në Romë", deklaroi kapiteni i Milanit.

## Kupa e Botës në rrezik për shkak të karkalecave shkatërrues

Qeveria ruse thotë se karkalecat mund të shkatërronjë vendin dhe fushat e Kupës së Botës. Karkalecat zakonisht ushqehen me të korrat në Rusinë jugore dhe Pjotr Çekmarjov, i cili kujdeset për mbrojtjen e bimëve në ministrinë e agrikulturës, thotë se ata mund të sulmojnë edhe stadiumet. Në komentet e raportuara nga agjencia e lajmeve vendase, Çekmarjov thotë se "jemi mësuar të përballojmë pak a shumë karkalecat, por këtë vit kam frikë se mund të gjendem me një skandal të madh ndërkombëtar." Ai ka shtuar se "karkalecat parapëlqejnë vendet ku ka shumë hapësirë jeshile," dhe thotë se "të mos turpërojmë veten përpara shoqërisë globale, sidomos kur



të kemi vizitorë nga e gjithë bota". Çekmarjov ka theksuar se regionin Volgograd, që ndodhet rreth 1000 km në jug të Moskës, është një vend delikat. Këtë verë

finalët e Kupës së Botës do të zhvillohen mes 14 qershorit dhe 15 korrikut, me ndeshjet që do të luhen në 12 stadione rreth e qark 11 qyteteve.





**DASHI** 21. mars - 20. prill

Jeta ne çift do vije duke u përmirësuar dita ditës. Duke filluar qe sot do ia shprehni me shume ndjenjat atij qe keni ne krah dhe e ardhmja pritet te jete me e ndritur. Beqaret do kenë takime te shumta dhe ne fund te ditës do i duhet te marrin vendime te rëndësishme. Ne planin financiar do jeni me te qete fale një shume qe keni marre kohet e fundit.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Marrëdhënia juaj me partnerin do filloje te përmirësohet gjate kësaj dite. Do flisni me lirshëm për gjithçka qe iu mundon dhe do i zgjidhni brengat. Edhe për beqaret gjithçka do jete e mundur. Bëjini sytë katër sepse mundësitë për takime do jete te mrekullueshme. Me financat nuk do i keni punët shume mire, kështu qe duhet te mos shpenzoni pa kufij.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Edhe pse marrëdhënia ne çift do jete shume e mire, nuk duhet te merrni vendime te rëndësishme për te ardhmen. Tregohuni pak me te duruar nëse doni qe gjithçka te shkoje për se mbari. Beqaret do tregohen impulsive dhe mund te bëjnë gabime te renda. Ne planin financiar ka mundësi t'iu gjeni zgjidhje te gjitha problemeve qe keni pasur me pare.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Jeta ne çift do jete me e bukur gjate kësaj dite. Do ruani një komunikim te mire me partnerin dhe do kaloni momente mjaft sensuale. Për sa iu përket beqareve ata do vazhdojnë te jene ne kërkim te dashurisë se madhe, por pa ndonjë rezultat specifik. Ne planin financiar do jeni me fat dhe do arrini te rregulloni problemet qe iu kishin dale me herët.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Dite shume e bukur kjo e sotmja për gjithë te dashuruarit. Do qëndroni me shume kohe pranë atij qe dashuron dhe do i sqaroni përfundimisht te gjitha dilemat qe keni pasur. Beqaret duhet te tregohen me realiste dhe te mos ëndërrojnë gjera te paqena. Financat do jene te qëndrueshme kështu qe mund te bëni investimet e duhura pa pasur asnjë rrezik.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Flisni me takt dhe diplomaci gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne çift sepse përndryshe do keni debate te shumta. Tregohuni edhe pak me te kuptueshëm. Beqaret do vazhdojnë edhe sot te kenë te njëjtin status kështu qe është e kote te mundohen te gjejnë një person. Ne planin financiar situata do jete e qëndrueshme. Përfitoni për te lare borxhet qe keni pasur.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Çështjet e zemrës do shkojnë me se miri sot. Nuk do i mbani aspak mëri partnerit për ndonjë kritike qe do iu beje sepse do e kuptoni qe ai ka te drejte. Beqareve nuk do iu ecin gjerat shume mire. Kujdes me personat qe do iu joshin sepse edhe mund t'iu lëndojnë. Ne planin financiar do e përmirësoni situatën fale një shpërblym qe do merrni nga puna.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Nëse kohet e fundit marrëdhënia mes jush dhe partnerit ishte ftohur duhet te gjeni mënyrën e duhur për ta përmirësuar. Mos i lini gjerat pas dore sepse situata edhe mund te ndërlikohet. Beqaret do kenë takime shume interesante te cilat nuk duhet t'i humbin për asnjë lloj arsyeje. Financat do i menaxhoni me shume kujdes dhe maturi.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Ka rrezik qe rutina ta pushtojte gjate gjithë kohës jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite. Nuk do i kushtoni rëndësinë e duhur ambientit ne çift pa menduar se kjo mund te jete shkatërruese për ju. Beqaret duhet ta heqin turpin dhe ti shprehin me tepër ndjenjat. Me financat do keni disa probleme te vogla te cilat mund t'i zgjidhni nëse tregoheni te kujdesshëm.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Bashkëpunimi do mbizotërojë gjate gjithë kohës sot ne jetën tuaj ne çift. Do filloni te thurni edhe projekte te rëndësishme për një te ardhme te ndritur bashke. Beqaret do ndihen shume mire me statusin qe kane dhe nuk do kërkojnë me ngulm te fillojnë një lidhje. Ne planin financiar nuk duhet te alarmoheni me problemin me te vogël. Me maturi mund te zgjidhni gjithçka.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Do jeni me humor te keq gjate kësaj dite dhe asgjë nuk do shkoje ashti si e kishit menduar ne çift. Zënkat me partnerin do jene shume te shpeshta. Beqaret do kenë takime te rëndësishme, por nuk duhet te nguten për asgjë. Ne planin financiar tregohuni me realiste dhe mos shpenzoni shuma te mëdha kur e dini qe situata nuk është aq e favorshme.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Nëse ende jeni ne një lidhje, dita e sotme do jete e mrekullueshme. Si ju ashtu edhe ai qe keni ne krah do i kushtoni vëmendjen dhe përkushtimin e duhur njeri-tjetrit. Beqaret ka shume mundësi te gjejnë personin e tyre te ëndrrave. Hiqeni sa me shpejt turpin dhe lëreni veten te lire. Ne planin financiar do kryeni transaksione te rëndësishme qe do e përmirësojnë situatën.



KOHA	VËSHITËRËSITË	SHTET NE AZI	MBAN RAMAZAN	NIË NGA NËNSHKRUËSIT E DEKLARATËS SE PAVARËSISË SE SHQIPËRISË, SOULIU	PËREMËR VETOR SHKRONJA FOINJE	KOBALTI FILOZOFI ÇEK, HUSI	AKTORI AMERIKAN, TARANTINO
USHTRUESJA E PIANOS							
SERIAL ME AKTOREN NE FOTO ... E ÇARLIT						ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS	
NËN					EMRI I DEKARTIT (SHQ.) LLOS ANXHELES.		
LLOJ MAJMUNI (SH)						VEZË POSTIM NE TUITER	
PARASHTESË PER 'EKOLOGJIKE'				E PASURON ME AZOT TOKA E PUNUAR			
AVICENA, IBNI					URANI ERBIUMI	UNION GENERAL DE TRABAJADORES TENESINI (ELEMENT KIMIK)	
PARAFJALË GJERMANE			ZVARRANIKU TEMPERATURA				
SHTETI I TATAREVE							

ZGJIDHJET: FISI, JAPAN, RAKS, AKRA, FLIN, OIF, SAID, AI, CO, PIANISTJA, ENGUJT, ATK, NDRË, RENU, GORILLAT, VE, EKO, AZOTON, SINA, U, UGT, AN, REPTILI, TATARISTAN.

## Sudoku

shumë i lehtë      mesatar

		4		3		2					2		1			7
			1		2						4	2			6	
7		2	6		8	1		5		3	7			8	4	1
	4	6				5	2				5			3	1	
3								9		8						3
	2	9				7	1			7		5				6
9		7	3		6	4		1		4	9	7			8	2
			9		4						2			4	3	
		8		1		3				6			9			5

Shumë i lehtë: 614539278, 583172964, 792648135, 146897523, 375261849, 829453716, 957326481, 231984657, 468715392. Mesatar: 826419573, 514237689, 937658412, 695823147, 481976235, 273541968, 349765821, 752184396, 168392754.



## Ose armët ose marihuanën



Një gjykatë në Bavari hodhi poshtë të mërkurën apelin e një gjahtari gjerman, që synonte të rifitonte të drejtën për të mbajtur armë me leje. Kjo megjithëse ai kishte qenë për një kohë të gjatë kon-

sumues i marihuanës mjekësore. Sipas gjykatësit, pronarët e armëve duhet të jenë të aftë që t'i përdorin armët dhe municionin me kujdes në të gjitha kohët. Konsumimi i kanabisit, edhe sipas re-

cetës së dhënë nga doktori, e ul aftësinë e personit për të vepruar me armën, tha gjykatësi. Ky vendim krijon një rast precedent. Shumë gjermanë tani do të jenë të detyruar që të zgjedhin midis pranimit të trajtimit me kanabis mjekësor dhe zotërimit të një leje për armëmbajtje. Administrata e distriktit në Miesbach, e cila ishte e para që ia hoqi lejen për armëmbajtje dhe për gjuhë personit, tha në një deklaratë të posaçme se kishte ndjekur mendimin e ekspertëve. Sipas ekspertëve, nuk mund të garantohet shëndeti mendor i një personi që konsumon rregullisht kanabis. Gjahtari pohoi se kishte konsumuar shumë herë kanabis. Në mars 2017, qeveria gjermane e përjashtoi nga përndjekja penale përdorimin e kanabisit me recetë. U pranua përdorimi si një formë e trajtimit nga mjeku.

## 69-vjeçarja e pasarelave të modës

Rinia nuk është gjithçka, të paktën jo për 69 vjeçarën Maye Musk. Kjo pasi Maye Musk ndonëse në atë moshë, vazhdon të thyej rekord duke qenë pjesë e trendeve më të reja botërore, pasi ajo shfaq talentin e saj prej një modeleje në pasarelave të mëdha ndërkombëtare. Koleksioni "Pranverë 2018" kohëve të fundit tregon në Nju Jork, Paris, Milano dhe Londër një numër rekord modelesh në vitet 50 dhe 60 në pasarela sipas forumit të industrisë, Fashion Spot. "Unë kurrë nuk kam punuar aq shumë gjatë 50 viteve të fundit siç kam bërë në 2017", thotë modelja 69 vjeçare Maye Musk, nënë e sipërmarrësit miliarder dhe themeluesi i Tesla Elon Musk. Musk e lindur në Kanada, filloi modelimin në Afrikën e Jugut në moshën 15 vjeçare, por vetëm në vitet e fundit karriera e saj është rritur. Ajo së fundi nënshkroi një kontratë me IMG Models, të cilët gjithashtu paraqesin supermodele duke përfshirë Gisele Bündchen dhe Gigi Hadid.



## Arrestohen hajnat e katër tonë portokajve



Pesë persona janë arrestuar për vjedhje të 4.4 tonë portokajve që ishin të futura në tri vetura. Vjedhja e këtyre portokajve u zbulua kur policia filloi të ndiqte dy vetura të cilat po udhëtonin afër njëra-tjetres në një lagje të Seviljas. Pesë personave u mungonin dokumentet dëshmuuese për prejardhjen e portokajve dhe nuk kanë dhënë përgjigje bindëse rreth tyre.



## Vjen dy minuta me vonesë, jep dorëheqjen ministri britanik

Dy minuta me vonesë kanë mjaftuar që ta detyrojnë të japë dorëheqjen: shumë turp! Kështu i ka ndodhur Lord Michael Bates, ministri britanik i Departamentit Ndërkombëtar për zhvillimin, i cili mbërriti në dhomën e Lordëve me pak vonesë, aq sa ka qenë e mjaftueshme për të mos e pasur të mundur t'i përgjigjet pyetjeve mbi hetimet ndaj opozitës. Kur mori fjalën, iu drejtua parlamentarit Ruth Lister për t'i kërkuar falje dhe përgatitur dorëheqjen. "Më vjen keq për edukatën jo të



mirë që tregova që nuk isha në vendin tim për t'iu përgjigjur pyetjes tuaj. Në 5 vjet, ka qenë një privilegj i imi që u jam përgjigjur pyetjeve për llogari të qeverisë dhe gjithnjë kam besuar se duhet të kemi një nivel të lartë mirësjelljeje në respekt të punës. Më vjen keq që nuk isha në vendin tim dhe në vijimësi do t'i ofroj kryeministres dorëheqjen time të përvokueshme". Pas këtij momenti, salla ka reaguar me një "jo" refuzuese ndaj vendimit të parlamentarit.

1492 - Spanja rimerr Granadën nga Murët.

1585 - Spanja dhe Franca krishtere nënshkruajnë Lidhjen e shenjtë të Zhoivillit.

1757 - Trupat angleze okupojnë Kalkutën, India.

1839 - Fotografia e parë e hënës (fotografi francez Lui Dague).

1870 - Fillon ndërtimi i Urës së Bruklinit.

1905 - Elara, sateliti i Jupiterit, zbulohet nga Perrini.

1919 - Kryengritje anti-britanike në Irlandë.

1919 - Lituania fiton pavarësinë.

1929 - SHBA dhe Kanada pajtohen për të bërë mbrojtjen e Ujëvarave të Niagarës.

1933 - Trupat amerikane largohen nga Niagara.

2001 - Sila Calderón bëhet femra e parë Guvernatore e Porto Rikos.

Optimistët kanë shanse dy herë më të mira për shëndetin ideal kardiovaskular, shkruan EurekAlert. Njerëzit me një qëndrim pozitiv ndaj jetës kanë shëndet në mënyrë të konsiderueshme më të mirë kardiovaskular, thotë një studim i ri që ekzaminuar lidhjen mes optimizimit dhe shëndetit e zemrës në më shumë se 5.100 të rriturit.



"Njerëzit me nivelin më të lartë të optimizimit kanë dy herë më shumë gjasa që të ketë shëndet ideal kardiovaskular në krahasim me njerëzit pesimistë", thotë autori kryesor Rosalba Hernandez, profesor i punës sociale në Universitetin e Illinois.

### Ç'FAJ KA PULA?

I dhamë 100 bursa sociale studimi për fëmijët e familjeve në nevojë, ndërsa për ne - nuk bëjmë asgjë - i thotë gruaja burrit!

- Çfarë do të bëjmë atëherë? - pyet burri.

- Po ja, nesër e kremtojmë dhjetë vjetorin e martesës. Ta therim pulën?

- E ç'faj ka ajo?! - përgjigjet burri.



Jeta nuk ka të bëjë me gjetjen e vetvetes. Jeta ka të bëjë me krijimin e vetvetes.

(George Bernard Shaw)



KALENDARI HISTORIK 2 JSHKURT



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS